<p>2. Administrata Tatimore e Kosovës mund të bëjë vizita pa njoftim paraprak për tatimpaguesin, për të konfirmuar përmbushjen me ligjet tatimore në fuqi dhe për të mbledhur borxhet tatimore obligative të kaluara që konsiderohen të nevojshme. Vizita pa njoftim paraprak nuk mund të realizohet në rastet kur tatimpaguesi është përzgjedhur për kontrollë.</p> <p>3. Informacionet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të jenë të qasshme pa marrë parasysh nëse i takojnë tatimpaguesit, një personi i cili ka pasur lidhje financiare me tatimpaguesin, një punëdhënësi, një të punësuar, një personi të vetëpunësuar, ose çdo personi tjetër i cili ka informata që mund të shpien në verifikimin e detyrimit të tatimpaguesit.</p> <p>4. Administrata Tatimore e Kosovës sipas këtij neni ka të drejtë:</p> <p>4.1. të bëjë një evidencë/raport ose kopje nga secili libër, regjistër, kompjuter ose pajisje e ngjashme për ruajtjen e regjistrave për të cilat është siguruar qasja;</p> <p>4.2. të marr në posedim çdo libër dhe regjistër, që sipas ATK përbën provë materiale në përcaktimin e detyrimit të</p>	<p>2. The Tax Administration of Kosovo may conduct visits without prior notice to the taxpayer, to confirm compliance with applicable tax laws, to obtain information pertinent to subsequent audit activity, and to collect past due tax debts as considered necessary. The visit without prior notice cannot be carried out in cases where the taxpayer has been selected for audit.</p> <p>3. The information referred to in paragraphs 1 and 2 of this Article shall be accessible whether it belongs to the taxpayer, a person who had financial dealings with the taxpayer, an employer, employee, self-employed person, or any other person who has information that may lead to verification of the taxpayer's liability.</p> <p>4. According to this article, the Tax Administration of Kosovo has the right to:</p> <p>4.1. make a report or copy from any book, record, computer or similar record storage device of information to which access is obtained;</p> <p>4.2. take possession of every book and register, which, according to the TAK, constitutes material evidence in</p>	<p>2. Poreska administracija Kosova može da vrši posete poreskom obvezniku bez prethodnog obaveštenja, kako bi potvrdila poštovanje poreskih zakona na snazi, dobila relevantne informacije o naknadnim kontrolnim aktivnostima i naplatila prošle obavezne poreske dugove koji se smatraju neophodnim. Poseta bez prethodne najave ne može da se izvrši u slučajevima kada je poreski obveznik odabran da prođe kontrolu.</p> <p>3. Informacije navedene u stavovima 1. i 2. ovog člana, moraju biti dostupne bez obzira na to da li pripadaju poreskom obvezniku, licu koje je imalo finansijske veze sa poreskim obveznikom, poslodavcu, zaposlenom, samozaposlenom licu ili bilo kom drugom licu koje ima informacije koje mogu dovesti do provere obaveze poreskog obveznika.</p> <p>4. Poreska administracija Kosova prema ovom članu ima pravo da:</p> <p>4.1. sastavi evidenciju/izveštaj ili napravi kopiju iz svake knjige i registra, računara ili sličnog uređaja za čuvanje registara za koje je obezbeđen pristup;</p> <p>4.2. preuzme svaku knjigu i registar koji, prema PAK-u predstavlja materijalni dokaz za utvrđivanje</p>
---	--	---

<p>personit sipas legjislacionit tatimor në fuqi në Republikën e Kosovës;</p> <p>4.3. të mbajë çdo libër ose regjistër të tillë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për të përcaktuar detyrimin e personit ose për çdo veprim sipas këtij Ligji;</p> <p>4.4. të kërkojë dhënien e fjalëkalimit që mbron informatat në pajisjen e teknologjisë informative për ruajtjen e regjistrave;</p> <p>4.5. të marr në posedim dhe të mbajë pajisjen e teknologjisë informative, aty ku kopja në letër apo pajisja e teknologjisë informative për ruajtjen e regjistrave nuk është siguruar, për aq kohë sa të jetë e nevojshme për të kopjuar informatat e kërkuara; dhe</p> <p>4.6. të bëjë verifikime në aktivën dhe pasivën e një personi aty ku verifikimet e tilla sipas ATK përbëjnë provë materiale në përcaktimin e detyrimit të një personi sipas legjislacionit tatimor në fuqi në Republikën e Kosovës;</p> <p>5. Autorizimet sipas këtij neni ushtrohen vetëm brenda orarit të punës së ATK, përveç kur ATK përcakton se mbledhja e tatimit është në rrezik dhe autorizimet e tilla duhet të vihen në veprim jashtë orarit të punës, me qëllim për të mbrojtur</p>	<p>determining the person's liability according to the tax legislation in force in the Republic of Kosovo;</p> <p>4.3. retain any such book or record for as long as it may be required for determining a person's liability or for any proceeding under this law;</p> <p>4.4. require the provision of any password protecting information on the information technology record storage device;</p> <p>4.5. take possession and keep the information technology device, where the hard copy or the information technology device for keeping records has not been provided, for as long as it is necessary to copy the requested information; and</p> <p>4.6. carry out verifications on the assets and liabilities of a person where such verifications according to the TAK constitute material evidence in determining the liabilities of a person according to the tax legislation in force in the Republic of Kosovo;</p> <p>5. The powers under this Article shall be exercised only during TAK's ordinary business hours, unless the TAK determines that collection of tax is in jeopardy and that such powers must be operated outside those ordinary business hours in order to protect</p>	<p>odgovornosti lica prema poreskom zakonodavstvu na snazi u Republici Kosovo;</p> <p>4.3. zadrži takvu knjigu ili registar onoliko dugo koliko je potrebno da se utvrdi odgovornost lica ili za bilo koju radnju prema ovom zakonu;</p> <p>4.4. zahteva davanje lozinke koja štiti informacije u uređaju informacione tehnologije za čuvanje registra;</p> <p>4.5. preuzme i zadrži uređaj informacione tehnologije, tu gde kopija na papiru ili uređaj informacione tehnologije za čuvanje registara nije obezbeđena, onoliko koliko je vremena potrebno za kopiranje traženih informacija; i</p> <p>4.6. izvrši proveru u imovini i obavezama lica gde takve verifikacije prema PAK-u predstavljaju materijalni dokaz u utvrđivanje odgovornosti lica prema poreskom zakonodavstvu na snazi u Republici Kosovo;</p> <p>5. Ovlašćenja prema ovom članu se vrše samo tokom radnog vremena PAK-a, osim kada PAK utvrdi da je naplata poreza u opasnosti i takva ovlašćenja se moraju izvršiti van radnog vremena, u cilju zaštite naplate poreza.</p>
--	---	---

<p>mbledhjen e tatimit.</p> <p>6. Një zyrtar tatimor i cili ushtron një autorizim sipas këtij neni, nuk ka të drejtë të hyjë ose të qëndrojë në ndonjë objekt, nëse pas kërkesës së tatimpaguesit, zyrtari tatimor nuk paraqet autorizimin e tij. Autorizim sipas këtij neni konsiderohet kartela zyrtare nga ATK ose çfarëdo forme tjetër e përcaktuar nga ATK.</p> <p>7. Zyrtari tatimor i cili merr dhe mban regjistrat sipas këtij neni, bën një kopje të regjistrit dhe ia kthen tatimpaguesit origjinalin në kohën sa më të shkurtër.</p> <p>8. Nëse një tatimpagues nuk dorëzon informatat e kërkuara brenda afatit kohor të vendosur sipas paragrafit 1 të nenit 9 të këtij Ligji, atë e dorëzon deri në datën në të cilën është dorëzuar raporti përfundimtar i vlerësimit, nëse është në gjendje të vërtetojë se dokumentet e kërkuara nuk kanë mundur të dorëzohen me kohë për shkak të arsyeve të cilat janë jashtë kontrollit të tatimpaguesit.</p> <p>9. Çdo dokument i ofruar jashtë afatit të paraparë në paragrafin 8 të këtij neni, nuk merret në shqyrtim nga Ankesat, Bordi dhe gjykata kompetente, në çdo ankesë të mëvonshme të paraqitur nga tatimpaguesi, nëse dokumenti ka qenë ekzistues në momentin e lindjes së kontestit. Kjo zbatohet, nëse tatimpaguesit i është</p>	<p>the collection of tax.</p> <p>6. A tax official who exercises a power under this article, shall not have the right to enter or stay in any facility, if after the request of the taxpayer, the tax official does not present their powers. Powers under this article is considered an official TAK card or any other form determined by the TAK.</p> <p>7. The tax official who receives and keeps the records under this article, shall makes a copy of the record and shall return the original to the taxpayer as soon as possible.</p> <p>8. If a taxpayer does not submit the requested information within the timeframes established under paragraph 1 of Article 9, he/she may do so up to the date on which the final assessment report is submitted, if he/she is able to demonstrate that the requested documents could not be timely submitted due to causes which are beyond his/her control.</p> <p>9. Any document provided outside the timeframe foreseen in paragraph 8 of this article, shall not be considered by the Appeals Board, and the competent court, in any subsequent appeal submitted by the taxpayer, if the document existed at the time of the dispute. This applies, if a specific written request has been sent to the</p>	<p>6. Poreski službenik koji vrši ovlašćenje prema ovom članu nema pravo da ulazi ili boravi u bilo kom objektu, ako na zahtev poreskog obveznika poreski službenik ne pokaže svoje ovlašćenje. Ovlašćenje prema ovom članu se predočava službenom karticom PAK-a ili bilo kojim drugim oblikom koji odredi PAK.</p> <p>7. Poreski službenik koji prima i vodi registre prema ovom članu pravi kopiju registra i vraća original poreskom obvezniku što je pre moguće.</p> <p>8. Ako poreski obveznik ne dostavi tražene informacije u roku određenom prema stavu 1. člana 9. ovog zakona, on ih dostavlja do dana podnošenja konačnog izveštaja o proceni, ako je u mogućnosti da dokaže da traženi dokumenti nisu mogli biti dostavljeni na vreme iz razloga koji su van kontrole poreskog obveznika.</p> <p>9. Bilo koji dokument koji je dostavljen van roka predviđenog u stavu 8. ovog člana, Žalbeno veće, Odbor i nadležni sud ne razmatraju ni u jednoj naknadnoj žalbi koju je podneo poreski obveznik, ako je dokument postojao u vreme kada je spor nastao. Ovo važi ako je poreskom obvezniku dostavljen poseban pismeni</p>
---	---	--

<p>dërguar një kërkesë specifike me shkrim, e cila përshkruan informatat apo dokumentet e kërkuara dhe përfshinë paralajmërimin për tatimpaguesin lidhur me dispozitat e këtij paragrafi.</p> <p>10. Çdo kontroll i kryer nga ATK sipas autorizimit të dhënë në këtë nen, bazohet në një metodë të përzgjedhjes së rasteve që minimizon mundësinë për tejkalimin e autorizimit të ATK. Kontrolli paraprihet nga njoftimi për tatimpaguesin për kontrollin në pritje, i cili do të përfshijë të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesit në lidhje me një kontroll.</p> <p>11. Ministri nxjerrë akt nënligjor për të përshkruar procedurat që duhet ndjekur në fillimin, kryerjen dhe përfundimin e një kontrolli.</p>	<p>taxpayer, which describes the requested information or documents and includes a warning to the taxpayer regarding the provisions of this paragraph.</p> <p>10. Any audit conducted by TAK under the authority granted in this Article, shall be based on a case selection method that minimizes the potential for abuse of TAK powers. The audit is preceded by notification to the taxpayer of the pending audit, which will include the rights and obligations of the taxpayer in relation to an audit.</p> <p>11. The Minister shall issue a by-law to describe the procedures which must be followed in initiating, conducting, and finalizing an audit.</p>	<p>zahtev koji opisuje tražene informacije ili dokumente i sadrži upozorenje poreskom obvezniku u vezi sa odredbama ovog stava.</p> <p>10. Svaka kontrola koju vrši PAK u skladu sa ovlašćenjem datim u ovom članu, zasniva se na metodi odabira slučaja koja minimizuje mogućnost prekoračenja ovlašćenja PAK-a. Reviziji prethodi obaveštavanje poreskog obveznika o reviziji koja je u toku, a koje uključuje prava i obaveze poreskog obveznika u vezi sa revizijom.</p> <p>11. Ministar donosi podzakonski akt kojim se opisuje procedure koje treba poštovati pri pokretanju, obavljanju i završetku inspekcijskog nadzora.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Mbledhja e informatave ose provave</p> <p>1. Administrata Tatimore e Kosovës me anë të njoftimit me shkrim, mund të kërkojë nga një person i detyruar të paguajë tatim apo nga një person që nuk ka detyrim të tillë, të:</p> <p>1.1. përgatisë dokumente të caktuara të kërkuara me njoftim brenda shtatë (7) ditëve kalendarike pas dorëzimit të njoftimit, apo brenda periudhës tjetër kohore, siç ATK dhe personi, nga i cili</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Collection of Information or Evidence</p> <p>1. The Tax Administration of Kosovo may, by notice in writing, require a person whether that person is liable to pay tax or not, to:</p> <p>1.1. produce certain documents required by the notice within seven days (7) of the delivery of the notice, or such other period of time as may be agreed between TAK and the person from whom</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Prikupljanje informacija ili dokaza</p> <p>1. Poreska administracija Kosova putem pisanog obaveštenja, može da zahteva od lica koje je u obavezi da plaća porez ili od lica koje nema takvu obavezu da:</p> <p>1.1. pripremi određene dokumente tražene obaveštenjem u roku od sedam (7) kalendarskih dana nakon dostavljanja obaveštenja, ili u narednom vremenskom periodu,</p>

<p>janë kërkuar dokumentet, pajtohen. Nëse dokumentet janë kërkuar nga një vend jashtë Kosovës, periudha për dërgimin e dokumenteve zgjatet së paku për tridhjetë (30) ditë kalendarike, e cila mund të vazhdohet bazuar në rrethanat e rastit aktual;</p> <p>1.2. merr pjesë në kohën dhe vendin e shënuar në njoftim, që duhet të jetë së paku dyzetetë (48) orë pas dorëzimit të njoftimit, për t'u intervistuar nga ATK për këtë qëllim, lidhur me detyrimin tatimor të atij personi ose ndonjë personi tjetër, ose ndonjë libri, regjistri, informate të ruajtur në pajisjet e teknologjisë informative që është nën kontrollin e atij personi.</p> <p>2. Aty ku njoftimi kërkon përgatitjen e dokumenteve ose regjistrave tjera, dokumentet ose regjistrat e tillë përshkruhen me saktësi.</p> <p>3. Çdo personi, i cili nuk paraqitet në kohën dhe vendin e specifikuar sipas njoftimit, si dhe nuk jep informata në përgjigje të kërkesave për informata të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, i shqiptohet gjoba e përcaktuar në nenin 101 të këtij Ligji.</p> <p>4. Gjoba e paraparë në paragrafin 3 të këtij neni, nuk shqiptohet në rast se personi nuk është paraqitur në kohën e specifikuar për t'u intervistuar, për shkak të ndonjë</p>	<p>documents are requested. If documents are requested from a location outside Kosovo, the period for delivery of documents shall be extended accordingly for a period of thirty (30) calendar days, which may be extended based on the circumstances of the current case;</p> <p>1.2. attend at the time and place designated in the notice, which must be at least 48 hours after the delivery of the notice, TAK's interview for this purpose, concerning the tax liability of that person or any other person, or any book, record, information stored in information technology devices in the control of that person.</p> <p>2. Where the notice requires the production of documents or other records, such documents or records must be precisely described.</p> <p>3. Any person who fails to appear at the time and place specified, or to provide information, in response to the requests for information described in paragraph 1 of this Article, shall be issued the fine defined under Article 101 of this Law.</p> <p>4. The fine provided for in paragraph 3 of this article is not imposed in the event that the person did not appear at the specified time to be interviewed, due to some</p>	<p>kako se saglase PAK i lice od koga su tražena dokumenta. Ako se traže dokumenti iz neke druge zemlje, period za slanje dokumenata se produžava za najmanje trideset (30) kalendarskih dana, koji se može produžiti na osnovu okolnosti aktuelnog slučaja;</p> <p>1.2. učestvuje u vreme i na mestu naznačenom u obaveštenju, koje mora biti najmanje četrdeset osam (48) sati nakon dostavljanja obaveštenja, da bude intervjuisano od strane PAK-a u ovu svrhu, u vezi sa poreskom obavezom tog lica ili bilo kog drugog lica, ili bilo koje knjige, evidencije, informacije pohranjene u uređaju informacione tehnologije koja je pod kontrolom tog lica.</p> <p>2. Kada obaveštenje zahteva pripremu drugih dokumenata ili zapisa, takvi dokumenti ili zapisi će biti tačno opisani.</p> <p>3. Svako lice koje se ne pojavi u vreme i na mestu određenom obaveštenjem, kao i ne pruži informacije u odgovoru na zahteve za informacijama iz stava 1. ovog člana, kazniće se novčanom kaznom iz člana 101. ovog zakona.</p> <p>4. Novčana kazna iz stava 3. ovog člana ne izriče se u slučaju da se lice nije pojavilo u naznačeno vreme na razgovor, zbog neke neizbežne prepreke, koja mora</p>
--	--	--

<p>pengese të paevitueshme, e cila duhet të arsyetohet. Në këto raste ATK përcakton një kohë tjetër dhe në rast se personi përsëri nuk paraqitet në kohë, i shqiptohet gjoba nga paragrafi 3 i këtij neni, me kusht që sërish të mos ketë ndodhur një pengesë e paevitueshme që duhet të arsyetohet.</p>	<p>unavoidable obstacle, which must be justified. In these cases, the TAK shall determine another time and in the event that the person does not appear on time again, the fine from paragraph 3 of this article is imposed, provided that there has not been an unavoidable obstacle that must be justified.</p>	<p>biti opravdana. U tim slučajevima PAK određuje drugi put, a u slučaju da se lice ponovo ne pojavi, izriče se novčana kazna iz stava 3. ovog člana, pod uslovom da nije postojala neizbežna prepreka koja mora biti opravdana.</p>
<p>5. Për qëllime të mbikëqyrjes së fakteve që janë relevante me tatime, institucionet financiare duhet të dorëzojnë në ATK informatat për të gjitha transaksionet vendore dhe ndërkombëtare, në valutën vendore dhe të huaj, të llogarive të personave juridik, personave fizikë afarist dhe jo-afarist, përfshirë këtu edhe depozitat e kursimeve.</p>	<p>5. For the purpose of supervising facts that are relevant to taxes, financial institutions must submit to the TAK information on all domestic and international transactions transactions in local and foreign currency in the accounts of legal entities, business and non-business natural persons, including savings deposits.</p>	<p>5. Za potrebe nadzora činjenica koje su relevantne za poreze, finansijske institucije moraju dostaviti PAK-u informacije za sve domaće i međunarodne transakcije transakcijama u domaćoj i stranoj valuti na računima pravnih lica, poslovnih i neposlovnih fizičkih lica, uključujući depozite štednje.</p>
<p>6. Për qëllime të mbikëqyrjes së fakteve që janë relevante me tatime, Noterët duhet të dorëzojnë në ATK informatat për të gjitha kontratat e shitblerjeve nga personat juridik, personat fizikë afarist dhe personat fizikë jo-afarist.</p>	<p>6. For the purpose of supervising the facts that are relevant to taxes, Notaries must submit to the TAK information on all sales contracts from legal entities, business natural persons and non-business natural persons.</p>	<p>6. U cilju nadgledanja činjenica koje se odnose na poreze, javni beležnici moraju PAK-u da dostave informacije o svim kupoprodajnim ugovorima od pravnih lica, fizičkih poslovnih lica i neposlovnih fizičkih lica.</p>
<p>7. Informatat sipas paragrafit 5 dhe 6 të këtij neni do të dorëzohen nga bankat dhe Noterët përmes teknologjisë informative në dispozicion, në baza mujore, tremujore ose sipas kërkesës.</p>	<p>7. The information according to paragraphs 5 and 6 of this Article will be submitted by banks and Notaries through available information technology, on a monthly, quarterly basis or upon request.</p>	<p>7. Informacije iz stava 5. i 6. ovog člana dostavljaju banke i notari putem raspoložive informacione tehnologije, mesečno, tromesečno ili na zahtev.</p>
<p>8. Me kërkesë të veçantë të ATK, institucionet financiare obligohen të sigurojnë të dhëna të referuara në paragrafin 5 të këtij neni edhe brenda</p>	<p>8. At the special request of the TAK, financial institutions are obliged to provide data referred to in paragraph 5 of this article within other deadlines, except those</p>	<p>8. Na poseban zahtev PAK-a, finansijske institucije su dužne da dostave podatke iz stava 5. ovog člana u drugim rokovima, osim onih predviđenih u stavu 7. ovog</p>

<p>afateve të tjera, përveç atyre të parashikuara në paragrafin 7 të këtij neni, përfshirë të dhënat për transaksionet në të gjitha llogaritë.</p> <p>9. Informatat bankare nga institucionet financiare të licencuara, mund të kërkojnë në mënyrë individuale, grupore apo në ndonjë mënyrë tjetër të përcaktuar me ndonjë ligj të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.</p> <p>10. Ky nen nuk zbatohet për informatat e klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi për klasifikimin e dokumenteve dhe informacionit.</p> <p>11. Paragrafi 10 i këtij neni apo ndonjë dispozitë tjetër që lidhet me konfidencialitetin bankar, nuk aplikohet për bankat dhe institucionet tjera financiare, të cilat kërkojnë të njoftojnë ATK.</p> <p>12. Administrata Tatimore e Kosovës ka të drejtë që për qëllime tatimore të përdorë informata në formë të fotove të momentit apo video inqizime, të bëra nga publikimet e tatimpaguesit.</p> <p>13. Ministri nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.</p>	<p>provided for in paragraph 7 of this article, including data on transactions in all accounts.</p> <p>9. Bank information from licensed financial institutions can be requested individually, in groups or in any other way determined by any applicable law in the Republic of Kosovo.</p> <p>10. This article does not apply to information classified according to the legislation in force for the classification of documents and information.</p> <p>11. Paragraph 10 of this article or any other provision related to banking confidentiality, shall not apply to banks and other financial institutions, which are required to notify the TAK.</p> <p>12. The Kosovo Tax Administration has the right to use information in the form of current photos or videos made from the taxpayer's publications, for tax purposes.</p> <p>13. The minister shall issue a by-law on the implementation of this article.</p>	<p>člana, uključujući podatke o transakcijama na svim računima.</p> <p>9. Bankarske informacije od licenciranih finansijskih institucija mogu se tražiti pojedinačno, u grupama ili na bilo koji drugi način utvrđen bilo kojim zakonom koji se primenjuje u Republici Kosovo.</p> <p>10. Ovaj član se ne primenjuje na informacije klasifikovane u skladu sa zakona koji su na snazi o klasifikaciji dokumenata i informacija.</p> <p>11. Stav 10. ovog člana ili bilo koja druga odredba koja se odnosi na bankarsku poverljivost, ne primenjuje se na banke i druge finansijske institucije, koje su obavezne da obaveste PAK.</p> <p>12. Poreska administracija Kosova ima pravo da koristi informacije u obliku aktuelnih fotografija, napravljenih iz publikacija poreskog obveznika, u poreske svrhe.</p> <p>13. Ministar donosi podzakonski akt za sprovođenje ovog člana.</p>
---	---	--

<p align="center">Neni 10 Shkëmbimi i informacionit për qëllime ndërkombëtare</p>	<p align="center">Article 10 Exchange of Information for International Purposes</p>	<p align="center">Član 10 Razmena informacija u međunarodne svrhe</p>
<p>1. Me kërkesë të ATK, çdo person duhet të sigurojë çdo informacion, përfshirë por pa u kufizuar në informacionin e mbajtur nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, të cilat mund të kërkohen për qëllimet e një konvente ndërkombëtare për çështjet tatimore, përfshirë Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD), Marrëveshjet për Shkëmbimin e Informatave Tatimore (MSHIT) ose për qëllimin e një marrëveshje ndërkombëtare që ofron ndihmë administrative në çështjet tatimore (në tekstin e mëtejshëm: Marrëveshje Ndërkombëtare).</p> <p>2. Pa kufizim të detyrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, zbatohen të njëjtat rregulla si për informacionin përkatës për qëllimet e tatimeve vendore, përveç nëse parashikohet ndryshe në Marrëveshjen Ndërkombëtare, sipas së cilës kërkohet informacioni.</p> <p>3. Ministri nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.</p>	<p>1. At the request of TAK, any person must provide any information, including but not limited to information held by banks and other financial institutions, which may be required for the purposes of an international convention on tax matters, including Double taxation agreements (DTAs), Tax Information Exchange Agreements (TIEAs) or for the purpose of an international agreement that provides administrative assistance in tax matters (hereinafter: International Agreement).</p> <p>2. Without limiting the obligation under paragraph 1 of this article, the same rules shall apply for relevant information for local tax purposes, unless otherwise provided in the International Agreement under which the information is required.</p> <p>3. The minister shall issue a by-law on the implementation of this article.</p>	<p>1. Na zahtev PAK-a, svako lice mora pružiti bilo koju informaciju, uključujući, ali ne ograničavajući se na informacije koje poseduju banke i druge finansijske institucije, a koje mogu biti potrebne za potrebe međunarodne konvencije o poreskim pitanjima, uključujući sporazume o eliminaciji dvostrukog oporezivanja (SEDO), sporazume o razmeni poreznih informacija (SRPI) ili u svrhu međunarodnog ugovora koji pruža administrativnu pomoć u poreskim pitanjima (u daljem tekstu: Međunarodni ugovor).</p> <p>2. Bez ograničavanja obaveze iz stava 1. ovog člana, važe ista pravila kao i za relevantne informacije za potrebe lokalnog poreza, osim ako je drugačije predviđeno Međunarodnim ugovorom prema kojem se informacije traže.</p> <p>3. Ministar donosi podzakonski akt za sprovođenje ovog člana.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 11 Negociatat për Marrëveshje Ndërkombëtare</p> <p>1. Negociatat për Marrëveshje Ndërkombëtare për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe çështje të tjera të lidhura me tatimin dhe nënshkrimi i tyre në nivelin teknik bëhet nga Ministria përgjegjëse për Financa (në tekstin e mëtejme: Ministria) në bashkëpunim me ATK në përputhje me dispozitat e Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare.</p> <p>2. Zbatimi i dispozitave të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale ose konventave në fushën e tatimeve, bëhet nga ATK.</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Negotiations for International Agreements</p> <p>1. Negotiations for International Double Taxation Agreements and other tax-related issues and their signing at the technical level, are performed by the Ministry responsible for Finance (hereinafter: the Ministry) in cooperation with the TAK in accordance with the provisions of the Law on International Agreements.</p> <p>2. The implementation of the provisions of bilateral and multilateral agreements or conventions in the field of taxes, is performed by the TAK.</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Pregovori za Međunarodne Ugovore</p> <p>1. Pregovore za međunarodne ugovore za izbegavanje dvostrukog oporezivanja i druga pitanja u vezi sa oporezivanjem i njihovo potpisivanje na tehničkom nivou vrši Ministarstvo nadležno za poslove finansija (u daljem tekstu: Ministarstvo) u saradnji sa PAK-om u skladu sa odredbama Zakona o međunarodnim ugovorima.</p> <p>2. Sprovođenje odredbi bilateralnih i multilateralnih sporazuma ili konvencija u oblasti poreza vrši PAK.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Obligimet e përfaqësuesve juridik dhe menaxherëve të pasurisë</p> <p>1. Përfaqësuesit e autorizuar, përgjegjës të personave fizik, juridik, ortakërive, si dhe menaxherët apo drejtorët e shoqatave të pa inkorporuara apo organizatave, duhet t'i përmbushin obligimet tatimore për personat, ortakëritë dhe shoqatat apo organizatat që ata i përfaqësojnë ose i menaxhojnë. Nëse shoqatat apo organizatat nuk kanë menaxher apo drejtor, anëtarët e tyre apo partnerët duhet t'i përmbushin obligimet sipas këtij paragrafi. Ata duhet të sigurohen se tatimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Obligations of legal representatives and asset managers</p> <p>1. The responsible authorized representatives of natural, legal persons and partnerships and the managers or directors of unincorporated associations or organizations have to fulfill the tax obligation for the persons, partnerships and associations or organizations they represent or manage. To the extent that unincorporated associations or organizations do not have a manager or director, their members or partners have to fulfill the obligation under this paragraph.</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Obaveze zakonskih zastupnika i upravnika imovine</p> <p>1. Ovlašćeni, odgovorni zastupnici fizičkih, pravnih lica, ortačkih društava, kao i rukovodioci ili direktori neinkorporiranih udruženja ili organizacija, dužni su da ispune poreske obaveze za lica, ortačka društva i udruženja ili organizacije koje predstavljaju ili kojima upravljaju. Ako udruženja ili organizacije nemaju rukovodioca ili direktora, njihovi članovi ili partneri moraju ispuniti obaveze iz ovog stava. Oni moraju obezbediti da su</p>

<p>janë të deklaruara në kohë, saktë dhe të paguara.</p> <p>2. Obligimi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni zbatohet edhe për çdo person që ka dominim dhe/ose kontroll operativ mbi një biznes apo një pasuri dhe faktikisht përdor kompetencat e përfaqësuesve përgjegjës.</p> <p>3. Ndërprerja e autorizimit për të përfaqësuar apo për të menaxhuar, si dhe anulimi i dominimit dhe/ose kontrollit operativ, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, nuk ndikon në obligimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, për periudhat në të cilat ky autorizim për të përfaqësuar dhe menaxhuar ka qenë i vlefshëm apo dominimi dhe kontrolli janë ushtruar.</p> <p>4. Obligimet e përfaqësuesve ligjor dhe menaxherëve të pasurisë së përcaktuar me këtë nen, nuk i liron personat fizikë, ortakët e ortakërisë, apo anëtarët e shoqërive, nga obligimi i tyre që me saktësi dhe me kohë të deklarojnë dhe paguajnë shumën e saktë të tatimit.</p> <p>5. Këshilltari Tatimor është një person me trajnim të avansuar dhe njohuri të legjislacionit tatimor dhe ndihmon tatimpaguesin gjatë procedurave tatimore në mënyrë që të deklaratat tatimore të jenë në përputhje me legjislacionin tatimor dhe përfitojnë nga zbritjet dhe rimbursimet e</p>	<p>They must ensure that taxes are declared on time, correctly, and paid.</p> <p>2. The obligation defined in paragraph 1 of this article shall also apply to any person who has dominion and/or operational control over a business or an asset and actually uses the powers of responsible representatives.</p> <p>3. Termination of the authority to represent or to manage and the termination of dominion and/or operational control as defined in paragraph 2 of this Article, shall not affect the obligations pursuant to paragraphs 1 and 2 of this Article, for periods in which the authority to represent or to manage was valid or dominion and control were exercised.</p> <p>4. The obligations of legal representatives and asset managers set by this article do not relieve natural persons, partners of partnerships, or members of associations from their obligation to accurately and timely file and pay their correct amount of tax.</p> <p>5. Tax Advisor is a person with advanced training and knowledge of tax legislation and they help the taxpayer during the tax procedures so that the tax declarations are in accordance with the tax legislation and benefit from the deductions and refunds determined by the legislation in force.</p>	<p>porezi prijavljeni pravilno i na vreme, i da su plaćeni.</p> <p>2. Obaveza definisana u stavu 1. ovog člana takođe se odnosi na svako lice koje ima dominaciju i/ili operativnu kontrolu nad poslovanjem ili imovinom i stvarno koristi ovlašćenja odgovornih zastupnika.</p> <p>3. Prestanak ovlašćenja za zastupanje ili upravljanje, kao i ukidanje dominacije i/ili operativne kontrole, iz stava 2. ovog člana, ne utiče na obaveze iz stava 1. i 2. ovog člana, za periode u kojima je ovo ovlašćenje za zastupanje i upravljanje važilo ili je vršena dominacija i kontrola.</p> <p>4. Obaveze zakonskih zastupnika i upravnika imovine definisane ovim članom ne oslobađaju fizička lica, ortačke članove ili članove privrednih društava obaveze da tačno i blagovremeno prijave i plate tačan iznos poreza.</p> <p>5. Poreski savetnik je lice sa naprednom obukom i poznavanjem poreskog zakonodavstva i pomaže poreskom obvezniku tokom poreskih procedura kako bi poreske prijave bile u skladu sa poreskim zakonodavstvom i koristile odbitke i povraćaje utvrđene zakonima</p>
--	---	--

<p>përcaktuara me legjislacionin në fuqi.</p> <p>6. Administrata Tatimore e Kosovës bën licensimin e Këshilltarëve Tatimor pas përfundimit të trajnimit dhe testimit të suksesshëm.</p> <p>7. Ministri nxjerrë akt nënligjor për kriteret, rregullat dhe procedurat për zbatimin e paragrafit 5 dhe 6 të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI IV DEKLARIMI DHE VLERESIMI I TATIMIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Deklaratat tatimore</p> <p>1. Çdo person që i nënshtrohet çdo lloj tatimi sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, dorëzon në ATK ose tek bankat apo institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: BQK), një deklaratë të plotësuar sipas kërkesave të këtij Ligji.</p> <p>2. Kur një person obligohet të dorëzojë një deklaratë tatimore, por nuk e ka bërë atë, ATK ka autorizim të kërkojë që personi i tillë të dorëzojë një deklaratë tatimore. Kur kërkesa e tillë nuk është plotësuar, ATK mundet të ushtrojë autorizimin e paraparë</p>	<p>6. The Tax Administration of Kosovo licenses Tax Advisors after the successful completion of training and testing.</p> <p>7. The Minister issues a sub-legal act on the criteria, rules and procedures for the implementation of paragraphs 5 and 6 of this article.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER IV TAX DECLARATION AND ASSESSMENT</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Tax Declarations</p> <p>1. Every person who is subject to any type of tax according to the legislation in force in the Republic of Kosovo, shall submit to the TAK or to banks or financial institutions licensed by the Central Bank of the Republic of Kosovo (hereinafter: the CBK), a declaration completed according to the requirements of this Law.</p> <p>2. When a person is obliged to submit a tax declaration, but has not done so, the TAK shall have the authority to require that such person submit a tax declaration. Where such a requirement is not met, the TAK may exercise the authority provided in Article 15</p>	<p>na snazi. .</p> <p>6. Poreska uprava Kosova licencira poreske savetnike nakon uspešno završene obuke i testiranja.</p> <p>7. Ministarstvo donosi podzakonski akt o kriterijumima, pravilima i procedurama za sprovođenje stava 5. i 6. ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE IV PORESKA PRIJAVA I PROCENA</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Poreske prijave</p> <p>1. Svako lice koje podleže bilo kojoj vrsti poreza u skladu sa zakonodavstvom na snazi u Republici Kosovo, podnosi se PAK-u ili bankama ili finansijskim institucijama licenciranim od strane Centralne Banke Republike Kosovo (u daljem tekstu: CBRK), prijavu popunjenu u skladu sa zahtevima ovog zakona.</p> <p>2. Kada je lice dužno da podnese poresku prijavu, ali to nije učinilo, PAK ima ovlašćenje da zahteva od tog lica da podnese poresku prijavu. Kada takav zahtev nije ispunjen, PAK može izvršiti ovlašćenje predviđeno članom 15. ovog</p>
--	--	---

<p>në nenin 15 të këtij Ligji.</p> <p>3. Deklarata tatimore dorëzohet në formën e përgatitur nga ATK, e përcjellë me udhëzimet përkatëse.</p> <p>4. Deklarata tatimore përfshin numrin identifikues të tatimpaguesit, si: numrin unik identifikues apo numrin fiskal, llogaritjen e detyrimit tatimor dhe të gjitha informatat tjera sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>5. Deklarata tatimore nënshkruhet nga tatimpaguesi ose përfaqësuesi i tatimpaguesit nën ndëshkimin me përgjegjësi penale për dhënie të informatave të rreme lidhur me këtë. Nëse deklarata tatimore është përgatitur nga një këshilltar tatimor, i njëjti nënshkruan deklaratën dhe jep numrin e tij identifikues si tatimpagues. Deklarata tatimore e cila dorëzohet në mënyrë elektronike konsiderohet e nënshkruar. ATK nuk pranon:</p> <p>5.1. asnjë kreditim të TVSh së zbritshme, i cili nuk është mbështetur me fatura të vërteta dhe të sakta; dhe</p> <p>5.2. çdo shpenzim nga blerjet që lidhen me mallrat dhe/ose shërbimet, të cilat nuk janë të faturuara ose të dokumentuara si të vërteta dhe të sakta, për qëllime të tatimeve në të ardhura.</p>	<p>of this law.</p> <p>3. The tax declaration shall be submitted in the form prepared by the TAK, accompanied by the relevant instructions.</p> <p>4. The tax declaration shall include the identification number of the taxpayer, such as: the unique identification number or the fiscal number, the calculation of the tax liability and all other information according to the legislation in force.</p> <p>5. The tax declaration shall be signed by the taxpayer or taxpayer representative under the penalty of criminal liability for providing false information therein. If the tax declaration is prepared by a tax advisor, the same shall sign the declaration and provide their identification number as a taxpayer. The tax declaration which is submitted electronically is considered signed. The TAK shall not accept:</p> <p>5.1. any crediting of deductible VAT, which is not supported by true and correct invoices; and</p> <p>5.2. any purchase expenses related to goods and/or services that are not invoiced or documented as true and correct for income tax purposes.</p>	<p>zakona.</p> <p>3. Poreska prijava se podnosi u obrascu pripremljenom od strane PAK-a, uz odgovarajuća uputstva.</p> <p>4. Poreska prijava sadrži identifikacioni broj poreskog obveznika, kao što su: jedinstveni matični broj ili fiskalni broj, obračun poreske obaveze i sve druge podatke u skladu sa zakonima na snazi.</p> <p>5. Poresku prijavu potpisuje poreski obveznik ili predstavnik poreskog obveznika pod krivičnom kaznom za davanje lažnih podataka u vezi sa tim. Ako poresku prijavu sastavlja poreski savetnik, isti potpisuje prijavu i daje svoj matični broj kao poreskog obveznika. Poreska prijava koja se podnosi elektronskim putem smatra se potpisanom. ATK ne prihvata:</p> <p>5.1. nikakav kredit odbitnog PDV-a, koji nije potkrijepljen istinitim i ispravnim fakturama; i</p> <p>5.2. nijedan trošak kupovine koji se odnosi na robu i/ili usluge koje nisu fakturisane ili dokumentovane kao istinite i tačne za potrebe poreza na dobit.</p>
---	--	---

<p>6. Data për dorëzimin e një deklarate tatimore përcaktohet në legjislacionin e lidhur me tatimin përkatës.</p> <p>7. Nëse data e deklarimit e përcaktuar në legjislacion nuk është ditë pune në Republikën e Kosovës, datë e deklarimit do të jetë dita e parë e punës që pason pas asaj date.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Vetë-vlerësimi</p> <p>1. Aty ku një person dorëzon një deklarate tatimore të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi, tatimi i deklaruar si detyrim, nëse ka të tillë, në deklaratën tatimore trajtohet si vetë-vlerësim i tatimpaguesit për detyrimin tatimor të pagueshëm dhe të saktë.</p> <p>2. Tatimpaguesi mund të dorëzojë një ndryshim të deklaratës tatimore, brenda tre (3) viteve pas datës obligative kur deklarata është kërkuar të dorëzohet fillimisht, nëse më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar paraprakisht.</p> <p>3. Kur tatimpaguesi kupton para kalimit të periudhës së vlerësimit, se një deklarate e dërguar nga ai ose për atë është e pasaktë apo e pakompletuar dhe kjo mund të shpie apo vetëm e ka shpjerë në nën-deklarim të tatimit apo mbi-deklarim të rimbursimit të tatimeve dhe kredive, ai është i obliguar të deklarojë këtë pa vonesë dhe të bëjë</p>	<p>6. The date for submitting a tax declaration shall be prescribed in the legislation imposing the tax.</p> <p>7. If the filing date prescribed in legislation is not a business day in the Republic of Kosovo, the filing date shall be the first business day thereafter.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Self-assessment</p> <p>1. Where a person submits a tax declaration required under the legislation in force, the tax stated as due, if any, on the tax form shall be treated as the taxpayer's self-assessment of tax payable and properly due.</p> <p>2. The taxpayer may submit an amendment to the tax declaration within three (3) years after the mandatory date when the declaration was submitted, if they later discover an error in the tax declaration they previously submitted.</p> <p>3. Where a taxpayer realizes before the period for an assessment has elapsed that a return submitted by him or her or for him or her is incorrect or incomplete and that this can lead or has already led to an understatement of tax or overstatement of tax refunds and credits, he or she shall be obliged to indicate this without undue delay</p>	<p>6. Datum podnošenja poreske prijave određuje se poreskim zakonodavstvom.</p> <p>7. Ako datum prijave određen zakonodavstvom nije radni dan u Republici Kosovo, datum prijave biće prvi radni dan koji sledi nakon toga datuma.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Samoprocena</p> <p>1. Kada lice podnese poresku prijavu koja se zahteva prema važećem zakonu, porez koji je prijavljen kao obaveza, ako postoji, u poreskoj prijavi se tretira kao samoprocena poreske obaveze poreske obaveze koja se plaća i koja je tačna.</p> <p>2. Poreski obveznik može da podnese izmenu poreske prijave u roku od tri (3) godine od obaveznog datuma kada je podneta prijava, ako kasnije otkrije grešku u poreskoj prijavi koju je prethodno podneo.</p> <p>3. Kada poreski obveznik shvati pre isteka perioda procene, da je prijava poslata od njega ili za njega netačna ili nepotpuna i to može dovesti ili je već dovelo do nedovoljnog prijavljivanja poreza ili prevelikog prijavljivanja povraćaja poreza i kredita, dužan je to bez odlaganja da izjavi i da izvrši</p>
--	--	---

<p>korrigjimet e nevojshme.</p> <p>4. Obligimi i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni është i vlefshëm edhe mbi titullarin e ardhshëm të tatimpaguesit apo tatimpaguesin në bazë të nenit 12 të këtij Ligji. Obligimi për njoftim aplikohet kur kushtet për lirim nga tatimet, zvogëlimet tatimore apo privilegjet tjera tatimore pushojnë së ekzistuari, qoftë plotësisht apo pjesërisht.</p> <p>5. Ndryshimi i deklaratës shoqërohet me çdo detyrim tatimor shtesë ose, nëse është i zbatueshëm, me një kërkesë për kreditim kundrejt detyrimit tjetër të tanishëm apo të ardhshëm, ose me një rikthim për tatimin e paguar tepër. Ndryshimi i deklaratës duhet të jetë i dokumentuar përmes regjistrimeve.</p> <p>6. Në zbatim të paragrafit 2 të këtij neni, ndryshimi i deklaratës tatimore për TVSh për ndonjë periudhë tatimore më të hershme se sa periudha e vlerësuar nga ATK, lejohet vetëm me aprovimin nga ATK.</p> <p>7. Përveç nga ajo e paraparë në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 110 të këtij Ligji, për qëllime të përcaktimit të sanksioneve sipas këtij Ligji, asnjë deklaratë tatimore ndryshuese për një periudhë tatimore nuk prodhon efekt pasi ATK të ketë ushtruar kompetencën e saj sipas nenit 8 dhe/ose 9 të këtij Ligji, në lidhje me atë periudhë</p>	<p>and to effect the necessary corrections.</p> <p>4. The obligation defined in paragraph 3 of this article is also valid on the future holder of the taxpayer or the taxpayer based on article 12 of this Law. The notification obligation shall apply where the conditions for tax exemption, tax reduction or other tax privileges cease to exist, whether in full or in part.</p> <p>5. The amended tax declaration must be accompanied by any additional tax due or, if applicable, a request for credit against another liability (current or future), or a refund of the excess tax paid. The change in the statement must be documented through records.</p> <p>6. Pursuant to paragraph 2 of this article, the amendment of the VAT tax declaration for any earlier tax period than the period assessed by the TAK, is only allowed with TAK approval.</p> <p>7. Except as provided in paragraphs 1 and 2 of Article 110 of this law, for the purposes of determining sanctions under this law, no amended tax declarations for a tax period will have any effect after the TAK has exercised any power under Article 8 or 9 of this law, in relation to that tax period, and has commenced a tax investigation with</p>	<p>potrebne ispravke.</p> <p>4. Obaveza iz stava 3. ovog člana važi i za budućeg nosioca poreskog obveznika ili poreskog obveznika na osnovu člana 12. ovog zakona. Obaveza obaveštavanja se primenjuje kada, u potpunosti ili delimično, prestanu da postoje uslovi za oslobađanje od poreza, smanjenja poreza ili drugih poreskih privilegija.</p> <p>5. Promenu povrata prati bilo kakva dodatna porezna obaveza ili, ako je primenjivo, potraživanje za kredit protiv druge tekuće ili buduće obaveze, ili povrat preplaćenog poreza. Promena u izjavi mora biti dokumentovana putem evidencije.</p> <p>6. U skladu sa stavom 2. ovog člana, izmena poreske prijave PDV-a za bilo koji raniji poreski period od perioda koji je procenila PAK, dozvoljena je samo uz odobrenje PAK-a.</p> <p>7. Osim onog predviđenog u stavovima 1. i 2. člana 110. ovog zakona, za potrebe određivanja sankcija po ovom zakonu, nijedna poreska prijava koja se menja za poreski period nema nikakvo dejstvo nakon što PAK izvrši svoje nadležnosti u skladu sa članom 8. i/ili 9. ovog zakona, u odnosu na taj poreski period i započne</p>
--	---	--

<p>tatimore dhe të ketë filluar një hetim tatimor lidhur me periudhën tatimore.</p> <p>8. Në rastet kur punëdhënësi nuk kërkohet të mbajë tatimin në burim, kontributin pensional apo ndonjë kontribut tjetër, i punësuarit dorëzon një deklaratë dhe paguan detyrimin në fund të vitit ose në periudhën mujore kur i përfiton mjetet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Vlerësimi i ATK për tatimin</p> <p>1. Aty ku ATK beson në bazë të dëshmimeve se informatat e siguruar nga një person në deklaratën tatimore nuk paraqesin në mënyrë të saktë detyrimin e tij tatimor, ose kur tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar me këtë Ligj, ATK mund të bëjë një vlerësim të detyrimit të tij tatimor, përfshirë, por duke mos u kufizuar në vlerësimet që rezultojnë nga përdorimi i dokumentacionit apo transaksioneve fiktive.</p> <p>2. Përveç rasteve që paraqesin vepra penale në fushën e tatimeve apo kur shuma e obligimit tatimor mund të përcaktohet me saktësi, vlerësimet sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhen pas fillimit të procedurave të kontrollit siç janë përcaktuar në nenin 8 të këtij Ligji, nëse procedurat e tilla kërkohen. Kufizimi i vënë me këtë paragraf nuk zbatohet në dispozitat e nenit 17 të këtij Ligji.</p>	<p>respect to that tax period.</p> <p>8. In cases where the employer is not required to withhold tax, pension contribution or any other contribution, the employee shall submit a declaration and pay the liability at the end of the year or in the monthly period when they receive the funds.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 TAK's Tax Assessment</p> <p>1. Where the TAK believes that the information provided by a person on a tax declaration does not correctly disclose their tax liability, or where a taxpayer has not submitted a declaration required by this law, the TAK may make an assessment of their tax liability, including, but not limited to, assessments resulting from use of fictitious documents or transactions.</p> <p>2. Except for cases involving criminal tax offenses or where the amount of tax due can be determined with reasonable certainty, assessments under paragraph 1 of this article shall be made following the initiation of audit procedures as set in Article 8 of this law, if such procedures are required. The limitation imposed by this paragraph shall not apply to the provisions of Article 17 of this law.</p>	<p>poresku istragu u vezi sa poreskim periodom.</p> <p>8. U slučajevima kada poslodavac nije dužan da zadrži porez, penzijski doprinos ili bilo koji drugi doprinos, zaposleni podnosi prijavu i izmiruje obavezu na kraju godine ili u mesečnom periodu kada prima sredstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Procena PAK-a o Porezu</p> <p>1. Kada PAK veruje na osnovu dokaza da informacije koje je dalo lice u poreskoj prijavi ne predstavljaju tačno njegovu poresku obavezu, ili kada poreski obveznik nije podneo prijavu propisanu ovim zakonom, PAK može da izvrši procenu svoje poreske obaveze, uključujući, ali ne ograničavajući se na procene koje proizlaze iz upotrebe fiktivne dokumentacije ili transakcija.</p> <p>2. Izuzev slučajeva koji predstavljaju krivična dela iz oblasti poreza ili kada se visina poreske obaveze može tačno utvrditi, procene prema stavu 1. ovog člana vrše se nakon početka kontrolnog postupka definisanog u članu 8. ovog zakona, ako su takve procedure potrebne. Ograničenje utvrđeno ovim stavom ne primenjuje se na odredbe člana 17. ovog zakona.</p>
---	--	---

<p>3. Vlerësimi i ATK bëhet sipas gjykimit të saj më të mirë dhe bazohet në të gjitha provat të cilat i ka në dispozicion, përfshirë:</p> <p>3.1. librat, regjistrat, kuponët, faturat, si dhe informatat tjera përkatëse të tatimpaguesit;</p> <p>3.2. librat, regjistrat, kuponët, faturat, si dhe informatat tjera përkatëse të personave të tretë;</p> <p>3.3. informatat nga personat të cilët mund të verifikojnë saktësinë e deklaratave, librave dhe regjistrave të tatimpaguesit;</p> <p>3.4. informatat e tjera objektive rreth të ardhurave dhe/ose transaksioneve të tatimpaguesit, lidhur me detyrimin e tij;</p> <p>3.5. informatat e siguruara gjatë vizitave tek tatimpaguesit sikurse është paraparë në paragrafin 1 të nenit 8 të këtij Ligji; dhe</p> <p>3.6. zbatimin e këtij Ligji dhe/ose ligjeve tatimore në fuqi.</p> <p>4. Në qoftë se librat dhe regjistrat e tatimpaguesit kanë humbur apo janë shkatërruar, ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e</p>	<p>3. TAK's assessment shall be made to their best judgment and shall be based on all the evidence available to them, including:</p> <p>3.1. books, records, receipts, invoices, and other relevant information of the taxpayer;</p> <p>3.2. books, records, receipts, invoices, and other relevant information of third persons;</p> <p>3.3. information from persons who can verify the accuracy of the taxpayer's declarations, books and records;</p> <p>3.4. other objective information about a taxpayer's income and/or transactions relevant to its liability;</p> <p>3.5. information obtained during visits to taxpayers as provided in paragraph 1 of Article 8 of this law;</p> <p>3.6. implementation of this Law and/or applicable tax laws.</p> <p>4. If the books and records of the taxpayer have been lost or destroyed, or there are other circumstances that make it impossible to determine the tax liability, the TAK shall</p>	<p>3. Procena PAK-a je napravljena prema njennoj najboljoj proceni i zasnovana je na svim dokazima koji su joj dostupni, uključujući:</p> <p>3.1. knjige, registre, kupone, fakture, kao i druge relevantne podatke o poreskom obvezniku;</p> <p>3.2. knjige, registre, kupone, fakture, kao i druge relevantne informacije trećih lica;</p> <p>3.3. podatke od lica koja mogu da provere tačnost prijave, knjiga i registara poreskog obveznika;</p> <p>3.4. druge objektivne informacije o prihodima i/ili transakcijama poreskog obveznika u vezi sa njegovom obavezom;</p> <p>3.5. informacije pružene tokom poseta poreskim obveznicima kao što je predviđeno stavom 1. člana 8. ovog zakona; i</p> <p>3.6. sprovođenje ovog zakona i/ili važećih poreskih zakona.</p> <p>4. Ako su knjige i evidencije poreskog obveznika izgubljene ili uništene, ili postoje druge okolnosti koje onemogućavaju utvrđivanje poreske</p>
--	---	---

<p>detyrimin tatimor, ATK bën një vlerësim të parashikuar, i cili bazohet në mjetet, të ardhurat qarkulluese, shpenzimet e prodhimit, shpenzimet krahasuese, si dhe metodat tjera direkte dhe indirekte që lidhen me llogaritjen e detyrimit tatimor. Metodatat indirekte mund të përdoren edhe në rastet kur nuk janë dorëzuar deklaratat, si dhe në rastet në të cilat ka dyshim se nuk ka saktësi të detyrimit tatimor të deklaruar.</p>	<p>make an estimate, which is based on assets, circulating income, production expenses, comparative expenses, as well as other direct and indirect methods related to the calculation of tax liability. Indirect methods can also be used in cases where the declarations have not been submitted, as well as in cases where there is doubt that there is no accuracy of the declared tax liability.</p>	<p>obaveze, PAK vrshi procenu, koja se zasniva na imovini, prihodima u prometu, troškovima proizvodnje, uporednim troškovima, kao i druge direktne i indirektne metode vezane za obračun poreske obaveze. Indirektne metode se mogu koristiti i u slučajevima kada prijave nisu dostavljene, kao i u slučajevima kada postoji sumnja da ne postoji tačnost iskazane poreske obaveze.</p>
<p>5. Në qoftë se regjistrat e një personi të vetë-punësuar kanë humbur apo janë shkatërruar ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e shumës së kontributeve për pension dhe kontributeve tjera sipas legjislacionit në fuqi, ATK bën një vlerësim të kontributeve për pension dhe kontributeve tjera të barabartë me nivelin e detyrimit të kontributeve për periudhën e mëparshme mujore ose tremujore.</p>	<p>5. If the records of a self-employed person are lost or destroyed or other circumstances exist that make a determination of the amount of required pension contribution impossible under the legislation in force, the TAK may make an assessment of pension contributions and other contributions equal to the level of contributions due for the previous monthly or quarterly period.</p>	<p>5. Ako je evidencija samozaposlenog lica izgubljena ili uništena ili postoje druge okolnosti koje onemogućavaju utvrđivanje iznosa penzionih doprinosa i drugih doprinosa u skladu sa zakonima na snazi, PAK vrshi procenu penzijskih doprinosa i ostalih doprinosa jednakih visini obaveze doprinosa za prethodni mesečni ili tromesečni period.</p>
<p>6. Vlerësimi për tatimet e mbajtura në burim bëhet në të njëjtën mënyrë dhe i nënshtrohet dispozitave dhe kufizimeve të njëjta që janë të zbatueshme për tatimet të cilat nuk janë mbajtur në burim.</p>	<p>6. An assessment for withholding taxes shall be made in the same manner and subject to the same provisions and limitations that are applicable to taxes that are not withheld at the source.</p>	<p>6. Procena poreza po odbitku vrshi se na isti način i podleže istim odredbama i ograničenjima koja se primenjuju na poreze koji nisu zadržani.</p>
<p>7. Tatimpaguesi ka barrën e provës për të vërtetuar se ndonjë vlerësim i kryer nga ATK është i gabuar.</p>	<p>7. The taxpayer has the burden of proof to prove that any assessment made by TAK is incorrect.</p>	<p>7. Poreski obveznik ima teret dokaza da dokaže da je bilo koja procena izvršena od strane PAK-a pogrešna.</p>
<p>8. Aty ku të dhënat e ATK përmbajnë informata të mjaftueshme mbi një detyrim</p>	<p>8. Where the TAK data contain sufficient information on an unfiled liability for a tax</p>	<p>8. Kada podaci PAK-a sadrže dovoljno informacija o neprijavljenoj obavezi za</p>

<p>të padeklaruar për një periudhë tatimore, ATK bazuar në ato të dhëna mund të bëjë një vlerësim të menjëhershëm. Kur një individ deklaron një shumë të të ardhurave të cilat janë të pamjaftueshme të mbështesin shpenzimet e tij të dala për konsum personal, ATK mund të rillogarisë të ardhurat e individëve bazuar në shpenzimet e dala nga individ, duke marrë parasysh të ardhurat e periudhave të kaluara.</p>	<p>period, the TAK may make an immediate assessment based on this data. Where an individual declares an amount of income that is insufficient to support his or her expenses incurred for personal consumption, the TAK may recalculate the income of the individual on the basis of expenses incurred by the individual, taking into account income of previous periods.</p>	<p>poreski period, PAK na osnovu tih podataka može odmah da izvrši procenu. Kada pojedinac prijavi iznos prihoda koji nije dovoljan da podrži njegove troškove za ličnu potrošnju, PAK može da preračuna prihode pojedinca na osnovu troškova koje je napravio pojedinac, uzimajući u obzir prihode iz prethodnih perioda.</p>
<p>9. Për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohet zbritje nga të ardhurat bruto për shpenzimet e ndodhura brenda ose jashtë vendit, nëse ato në tërësi ose pjesërisht lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike të zhvilluar gjatë asaj periudhe tatimore dhe nëse ato janë të dokumentuara si shpenzime të ndodhura.</p>	<p>9. For determination of taxable income, the taxpayer is allowed a reduction from gross income for costs paid in or outside the country, if these costs in full or in part are in connection with their economic activity performed during that tax period and if those costs are documented as incurred expenses.</p>	<p>9. Za utvrđivanje oporezivog dohotka, poreskom obvezniku je dozvoljen odbitak od bruto prihoda za troškove nastale u zemlji ili van nje, ako su u potpunosti ili delimično povezani sa njegovom privrednom aktivnošću koja se razvijala u tom poreskom periodu i ako su dokumentovani kao nastali rashodi.</p>
<p>10. Përjashtim nga paragrafi 9 i këtij neni, bëjnë shpenzimet që lidhen me tatimin e mbajtur në burim, të cilat kushtëzohen me pagesë.</p>	<p>10. From paragraph 9 of this article are excluded the expenses related to withholding tax, which are conditional on payment.</p>	<p>10. Izuzetak od stava 9. ovog člana su izdaci u vezi sa porezom po odbitku, koji su uslovljeni plaćanjem.</p>
<p>11. Kur një tatimpagues çregjistrohet vullnetarisht apo ndryshe, regjistrimi është refuzuar nga ATK shkaku se tatimpaguesi nuk ka mundur të gjendet, apo regjistrimi i tatimpaguesit është anuluar në pajtim me dispozitat e nenit 19 të këtij Ligji, çregjistrimi i tillë, refuzim regjistrimi, apo anulim regjistrimi publikohet në ueb faqen zyrtare të ATK. Çdo shpenzim i</p>	<p>11. Where a taxpayer has been de-registered (voluntarily or otherwise), registration has been refused by TAK because the taxpayer was unable to be located, or the taxpayer's registration has been canceled in accordance with the provisions of Article 19 of this law, such de-registration, registration refusal, or registration cancellation shall be published on TAK's official website. Any expenses</p>	<p>11. Kada se poreski obveznik odjavi dobrovoljno ili na drugi način, PAK odbija registraciju jer poreski obveznik nije mogao da bude pronađen, ili je registracija poreskog obveznika poništena u skladu sa odredbama člana 19. ovog zakona, takva odjava, odbijanje registracije, ili otkazivanje registracije je objavljeno na zvaničnom sajtu PAK-a.</p>

<p>aplikueshëm në të ardhurat tatimore apo kreditim i zbritshëm i TVSh, që i atribuohet transaksioneve që përdorin numrin unik identifikues apo numrin fiskal të këtyre bizneseve që janë çregjistruar, u është refuzuar regjistrimi, apo regjistrimi i tyre është anuluar, nuk njihet nga ATK dhe deklaratat tatimore rregullohen në përputhje me to në kontroll apo nga zbulimi i ATK.</p>	<p>applicable to income tax, or VAT input credits, attributable to transactions using the unique ID number or fiscal number of those businesses that have been de-registered, registration has been refused, or registration has been canceled, will not be recognized by the TAK and tax declarations will be adjusted accordingly upon audit or discovery by the TAK.</p>	<p>PAK ne priznaje nijedan rashod koji se odnosi na poreski prihod ili odbitni PDV kredit, koji se može pripisati transakcijama koristeći jedinstveni identifikacioni broj ili fiskalni broj ovih preduzeća koja su objavljeni, kojima je registracija odbijena ili poništena, te se poreske prijave regulišu u skladu sa tim pod kontrolom PAK-a ili kada ih PAK otkrije.</p>
<p>12. Pavarësisht paragrafit 11 të këtij neni, kur ATK vlerëson se transaksioni është fiktiv, për qëllime tatimore nuk do të njihet si shpenzim nga të ardhurat dhe/ose kreditim për TVSh.</p>	<p>12. Notwithstanding paragraph 11 of this article, when the TAK assesses that the transaction is fictitious, for tax purposes it will not be recognized as an expenditure from income and/or credit for VAT.</p>	<p>12. Izuzetno od stava 11. ovog člana, kada PAK proceni da je transakcija fiktivna, za poreske svrhe se neće priznati kao trošak prihoda i/ili PDV kredita.</p>
<p>13. Për përcaktimin e detyrimeve tatimore, në rastin e prishjes, shkatërrimit ose djegies së mallit, për t'u pranuar si shpenzime të veprimtarisë ekonomike, mungesa e mallit dokumentohet nga tatimpaguesi me fakte të besueshme të lëshuara nga organet kompetente. Nëse sipas kërkesës së ATK, tatimpaguesi nuk dokumenton mungesën e mallrave, atëherë mallrat e tilla konsiderohen si mallra të shitura.</p>	<p>13. For determination of tax, in case of damage, destruction or burning of goods to be accepted as economic activity costs, the taxpayer is required to document the lack of goods with persuasive documents issued by competent bodies. If the taxpayer does not document lack of goods following an appropriate request by the TAK, then such goods shall be considered as goods sold.</p>	<p>13. Za utvrđivanje poreskih obaveza, u slučaju kvara, uništenja ili spaljivanja robe, koje se prihvataju kao rashodi privredne aktivnosti, nepostojanje robe dokumentuje poreski obveznik pouzdanim činjenicama izdatim od nadležnih organa. Ako na zahtev PAK-a poreski obveznik ne dokumentuje nedostatak robe, onda se takva roba smatra prodatom robom.</p>
<p>14. Administrata Tatimore e Kosovës nuk ri kontrollon një periudhë tatimore që përfshinë llojin e njëjtë të tatimit që më herët është kontrolluar, e për të cilën është lëshuar një njoftim vlerësim nga ATK, ku ri kontrolli i tillë do të rezultojë në një rezultat të pafavorshëm për tatimpaguesin,</p>	<p>14. The Tax Administration of Kosovo shall not re-audit a tax period involving the same tax type that has previously been audited for which a notice of assessment has been issued by the TAK, where such re-audit will result in an unfavorable result to the taxpayer, except in the following</p>	<p>14. Poreska administracija Kosova ne vrši ponovnu reviziju poreskog perioda koji uključuje istu vrstu poreza koji je prethodno revidiran, i za koji je izdato obaveštenje o proceni od strane PAK-a, gde će takva ponovna revizija rezultirati nepovoljnim rezultatom za poreskog</p>

<p>përveç në rrethanat vijuese:</p> <p>14.1. kur të jenë zbuluar fakte të reja nga ATK, të cilat nuk janë ditur dhe nuk kanë mundur të dihen në kohën e kontrollit dhe mos-hapja e rastit do të ishte shkelje administrative;</p> <p>14.2. kur ka evidencë për mashtrim, shpërdorim, marrëveshje të fshehtë, fshehje të provave apo keqinterpretim të fakteve materiale; dhe</p> <p>14.3. kur rasti i mbyllur përmban një gabim substancial të definuar qartë bazuar në një pozicion të vendosur të ATK, i cili ka ekzistuar në kohën e kontrollit.</p> <p>15. Çdo rihapje e një kontrolli të mbyllur autorizohet nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK (në tekstin e mëtejshëm: Drejtori), bazuar në evidencë të dokumentuar duke mbështetur bazën për rihapje.</p> <p>16. Në rastin e një rikontrolli sipas vendimit të Ankesave, Bordit apo Gjykatës, rikontrolli nuk mund të bëhet nga zyrtari tatimor dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, të cilët kanë marrë pjesë në vlerësimin e parë.</p> <p>17. Në rastet kur ATK bazuar në informatat nga analiza e riskut bën inspektime dhe vëzhgime të tatimpaguesi</p>	<p>circumstances:</p> <p>14.1. new facts are discovered by the TAK that were not known, and could not have been known, at the time of audit and failure to re-open the case would be an administrative violation;</p> <p>14.2. there is evidence of fraud, malfeasance, collusion, concealment, or misrepresentation of material fact; and</p> <p>14.3. the closed case involved a clearly-defined, substantial error based on an established TAK position which existed at the time of the audit.</p> <p>15. Any reopening of a closed audit is authorized by the TAK Executive Director (hereinafter: the Director), based on documented evidence supporting the basis for reopening.</p> <p>16. In the case of a re-audit according to the decision of the Appeals Board or Court, the re-audit cannot be performed by the tax official and the direct supervisor who participated in the first assessment.</p> <p>17. In cases where TAK, based on the information from the risk analysis, makes inspections and observations of the taxpayer</p>	<p>obveznika, osim u sledećim okolnostima:</p> <p>14.1. kada su otkrivene nove činjenice od strane PAK-a, koje nisu bile poznate i nisu mogle biti poznate u vreme inspekcije, a neotvaranje predmeta predstavljalo bi administrativni prekršaj;</p> <p>14.2. kada postoje dokazi o prevari, proneveri, dosluhu, prikriivanju dokaza ili pogrešnom tumačenju materijalnih činjenica; i</p> <p>14.3. kada zatvoreni slučaj sadrži jasno definisanu značajnu grešku na osnovu utvrđenog položaja PAK-a, koji je postojao u vreme inspekcije.</p> <p>15. Svako ponovno otvaranje zatvorene kontrole ovlašćuje Izvršni direktor PAK-a (u daljem tekstu: Direktor), na osnovu dokumentovanih dokaza koji podržavaju osnov za ponovno otvaranje.</p> <p>16. U slučaju preispitivanja po odluci Žalbenog veća, Odbora ili Suda, preispitivanje ne može da vrši poreski službenik i neposredni rukovodilac, koji je učestvovao u prvoj proceni.</p> <p>17. U slučajevima kada TAK na osnovu informacija iz analize rizika izvrši inspekciju i posmatranje poreskog</p>
---	---	--

<p>dhe konstaton se tatimpaguesi ka nëndeklaruar qarkullimin ditor, diferenca e qarkullimit ditor do të përlllogaritet për ditët e punës të asaj periudhe që punon biznesi dhe do të konsiderohet qarkullim mujor i padeklaruar, mbi bazën e së cilës do të aplikohet gjoba e përcaktuar në nenin 99, paragrafin 3.</p>	<p>and finds that the taxpayer has undeclared the daily turnover, the difference of the daily turnover will be calculated for the working days of that period and will be considered as undeclared monthly turnover, on the basis of which the fine defined in article 99, paragraph 3, will be applied.</p>	<p>obveznika i utvrdi da je poreski obveznik nedovoljno proglasio dnevni promet, razlika u dnevnom prometu se obračunava za radne dane tog perioda poslovanja i smatra se neprijavljenim mesečnim prometom, na osnovu čega se primenjuje novčana kazna navedena u članu 99. Stav 3.</p>
<p>18. Ministri nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.</p>	<p>18. The minister shall issue a by-law on the implementation of this article.</p>	<p>18. Ministar donosi podzakonski akt za sprovođenje ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Kufizimet kohore për vlerësimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Time limits for assessment</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Vremenski rokovi za procenu</p>
<p>1. Administrata Tatimore e Kosovës mund të bëjë vlerësimin në çdo kohë, për rastet kur:</p>	<p>1. The Tax Administration of Kosovo may make an assessment at any time where:</p>	<p>1. Poreska administracija Kosova može da vrši procenu u svako vreme, za slučajeve kada:</p>
<p>1.1. një person nuk ka dorëzuar deklaratën tatimore;</p>	<p>1.1. a person has failed to deliver a tax declaration;</p>	<p>1.1. lice nije podnelo poresku prijavu;</p>
<p>1.2. një person, me synim të shmangies së tatimeve, ka dorëzuar një formular tatimor; dhe</p>	<p>1.2. a person has delivered a tax form with the intent of evading tax; and</p>	<p>1.2. lice, u cilju izbegavanja poreza, dostavi poreski obrazac; i</p>
<p>1.3. sjellja mashtruese e një personi të tretë ka çuar në nën raportimin e tatimit apo mbi raportimin e kreditimeve.</p>	<p>1.3. fraudulent behavior of a third person has led to an understatement of tax or overstatement of credits.</p>	<p>1.3. lažno ponašanje treće osobe dovelo je do nedovoljnog prijavljivanja poreza ili prevelikog prijavljivanja kredita.</p>
<p>2. Në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, të gjitha tatimet vlerësohen brenda gjashtë (6) viteve nga data kur deklarata tatimore me të cilën lidhet vlerësimi ka qenë</p>	<p>2. Subject to paragraph 1 of this Article, all taxes must be assessed within six years of the date the tax declaration to which the assessment relates was due, or the date the</p>	<p>2. U skladu sa stavom 1. ovog člana, svi porezi se obračunavaju u roku od šest (6) godina od dana kada je poreska prijava na koju se procena odnosi postala</p>

<p>obligues, apo datën kur është paraqitur deklarata, cilado qoftë më e vona.</p>	<p>declaration was submitted, whichever is later.</p>	<p>obavezujuća, ili od dana kada je prijava podneta, u zavisnosti od toga koje od ta dva se dogodilo kasnije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Vlerësimet në rast rreziku</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Jeopardy Assessments</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Procena u slučaju rizika</p>
<p>1. Administrata Tatimore e Kosovës bën një vlerësim tatimesh në rast rreziku, kur ajo konsideron se mbledhja e tatimit apo ndëshkimit që bëhet detyrim i pagueshëm është në rrezik me arsyetim se personi po përgatitet të shmangë tatimin duke braktisur Republikën e Kosovës, transferuar mjetet, ndërprerë biznesin ose duke ndërmarrë veprime tjera që rrezikojnë mbledhjen e tatimit, nëse nuk bëhet një vlerësim rreziku.</p>	<p>1. The Tax Administration of Kosovo may make a jeopardy assessment of tax or penalty where they consider that the collection of tax or penalty that will become due is in jeopardy because a person is about to evade taxation by fleeing the Republic of Kosovo, transferring assets, ceasing business or taking other actions that will jeopardize collection of the tax unless a jeopardy assessment is made.</p>	<p>1. Poreska administracija Kosova vrši procenu poreza u slučaju rizika, kada smatra da je naplata poreza ili kazne koja postaje obaveza koja se plaća, u opasnosti na osnovu toga što se lice sprema da izbegne porez napuštanjem Republike Kosovo, prenos sredstava, prekid poslovanja ili preduzimanje drugih radnji koje ugrožavaju naplatu poreza, ako se ne izvrši procena rizika.</p>
<p>2. Një vlerësim në rast rreziku mund të bëhet edhe në rast të konfiskimit të mallrave të pa dokumentuara, sipas dispozitave të këtij Ligji.</p>	<p>2. A jeopardy assessment can also be done in case of confiscation of undocumented goods, according to the provisions of this Law.</p>	<p>2. Procena rizika se može izvršiti i u slučaju oduzimanja robe bez dokumentacije, u skladu sa odredbama ovog zakona.</p>
<p>3. Supozohet ligjërisht se mbledhja e tatimit që bëhet detyrim i pagueshëm është në rrezik, nëse ekziston dyshim i arsyeshëm se tatimi ishte, apo do të, shmangët dhe nëse rrethanat e kësaj shmangieje tregojnë se detyrimi tatimor nuk do të zgjidhet.</p>	<p>3. It is legally assumed that collection of tax that will become due is in jeopardy, if there is a reasonable suspicion that the tax was, or will be, evaded and if the circumstances of the evasion indicate that the tax liability will not be settled.</p>	<p>3. Zakonski se pretpostavlja da je naplata poreza koji postaje plativa obaveza ugrožena, ako postoji osnovana sumnja da je porez izbegnut ili će biti izbegnut i ako okolnosti tog izbegavanja ukazuju da porezna obaveza neće biti namirena.</p>
<p>4. Përrjashtimisht nga dispozitat tjera të këtij Ligji, vendimi për vlerësim në rast rreziku ankimohet drejtpërdrejtë në Bord,</p>	<p>4. Except from other provisions of this Law, the decision on jeopardy assessment is appealed directly to the Board, and the</p>	<p>4. Izuzev drugih odredaba ovog zakona, žalba na odluku o proceni u slučaju rizika ulaže se direktno Odboru, a žalba ne</p>

<p>dhe ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit për vlerësim dhe për mbledhjen e borxhit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Njoftim vlerësimi</p> <p>1. Në qoftë se ATK bën një vlerësim të tatimit, ose një vetë-vlerësim nga tatimpaguesi nuk është i shoqëruar me shumën e tërësishme të detyrimit tatimor, ATK i lëshon një njoftim vlerësim personit i cili ka detyrim tatimor.</p> <p>2. Njoftim vlerësimi përmban informatat vijuese:</p> <p>2.1. emrin e tatimpaguesit;</p> <p>2.2. numrin identifikues të tatimpaguesit apo numrin fiskal të tatimpaguesit;</p> <p>2.3. datën e njoftimit;</p> <p>2.4. llojin e tatimit/kontributit dhe periudhën tatimore ose periudhat me të cilat lidhet njoftimi;</p> <p>2.5. shumën e tatimit të vlerësuar, ndëshkimin, gjobën dhe interesin;</p> <p>2.6. një sqarim të shkurtër të vlerësimit;</p>	<p>appeal shall not postpone the execution of the decision on assessment and debt collection.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 Assessment Notice</p> <p>1. If the TAK makes an assessment of tax, or the self-assessment by the taxpayer is not accompanied by the full amount of tax due, the TAK shall issue an Assessment Notice to the person liable for the tax.</p> <p>2. The assessment notice shall contain the following information:</p> <p>2.1. the name of the taxpayer;</p> <p>2.2. the identification number of the taxpayer or the fiscal number of the taxpayer;</p> <p>2.3. the date of the notice;</p> <p>2.4. the type of tax/contribution and tax period or periods to which the notice relates;</p> <p>2.5. the amount of assessed tax, penalties, fine, and interest;</p> <p>2.6. a brief explanation of the assessment;</p>	<p>odlaže izvršenje odluke o proceni i naplati duga.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Obaveštenje o proceni</p> <p>1. Ako PAK izvrši procenu poreza, ili samoprocena od strane poreskog obveznika nije praćena punim iznosom poreske obaveze, PAK izdaje obaveštenje o proceni licu koje ima poresku obavezu.</p> <p>2. Obaveštenje o proceni sadrži sledeće informacije:</p> <p>2.1. ime poreskog obveznika;</p> <p>2.2. identifikacioni broj poreskog obveznika ili fiskalni broj poreskog obveznika;</p> <p>2.3. datum obaveštenja;</p> <p>2.4. vrsta poreza/doprinosa i poreskog perioda ili pririoda na koje se odnosi obaveštenje;</p> <p>2.5. iznos poreske procene, kazne, novčane kazne i kamate;</p> <p>2.6. kratko pojašnjenje procene;</p>
---	---	--

<p>2.7. kërkesën për pagesë të shumës që përbën detyrim;</p> <p>2.8. vendin dhe mënyrën e pagesës së shumës që përbën detyrim;</p> <p>2.9. procedurat e ankesës; dhe</p> <p>2.10. informata të tjera të nevojshme.</p> <p>3. Tatimpaguesi brenda dhjetë (10) ditëve pasi t'i jetë dorëzuar njoftimi, obligohet të paguajë shumën që përbën detyrim në vendin e cekur në njoftim. Shumat për pagesë përfshijnë: tatimin, ndëshkimet, gjobat dhe interesin deri në ditën e pagesës.</p> <p>4. Kur ekziston vlerësimi në rast rreziku sipas nenit 17 të këtij Ligji, ATK kërkon pagesën e menjëhershme të tatimit dhe ndërmerr menjëherë mbledhjen e detyrueshme për të siguruar pagesën e detyrimit tatimor të pagueshëm.</p>	<p>2.7. a demand for payment of the amount due;</p> <p>2.8. the place and manner of payment of the amount due;</p> <p>2.9. the appeal procedures; and</p> <p>2.10. other necessary information.</p> <p>3. The taxpayer shall, within ten (10) days after the notice is delivered, pay the amount due at the place stated in the notice. Amounts to be paid include: tax, penalties, fines and interest up to the date of payment.</p> <p>4. In the event of a jeopardy assessment under Article 17 of this law, the TAK shall demand immediate payment of tax and take enforced collection immediately to secure the payment of taxes due.</p>	<p>2.7. zahtev za uplatu obaveznog iznosa;</p> <p>2.8. mesto i način iznosa obavezne uplate;</p> <p>2.9. žalbeni postupak; i</p> <p>2.10. ostale neophodne informacije.</p> <p>3. Poreski obveznik, u roku od deset (10) dana od dana dostavljanja obaveštenja, dužan je da uplati iznos koji predstavlja obavezu u mestu navedenom u obaveštenju. Iznosi za plaćanje uključuju: poreze, kazne, novčane kazne i kamate do dana uplate.</p> <p>4. Kada postoji procena u slučaju rizika u skladu sa članom 17. ovog zakona, PAK zahteva hitnu uplatu poreza i odmah preduzima obaveznu naplatu kako bi obezbedio plaćanje poreske obaveze.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19 Anulimi i dokumenteve tatimore</p> <p>1. Administrata Tatimore e Kosovës mund të anulojë dokumentet tatimore të lëshuara nga ajo, në qoftë se konstatohet se janë bërë shkelje të legjislacionit tatimor.</p> <p>2. Administrata Tatimore e Kosovës</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 Cancellation of Tax Documents</p> <p>1. The Tax Administration of Kosovo can cancel any tax document issued by the TAK if any violation of tax legislation is determined.</p> <p>2. The Tax Administration of Kosovo shall</p>	<p style="text-align: center;">Član 19 Ukidanje poreske dokumentacije</p> <p>1. Poreska administracija Kosova može da poništi poresku dokumentaciju koju je izdala, ako se utvrdi da je došlo do kršenja poreskog zakonodavstva.</p> <p>2. Poreska administracija Kosova</p>

<p>publikon njoftim në ueb faqen e saj apo në media kur është tërhequr certifikata e një tatimpaguesi, në mënyrë që bizneset tjera të jenë në dijeni për tërheqjen dhe ndikimin e kësaj tërheqjeje në mundësinë e tyre për të hyrë në transaksione ligjore me atë biznes.</p> <p>3. Çdo herë kur ATK gjatë verifikimit të dokumentacionit identifikon ndonjë transaksion/faturë fiktive, pavarësisht se a është biznesi që ka lidhur transaksionin/lëshuar faturën i publikuar në ueb-faqe të ATK-së apo jo, ai transaksion/ajo faturë nuk do të pranohet për qëllime të njohjes së shpenzimeve në Deklaratën e Tatimit në të Ardhura, nuk do të pranohet për qëllime të njohjes së TVSh së zbritshme, si dhe për të dy bizneset, si: për biznesin i cili e ka lëshuar faturën për transaksionin fiktiv dhe biznesin që e ka pranuar faturën për transaksionin fiktiv, ATK do të ndër marrë masat e përcaktuara me Legjislacionin në fuqi.</p> <p>4. Në rastet kur ATK ndalon ushtrimin e aktivitetit ekonomik të tatimpaguesit për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore, njofton ARBK me qëllim të anulimit të certifikatës së regjistrimit të biznesit.</p>	<p>publish a notice on its website or on the media, when a taxpayer certificate has been withdrawn so that other businesses can become aware of the withdrawal, as this would impact on their ability to engage in legal transactions with that business.</p> <p>3. Every time when the TAK, during the documentation verification, identifies any fictitious transaction/invoice, regardless of whether the business that concluded the transaction/issued the invoice is published on TAK's website or not, that transaction/invoice will not be accepted for the purposes of recognizing expenses in the Income Tax Declaration, it will not be accepted for the purposes of recognizing the deductible VAT, while against both businesses, the one that issued the invoice for the fictitious transaction and the one that received the invoice for the fictitious transaction, the TAK will undertake the measures defined by the Legislation in force.</p> <p>4. In cases where the TAK prohibits the exercise of the taxpayer's economic activity due to violations of legal provisions, it shall notify the KBRA with the aim of canceling the business registration certificate.</p>	<p>objavljuje obavještenje na svojoj veb stranici ili u medijima kada je sertifikat poreskog obveznika povučen, tako da druga preduzeća budu upoznata sa povlačenjem i uticajem ovog povlačenja na njihovu sposobnost da uđu u pravne transakcije sa tim preduzećem.</p> <p>3. Svaki put kada PAK, tokom verifikacije dokumentacije, identifikuje bilo koju fiktivnu transakciju/fakturu, bez obzira da li je posao koji je zaključio transakciju/izdao fakturu objavljen na veb stranici PAK-a ili ne, ta transakcija/faktura neće biti prihvaćena za potrebe priznavanja rashoda u prijavi poreza na dobit, neće biti prihvaćena za potrebe priznavanja odbitnog PDV-a, kao ni za oba poslovanja, kao što su: za biznis koji je izdao račun za fiktivnu transakciju i za biznis koji je primio fakturu za fiktivnu transakciju, PAK će preduzeti mere definisane važećim zakonodavstvom.</p> <p>4. U slučajevima kada PAK zabrani obavljanje privredne aktivnosti poreskog obveznika zbog kršenja zakonskih odredbi, obavestava ARBK sa ciljem poništavanja sertifikata o registraciji poslovanja.</p>
--	---	--

<p>5. Ministri nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e kushteve dhe mënyrën e anulimit të dokumenteve tatimore dhe lëshimit të dokumenteve publike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Detyrimi në rastet e veprës penale në fushën e tatimeve</p> <p>Kushdo që kryen veprën penale në fushën e tatimeve, detyrimi tatimor që rrjedh nga aktgjykimi i formës së prerë për veprën penale në fushën e tatimeve, përfshin edhe interesin, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Detyrimi i personave përgjegjës</p> <p>1. Personat e përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 12 të këtij Ligji, janë përgjegjës për obligimet tatimore, që nuk janë vlerësuar ose nuk janë paguar, apo nuk janë vlerësuar ose nuk janë paguar me kohë.</p> <p>2. Paragrafi 1 i këtij neni zbatohet edhe në rastet kur kreditimet dhe rimbursimet tatimore janë paguar pa bazë ligjore.</p> <p>3. Detyrimi sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni përfshin interesin në përputhje me dispozitat e këtij Ligji.</p>	<p>5. The Minister shall issue a by-law on determining the conditions and manner of canceling tax documents and issuing public documents.</p> <p style="text-align: center;">Article 20 Liability in cases of Criminal Tax Offense</p> <p>For whomever commits a criminal offense in the field of taxation, the tax liability arising from the final judgment for the criminal offense in the field of taxation, shall include interest, in accordance with the provisions of this Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 21 Liability of responsible persons</p> <p>1. The persons defined in paragraphs 1 and 2 of Article 12 of this Law are responsible for tax liabilities that have not been assessed or paid, or have not been assessed or paid on time.</p> <p>2. Paragraph 1 of this article shall also apply in cases where credits and tax refunds were paid without a legal basis.</p> <p>3. The liability according to paragraph 1 and 2 of this article shall include interest in accordance with the provisions of this Law.</p>	<p>5. Ministar donosi podzakonski akt za utvrđivanje uslova i načina ukidanja poreskih isprava i izdavanja javnih isprava.</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Obaveza u slučajevima krivičnog dela iz oblasti poreza</p> <p>Svako lice koje izvrši krivično delo iz oblasti poreza, u poresku obavezu koja proizilazi iz pravosnažne presude za krivično delo iz oblasti poreza uračunava se kamata, u skladu sa odredbama ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Obaveza odgovornih lica</p> <p>1. Lica iz stava 1. i 2. člana 12. ovog zakona odgovorna su za poreske obaveze koje nisu procenjene ili plaćene, ili nisu procenjene ili plaćene na vreme.</p> <p>2. Stav 1. ovog člana primenjuje se i u slučajevima kada su poreski krediti i povraćaji plaćeni bez pravnog osnova.</p> <p>3. Obaveza iz stava 1. i 2. ovog člana obuhvata kamatu u skladu sa odredbama ovog zakona.</p>
--	--	--

<p align="center">Neni 22</p> <p>Vlerësimi i detyrimit të personit të tretë</p>	<p align="center">Article 22</p> <p>Assessment of a third person's liability</p>	<p align="center">Član 22</p> <p>Procena obaveze prema trećim licima</p>
<p>1. Administrata Tatimore e Kosovës mund të kryejë një vlerësim të detyrimeve të personit të tretë sipas neneve 20 dhe 21 të këtij Ligji, si dhe kundër personave përgjegjës të përcaktuar në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni. Në rastin e zbatimit të këtij vlerësimi, nenet 15, 16, 17 dhe 18 të këtij Ligji zbatohen përshtatshmërisht.</p> <p>2. Administrata Tatimore e Kosovës ka barrën e provës për vlerësim të drejtë dhe për arsyetimin e detyrimeve të personit të tretë.</p> <p>3. Pagesa e shumës së detyrimit të personit të tretë mund të kërkohet vetëm kur mbledhja e detyrueshme ndaj pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të tatimpaguesit nuk ka qenë e suksesshme apo kur mund të vlerësohet se mbledhja e detyrueshme ndaj pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme të tatimpaguesit nuk do të shpije në përmbushje të detyrimeve tatimore. Ky kufizim nuk zbatohet kur detyrimi është i bazuar në kryerjen e veprës penale në fushën e tatimeve nga personi, apo kur detyrimi i personit për tatim ka rezultuar nga mos-mbledhja, mos-mbajtja në burim apo mos-pagesa e tatimeve të tilla, siç është përcaktuar në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni.</p> <p>4. Kur një entitet juridik apo organizatë,</p>	<p>1. The Tax Administration of Kosovo may make an assessment of a third person's liability under Articles 20 and 21 of this Law, as well as against responsible persons described in paragraphs 4 and 5 of this Article. In the case of the implementation of this assessment, articles 15, 16, 17 and 18 of this Law are applied accordingly.</p> <p>2. The Tax Administration of Kosovo has the burden of proof for a fair assessment and for the justification of the liabilities of the third party.</p> <p>3. The payment of the amount of a third person's liability may only be required where the enforcement against the taxpayer's movable or immovable property was not successful or where it can be assessed that enforcement against the taxpayer's movable or immovable property would not lead to a settlement of the tax liability. This restriction shall not apply where the liability is based on a person's commission of a criminal tax offense, or where the person's liability to tax results from the taxpayer's failure to collect, withhold or pay over such taxes as provided in paragraph's 4 and 5 of this Article.</p> <p>4. When a legal entity or organization,</p>	<p>1. Poreska administracija Kosova može izvršiti procenu obaveza trećih lica prema članovima 20. i 21. ovog zakona, kao i protiv odgovornih lica definisanih u stavovima 4. i 5. ovog člana. U slučaju sprovođenja ove procene, shodno se primenjuju članovi 15, 16, 17. i 18. ovog zakona.</p> <p>2. Poreska administracija Kosova ima teret dokazivanja za pravičnu procenu i za opravdanje obaveza treće strane.</p> <p>3. Isplata iznosa obaveze prema trećem licu može se tražiti samo kada prinudna naplata na pokretnu i nepokretnu imovinu poreskog obveznika nije uspela ili kada se može proceniti da je prinudna naplata na pokretnu ili nepokretnu imovinu poreskog obveznika neće dovesti do ispunjenja poreskih obaveza. Ovo ograničenje ne važi kada je obaveza zasnovana na izvršenju krivičnog dela iz oblasti poreza od strane lica, ili kada je poreska obaveza tog lica nastala nenaplatom, nedržanjem ili neplaćanjem tih poreza, kao što je definisano u stavovima 4. i 5. ovog člana.</p> <p>4. Kada pravno lice ili organizacija, sa</p>

<p>përrjashtimisht ndërmarrja afariste individuale, nuk ka mbajtur në burim, nuk ka mbledhur apo nuk ka paguar tatimin e mbajtur në burim apo tatimin e mbledhur, atëherë çdo person përgjegjës është personalisht i detyrueshëm nga pasuritë e tij për shumën e tatimit të mos-mbajtur, të mos mbledhur apo të mos-paguar.</p>	<p>except the individual business enterprise, has not withheld, collected or paid the tax withheld or the tax collected, then each responsible person is personally liable from their assets for the amount of non-withheld, non-collected or non-paid tax.</p>	<p>izuzetkom pojedinačnog poslovnog preduzeća, nije zadržao, naplatio ili platio porez po odbitku ili naplaćeni porez, tada svako odgovorno lice lično odgovara iz svoje imovine za iznos poreza koji nije zadržan, nije naplaćen ili nije plaćen.</p>
<p>5. Kur një entitet juridik apo organizatë, përrjashtimisht nga një ndërmarrje afariste individuale, nuk ka mbajtur në burim, nuk ka mbledhur apo nuk ka paguar një kontribut pensional apo kontribut tjetër të obligueshëm, atëherë çdo person përgjegjës është personalisht i detyrueshëm nga pasuritë e tij për shumën e kontributit të mos-mbajtur, të mos-mbledhur apo të mos-paguar në fondet përkatëse.</p>	<p>5. When a legal entity or organization, except for an individual business enterprise, has not withheld, collected or paid a pension contribution or other mandatory contribution, then each responsible person is personally liable from their assets for the amount of the non-withheld, non-collected or non-paid contribution to the respective funds.</p>	<p>5. Kada pravno lice ili organizacija, osim pojedinačnog privrednog društva, nije obustavila, naplatila ili uplatila penzijski doprinos ili drugi obavezni doprinos, onda svako odgovorno lice lično odgovara iz svoje imovine za iznos doprinosa koji nije zadržan, nije naplaćen ili nije plaćen u odgovarajuće fondove.</p>
<p>6. Shuma e detyrimit të paraparë në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni është e kufizuar në shumën e tatimit të pa mbledhur, të pa mbajtur në burim apo të papaguar. Nëse pas vlerësimit të detyrimit kundër personave përgjegjës, entiteti juridik, apo organizata, përrjashtimisht nga ndërmarrja afariste individuale, paguan atë tatim që ka qenë obligues për të mbledhur, mbajtur në burim apo paguar, shuma e vlerësuar kundër personave përgjegjës hiqet dhe çdo barrë e dorëzuar lirohet.</p>	<p>6. The amount of the liability provided in paragraphs 4 and 5 of this Article is limited to the amount of tax not collected, withheld, or paid over. If, after assessing this liability against responsible persons, the legal entity, or organization other than a personal business enterprise, pays the tax that was due to be collected, withheld, or paid over, the amount assessed against the responsible persons shall be abated and any liens filed shall be released.</p>	<p>6. Iznos obaveze iz st. 4. i 5. ovog člana ograničen je na iznos nenaplaćenog, zadržanog ili neplaćenog poreza. Ako nakon procene obaveze prema odgovornim licima, pravno lice ili organizacija, osim pojedinačnog privrednog društva, plati porez koji je bilo u obavezi da naplati, zadrži ili plati, iznos koji je obračunat prema odgovornim licima se uklanja i svako podneto založno pravo se oslobađa.</p>
<p>7. Shuma e detyrimit të paraparë në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni mund të</p>	<p>7. The liability provided in paragraphs 4 and 5 of this Article may be assessed against</p>	<p>7. Iznos obaveze iz st. 4. i 5. ovog člana može se odrediti na teret jednog ili više</p>

<p>vlerësohet kundër një apo më shumë personave që janë përgjegjës për dështimin e entitetit juridik apo organizatës tjetër për të mbledhur, mbajtur në burim apo për të paguar tatimin e mbajtur në burim apo të mbledhur. Shuma totale e tatimit të mos-mbajtur në burim, të mos-mbledhur apo të mos paguar mund të mblidhet vetëm një herë. Kur shuma e tatimit të plotë të jetë paguar, çdo shumë e mbetur e ndëshkimit obligues nga personat përgjegjës, hiqet dhe çdo barrë e dorëzuar lirohet.</p>	<p>one or more persons who are responsible for the failure of the legal entity or other organization to withhold, collect or pay over a withholding or collected tax. The total amount of tax not withheld, collected or paid over can be collected only one time. Once the full tax amount has been paid, any remaining tax amounts due from responsible persons shall be abated and any liens filed shall be released.</p>	<p>lica koja su odgovorna za propust pravnog lica ili druge organizacije da naplati, zadrži ili uplati zadržani ili naplaćeni porez. Ukupan iznos poreza koji nije zadržan, nije naplaćen ili je neplaćen može se naplatiti samo jednom. Kada se uplati puni iznos poreza, poništava se svaki preostali iznos kazne koju duguju odgovorna lica, a podneto založno pravo se oslobađa.</p>
<p>8. Ministri nxjerrë akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.</p>	<p>8. The minister shall issue a by-law on the implementation of this article.</p>	<p>8. Ministar donosi podzakonski akt za sprovođenje ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI V PAGESA E TATIMEVE</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER V TAX PAYMENT</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE V UPLATE POREZA</p>
<p style="text-align: center;">Neni 23 Pagesat</p>	<p style="text-align: center;">Article 23 Payments</p>	<p style="text-align: center;">Član 23 Uplate</p>
<p>1. Çdo tatim që përbën detyrim dhe që duhet t'i paguhet ATK është një borxh ndaj ATK.</p>	<p>1. Any tax that is due and payable to TAK, is a debt due to TAK.</p>	<p>1. Svaki porez koji predstavlja obavezu i mora se platiti PAK-u je dug prema PAK-u.</p>
<p>2. Çdo person që ka detyrë t'i paguajë tatime ATK sipas legjislacionit në fuqi, i paguan ato në kohën dhe vendin e përcaktuar në legjislacionin tatimor në fuqi, pa njoftim ose kërkesë nga ana e ATK.</p>	<p>2. Any person required to pay any tax to the TAK under the legislation in force shall, without notice or demand from the TAK, pay such tax at the time and place specified in the tax legislation in force.</p>	<p>2. Svako lice koje ima obavezu da plaća poreze PAK-u u skladu sa zakonima na snazi, plaća ih u vreme i na mestu određenom u poreskom zakonodavstvu na snazi, bez obaveštenja ili zahteva od PAK-a.</p>
<p>3. Çdo person, i cili është përgjegjës nga tatimpaguesi të mbajë në burim dhe të</p>	<p>3. Any person who is responsible from the taxpayer to withhold and pay any taxes on</p>	<p>3. Svako lice koje je dužno od poreskog obveznika da zadrži i plati bilo koji porez</p>

<p>paguajë çdo tatim në emër të atij tatimpaguesi sipas legjislacionit tatimor në fuqi, i paguan ato në kohën dhe vendin e përcaktuar në legjislacionin tatimor në fuqi, pa njoftim apo kërkesë nga ATK.</p>	<p>behalf of that taxpayer according to the tax legislation in force, shall pay them at the time and place specified in the tax legislation in force, without notice or request from TAK.</p>	<p>u ime tog poreskog obveznika prema važećem poreskom zakonodavstvu, plaća ih u vreme i na mestu određenom u primenljivom poreskom zakonodavstvu, bez obaveštenja ili zahteva od PAK-a.</p>
<p>e këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 43 Shkëmbimi i transaksioneve dhe raportimi i informatave nga palët e treta</p> <p>1. Transaksionet e këmbimit konsiderohen si shitje e mallrave ose rezultat i punës apo shërbimeve të bëra me vlerë tregu.</p> <p>2. Faturat tatimore lëshohen për transaksionet e këmbimit në mënyrë të njëjtë sikur të jenë lëshuar për transaksione me para në dorë. Nëse vlera e transaksionit me këmbim e paraqitur në faturën tatimore është vlerë e zvogëluar, ATK mund të rregullojë vlerën e transaksionit për të reflektuar vlerën e hapur të tregut.</p> <p>3. Të gjithë personat që zhvillojnë aktivitet ekonomik dhe aktivitete tjera, duhet të dorëzojnë në ATK, në mënyrë elektronike librin e blerjes dhe librin e shitjes, si:</p> <p>3.1. Personat që janë të regjistruar për TVSh, dorëzojnë librat çdo muaj;</p> <p>3.2. Personat tjerë, dorëzojnë librat çdo tre muaj.</p> <p>4. Secilit person, nga i cili sipas këtij neni kërkohet të dorëzojë librat në mënyrë elektronike dhe nuk dorëzon ato, i</p>	<p>implementation of this article.</p> <p style="text-align: center;">Article 43 Barter Transactions and Third Party Information Reporting</p> <p>1. Barter transactions shall be considered as a sale of goods or the result of work or services at market values.</p> <p>2. Tax invoices shall be issued for barter transactions in the same manner as they are issued for cash transactions. If the value of a barter transaction indicated in a tax invoice is a reduced value, the TAK may adjust the value of the transaction to reflect the open market value.</p> <p>3. All persons who conduct an economic activity and other activities, must submit to the TAK, electronically, the book of purchases and the book of sales, as follows:</p> <p>3.1. Persons who are registered for VAT, shall submit their books every month;</p> <p>3.2. Other persons shall submit their books every three months.</p> <p>4. Any person who, according to this article, is required to submit the books electronically and does not submit them,</p>	<p>primenu ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 43 Razmena transakcija i izveštaj o informacijama od strane trećih strana</p> <p>1. Transakcije razmene predstavljaju prodaju robe ili rezultat rada ili usluga po tržišnoj vrednosti.</p> <p>2. Poreske fakture se izdaju za transakcije razmene na isti način kao da su izdate za gotovinske transakcije. Ako je vrednost transakcije razmene prikazana na poreskoj fakturi smanjena vrednost, PAK može da prilagodi vrednost transakcije kako bi odrazila vrednost na otvorenom tržištu.</p> <p>3. Sva lica koja razvijaju privrednu delatnost i druge delatnosti moraju elektronskim putem da dostave PAK-u knjigu kupovine i knjigu prodaje:</p> <p>3.1. Lica koja su registrovana za PDV, dostavljaju knjige svakog meseca;</p> <p>3.2. Ostala lica dostavljaju knjige svaka tri meseca.</p> <p>4. Novčanom kaznom prema članu 101. stav 1. ovog zakona kazniće se lica koje je prema ovom članu dužno da knjige</p>
---	--	---

<p>shqiptohet gjobë sipas nenit 101, paragrafit 1, të këtij Ligji.</p> <p>5. Çdo punëdhënës duhet të informojë ATK për lidhjen e një kontrate të punës një ditë para fillimit të punës së punëtorit. Ky informim bëhet në formën e përcaktuar nga ATK.</p> <p>6. Ministri nxjerr akt nënligjor për zbatimin e këtij neni.</p>	<p>shall be fined according to article 101, paragraph 1, of this Law.</p> <p>5. Each employer must inform the TAK about the conclusion of an employment contract one day before the employee starts work. This information is provided in the form determined by the TAK.</p> <p>6. The minister shall issue a by-law on the implementation of this article.</p>	<p>dostavi elektronskim putem, a ne dostavi ih.</p> <p>5. Svaki poslodavac mora da obavesti PAK o zaključivanju ugovora o radu jedan dan pre početka rada radnika. Ove informacije su date u formi koju odredi PAK.</p> <p>6. Ministar donosi podzakonski akt za sprovođenje ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 44 Nën-deklarimi i të ardhurave dhe arkëtimet e devijuara</p> <p>1. Kur një individ deklaron një shumë të të ardhurave që është e pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e tij të kryera për konsum personal, ATK mundet të rillogarisë të ardhurat e individit në bazë të shpenzimeve të kryera nga individit, apo ndonjë metodë tjetër indirekte e duhur për rrethanat, duke marrë në konsideratë të ardhurat e periudhave të mëhershme.</p> <p>2. Ministri nxjerrë akt nënligjor me të cilin përcakton metodat indirekte të vlerësimit dhe zbatimin e tyre.</p>	<p style="text-align: center;">Article 44 Understatements of Income and Diverted Receipts</p> <p>1. Where an individual declares an amount of income that is insufficient to support his or her expenses incurred for personal consumption, TAK may recalculate the income of the individual on the basis of expenses incurred by the individual, or any other indirect method appropriate to the circumstances, taking into account income of previous periods.</p> <p>2. The Minister shall issue a by-law that defines the indirect assessment methods and their implementation.</p>	<p style="text-align: center;">Član 44 Nedovoljna prijava prihoda i preusmereni prihodi</p> <p>1. Kada pojedinac prijavi iznos prihoda koji nije dovoljan da pokrije njegove troškove za ličnu potrošnju, PAK može da preračuna prihod pojedinca na osnovu troškova koje je napravio pojedinac, ili na bilo koji drugi odgovarajući indirektan metod za okolnosti, uzimajući u obzir prihode prethodnih perioda.</p> <p>2. Ministar donosi podzakonski akt kojim se definišu metode indirektne procene i njihova primena.</p>

<p style="text-align: center;">KAPITULLI VII KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL TATIMOR</p> <p style="text-align: center;">NËN-KAPITULLI I ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS</p> <p style="text-align: center;">Neni 45 Legjislacioni Tatimor</p> <p>1. Legjislacioni tatimor në fushëveprimin e ATK përbëhet nga:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. ligjet tatimore; dhe</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. aktet nënligjore të miratuara, që burojnë nga ligjet tatimore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 46 Administrata Tatimore e Kosovës</p> <p>1. Administrata Tatimore e Kosovës ka statusin e veçantë të një Agjencie Ekzekutive, e cila funksionon me autonomi të plotë operationale, përbrenda Ministrisë, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>2. Administrata Tatimore e Kosovës është përgjegjëse për administrimin e sistemit tatimor në Republikën e Kosovës dhe</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER VII TAX LEGAL AND INSTITUTIONAL FRAMEWORK</p> <p style="text-align: center;">SUB-CHAPTER I ORGANIZATION AND FUNCTIONING OF THE TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO</p> <p style="text-align: center;">Article 45 Tax Legislation</p> <p>1. The tax legislation on the scope of the TAK consists of:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. ratified international agreements;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. tax laws; and</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. adopted by-laws, originating from tax laws.</p> <p style="text-align: center;">Article 46 Tax Administration of Kosovo</p> <p>1. The Tax Administration of Kosovo has the special status of an Executive Agency, which operates with full operational autonomy, within the Ministry, according to the legislation in force.</p> <p>2. The Tax Administration of Kosovo shall be responsible for the administration of the tax system in the Republic of Kosovo and</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE VII PRAVNI OKVIR I PORESKE INSTITUCIJE</p> <p style="text-align: center;">POTPOGLAVLJE I ORGANIZACIJA I FUNKCIONISANJE PORESKE ADMINISTRACIJE KOSOVA</p> <p style="text-align: center;">Član 45 Poresko zakonodavstvo</p> <p>1. Poresko zakonodavstvo u delokrugu PAK-a sastoji se od:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Ratifikovanih međunarodnih ugovora;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Poreskih zakona; i</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. Usvojenih podzakonskih akata, proisteklih iz poreskih zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 46 Poreska administracija Kosova</p> <p>1. Poreska administracija Kosova ima status izvršne agencije, koja radi sa punom operativnom autonomijom, u okviru Ministarstva, prema zakonodavstvu na snazi.</p> <p>2. Poreska administracija Kosova je odgovorna za administraciju poreskog sistema u Republici Kosovo i</p>
--	---	--

<p>zbatimin e dispozitave të këtij Ligji, Ligjit për Tatim në të Ardhura Personale, Ligjit për Tatim në të Ardhura të Korporatave, Ligjit për Tatim mbi Vlerën e Shtuar dhe çdo legjislacioni tjetër në fuqi në Republikën e Kosovës e që i ngarkon detyrën të administrojë çdo lloj tatimi.</p> <p>3. Për të plotësuar përgjegjësinë e saj sipas paragrafit 2 të këtij neni, ATK ka për detyrë të mbledhë në vazhdimësi të hyrat që janë të aplikueshme përbrenda Ligjit duke pasur parasysh:</p> <p>3.1. burimet në dispozicion për ATK;</p> <p>3.2. rëndësinë e promovimit të përmbushjes, veçanërisht përmbushjes vullnetare, të legjislacionit tatimor në Republikën e Kosovës nga të gjithë tatimpaguesit; dhe</p> <p>3.3. shpenzimet e përmbushjes të dala nga tatimpaguesit.</p> <p>4. Administrata Tatimore e Kosovës ka stemën e saj, vulën dhe simbolet tjera me të cilat përcaktohet identiteti i institucionit.</p> <p>5. Forma, përmbajtja, dizajni, ngjyra dhe përdorimi i flamurit, stemës, vulave, simboleve, uniformës, shenjave të gradimit dhe epoletave, përcaktohen me akt nënligjor nga Ministri.</p>	<p>for applying the provisions of this law, the Law on Personal Income Tax, the Law on Corporate Income Tax, the Law on Value-Added Tax and any other legislation in force in the Republic of Kosovo that requires it to administer any type of taxation.</p> <p>3. In meeting its responsibility under paragraph 2 of this Article, it shall be the duty of the TAK to collect over time revenue that is practicable within the law having regard to:</p> <p>3.1. the resources available to the TAK;</p> <p>3.2. the importance of promoting compliance, especially voluntary compliance, by all taxpayers with the tax legislation of the Republic of Kosovo; and</p> <p>3.3. the compliance costs incurred by taxpayers;</p> <p>4. The Tax Administration of Kosovo has its coat of arms, seal and other symbols that determine the identity of the institution.</p> <p>5. The form, content, design, color and use of the flag, coat of arms, seals, symbols, uniform, rank insignia and shoulder straps, are determined by a by-law by the Minister.</p>	<p>sprovođenje odredaba ovog zakona, Zakona o porezu na dohodak fizičkih lica, Zakona o porezu na prihod preduzeća, Zakona o porezu na dodatu vrednost i bilo kojeg drugog zakona koji je na snazi u Republici Kosovo, a koji propisuje obavezu da administruje bilo koju vrstu poreza.</p> <p>3. Da bi ispunila svoju odgovornost prema stavu 2. ovog člana, PAK je dužna da kontinuirano prikuplja prihode koji se primenjuju u skladu sa zakonom uzimajući u obzir:</p> <p>3.1. izvore na raspolaganju PAK-u;</p> <p>3.2. značaj promovisanja poštovanja, posebno dobrovoljnog poštovanja poreskog zakonodavstva u Republici Kosovo od strane svih poreskih obveznika; i</p> <p>3.3. troškove usklađenosti koje imaju poreski obveznici.</p> <p>4. Poreska administracija Kosova ima svoj grb, pečat i druge simbole koji definišu identitet institucije.</p> <p>5. Oblik, sadržaj, dizajn, boju i upotrebu zastave, grba, pečata, simbola, uniforme, oznaka činova i epoleta utvrđuje ministar podzakonskim aktom.</p>
--	--	--

<p>6. Forma dhe përmbajtja e kartës së identitetit dhe procedura për lëshimin e tyre bëhen sipas procedurave të përcaktuara nga ATK.</p> <p style="text-align: center;">Neni 47 Organizimi i Administratës Tatimore të Kosovës</p> <p>Struktura funksionale dhe organizative e Administratës Tatimore të Kosovës rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, pas propozimit nga Ministri.</p> <p style="text-align: center;">Neni 48 Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës</p> <p>1. Drejtori, drejton dhe përfaqëson ATK dhe në mënyrë të veçantë është përgjegjës të/për:</p> <p>1.1. zbatimin e dispozitave të këtij Ligji;</p> <p>1.2 mbledhë të gjitha tatimet e vendosura sipas legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës që autorizon ATK të administrojë tatimin e tillë;</p> <p>1.3. përgatisë shpalljet, njoftimet dhe komunikimet tjera për të siguruar se të</p>	<p>6. The form and content of the identity cards and the procedure for issuing them are made according to the procedures established by the TAK.</p> <p style="text-align: center;">Article 47 Organization of the Tax Administration of Kosovo</p> <p>The operational and organizational structure of the Tax Administration of Kosovo is regulated by a by-law issued by the Government after the proposal from the Minister.</p> <p style="text-align: center;">Article 48 Responsibilities and tasks of the Executive Director of the Tax Administration of Kosovo</p> <p>1. The Director shall lead and represent the TAK and is specifically responsible for:</p> <p>1.1. the implementation of the provisions of this Law;</p> <p>1.2 the collection of all taxes levied under legislation applicable in the Republic of Kosovo that authorizes the TAK to administer such tax;</p> <p>1.3. preparing advertisements, notices, and other communications to ensure that</p>	<p>6. Forma i sadržaj lične karte i postupak za njihovo izdavanje vrši se prema procedurama koje utvrđuje PAK.</p> <p style="text-align: center;">Član 47 Organizacija Poreske administracije Kosova</p> <p>Funkcionalna struktura i organizacija Poreske administracije Kosova reguliše se podzakonskim aktom koji donosi vlada.</p> <p style="text-align: center;">Član 48 Odgovornosti i dužnosti izvršnog direktora Poreske administracije Kosova</p> <p>1. Direktor vodi i zastupa PAK i posebno je odgovoran za:</p> <p>1.1. sprovođenje odredbi ovog zakona;</p> <p>1.2 naplatu svih poreza uspostavljenih prema važećem zakonodavstvu u Republici Kosovo koje ovlašćuje PAK da upravlja takvim porezom;</p> <p>1.3.pripremanje objave, obaveštenja i drugih saopštenja kako bi obezbedio</p>
---	---	--

<p>gjithë personat i kuptojnë detyrimet dhe të drejtat e tyre sipas këtij Ligji;</p> <p>1.4. sigurojë zbatim të njëtrajtshëm të legjislacionit tatimor në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.5. propozoj një strukturë organizative brenda ATK të përshtatshme për funksionet e saj;</p> <p>1.6. emërojë personat të tillë sipas nevojës për të zbatuar dispozitat e këtij Ligji në përputhje me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik.</p> <p>1.7. propozimin e planit dhe raportit vjetor të performancës së ATK;</p> <p>1.8. menaxhimin e burimeve njerëzore të ATK, në pajtim me këtë Ligj dhe legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik;</p> <p>1.9. ekzekutimin e buxhetit të ATK dhe miratimin e pagesave sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e financave publike;</p> <p>1.10. lidhjen e kontratave dhe marrëveshjeve në emër dhe llogari të ATK, në pajtim me këtë Ligj dhe legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.11. menaxhimin e pronës së ATK;</p>	<p>all persons understand their obligations and rights under this law;</p> <p>1.4. ensuring uniform implementation of tax legislation in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. establishing an organizational structure within the TAK, appropriate for its functions;</p> <p>1.6. appointing such persons as may be required to carry out the provisions of this law in conformity with the legislation in force on public officials;</p> <p>1.7. proposing the TAK plan and annual performance report;</p> <p>1.8. managing TAK's human resources, in accordance with the legislation in force on public officials;</p> <p>1.9. executing the TAK budget and approving payments according to the legislation in force for the management of public finances;</p> <p>1.10. concluding contracts and agreements on behalf and on account of the TAK, in accordance with this Law and the legislation in force;</p> <p>1.11. managing TAK property;</p>	<p>da sva lica razumeju svoja prava i obaveze prema ovom zakonu;</p> <p>1.4. obezbeđivanje jedinstvene primene poreskog zakonodavstva u Republici Kosovo;</p> <p>1.5. uspostavljanje organizacione strukture u okviru PAK-a koja odgovara njenim funkcijama;</p> <p>1.6. imenovanje lica koja su neophodna za sprovođenje odredbi ovog zakona u skladu sa zakonima koji su na snazi za javne službenike.</p> <p>1.7. predlog plana i godišnji izveštaj o radu PAK-a;</p> <p>1.8. upravljanje ljudskim resursima PAK-a, u skladu sa zakonima na snazi o javnim službenicima;</p> <p>1.9. izvršenje budžeta PAK-a i odobravanje isplata u skladu sa zakonima na snazi o upravljanju javnim finansijama;</p> <p>1.10. zaključivanje ugovora i sporazuma u ime i za račun PAK-a, u skladu sa ovim zakonom i zakonima na snazi;</p> <p>1.11. upravljanje imovinom PAK-a;</p>
---	--	---

<p>1.12. aprovojë procedurat dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.13. zbatojë autorizimet dhe detyrat tjera të deleguara nga Ministri, të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.14. miratojë Kodin e Mirësjelljes në ATK;</p> <p>1.15. nxjerrë aktet e brendshme që kanë të bëjnë me rregullimin e marrëdhënies së punës së punonjësve të ATK, pas konsultimit me Ministrin;</p> <p>1.16. angazhoj ekspertë sipas nevojës, duke iu nënshtruar dispozitave të këtij Ligji, për të dhënë asistencë teknike në fushat e ndërlikuara që ndikojnë në administratën tatimore për të cilat kjo e fundit nuk ka ekspertizë;</p> <p>1.17. nxjerrë vendim për angazhimin e operatorëve ekonomikë të cilët do të monitorojnë tatimpaguesit për zbatimin e legjislacionit tatimor gjatë zhvillimit të aktiviteteve ekonomike; dhe</p> <p>1.18. detyrat e tjera.</p>	<p>1.12. approving procedures and supervising their implementation in accordance with the legislation in force;</p> <p>1.13. enforcing any other power or duty delegated by the Minister, which are in accordance with the legislation in force;</p> <p>1.14. approving the TAK Code of Conduct;</p> <p>1.15. issuing internal acts related to the regulation of the working relationship of TAK employees, after consultation with the Minister;</p> <p>1.16. engaging experts as necessary, subject to confidentiality provisions of this law, to provide technical assistance in complex areas impacting tax administration for which the latter has no expertise;</p> <p>1.17. issue a decision on the engagement of economic operators who will monitor taxpayers for the implementation of tax legislation during the development of economic activities; and</p> <p>1.18. other tasks.</p>	<p>1.12. odobravanje procedure i nadgledanje njihovog sprovođenja u skladu sa zakonima na snazi;</p> <p>1.13. sprovođenje ovlašćenja i drugih poslova koje je preneo ministar, a koji su u skladu sa zakonima na snazi;</p> <p>1.14. usvajanje Kodeksa ponašanja u PAK-u;</p> <p>1.15. donošenje internih akata u vezi sa regulisanjem radnog odnosa zaposlenih u PAK-u, nakon konsultacija sa ministrom;</p> <p>1.16. angažovanje stručnjaka po potrebi, u skladu sa odredbama ovog zakona, za pružanje tehničke pomoći u složenim oblastima koje utiču na poresku administraciju za koje ova potonja nema stručnost;</p> <p>1.17. donosi odluku o angažovanju privrednih subjekata koji će pratiti poreske obveznike za sprovođenje poreskog zakonodavstva u toku razvoja privrednih delatnosti; i</p> <p>1.18. drugi zadaci.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 49 Delegimi i kompetencave</p> <p>1. Drejtori mund t'i delegojë çdo zyrtari tatimor çdo lloj kompetence ose detyre që i është dhënë ose vënë Drejtorit sipas këtij Ligji, përveç kompetencës së delegimit.</p> <p>2. Drejtori mund të delegojë kompetenca zyrtarëve të DK, sipas një marrëveshjeje në mes të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK dhe Drejtorit të Përgjithshëm të DK.</p> <p>3. Drejtori, në çdo kohë mund të revokojë çdo kompetencë ose detyrë të deleguar sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij neni.</p>	<p style="text-align: center;">Article 49 Delegation of powers</p> <p>1. The Director may delegate to any tax official any power or duty conferred or imposed on the Director by this law other than this power of delegation.</p> <p>2. The Director may delegate powers to KC officials, according to an agreement between the TAK Executive Director and the KC Executive Director.</p> <p>3. The Director may revoke any power or duty delegated under paragraph 1 or 2 of this Article.</p>	<p style="text-align: center;">Član 49 Delegiranje nadležnosti</p> <p>1. Direktor može delegirati bilo kom poreskom službeniku bilo koju vrstu nadležnosti ili zadataka koji su mu dati ili dodeljeni prema ovom zakonu, osim nadležnosti delegiranja.</p> <p>2. Direktor može delegirati ovlašćenja službenicima CK-a, u skladu sa sporazumom između izvršnog direktora PAK-a i izvršnog direktora CK.</p> <p>3. Direktor, u bilo koje vreme, može opozvati bilo koje ovlašćenje ili zadatak koji je delegiran u skladu sa stavom 1. ili 2. ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 50 Raportimi i Drejtorit të Përgjithshëm</p> <p>1. Drejtori paraqet Raportin Vjetor të Performancës dhe raporte periodike mbi veprimtarinë dhe rezultatet e ATK tek Ministri.</p> <p>2. Drejtori përgatit raport për periudhën tremujore paraprake mbi veprimtarinë e ATK, të cilin ia dorëzon Ministrit dhe e publikon në ueb faqen e ATK. Raporti dorëzohet tridhjetë ditë (30) ditë pas përfundimit të periudhës raportuese.</p> <p>3. Raporti tremujor i ATK përfshinë:</p>	<p style="text-align: center;">Article 50 Reporting of the Executive Director</p> <p>1. The Director shall submit the Annual Performance Report and periodic reports on TAK activities and results to the Minister.</p> <p>2. The Director shall prepare a report for the previous quarterly period on TAK activities, which he shall submit to the Minister and publish on TAK's website. The report shall be submitted thirty (30) days after the end of the reporting period.</p> <p>3. The quarterly report of the TAK shall include:</p>	<p style="text-align: center;">Član 50 Izveštaj izvršnog direktora</p> <p>1. Direktor podnosi godišnji izveštaj o učinku i periodične izveštaje o aktivnostima i rezultatima PAK-a ministru.</p> <p>2. Direktor priprema izveštaj za prethodni tromesečni period o aktivnostima PAK-a, koji podnosi ministru i objavljuje na sajtu PAK-a. Izveštaj se podnosi trideset (30) dana nakon završetka izveštajnog perioda.</p> <p>3. Tromesečni izveštaj PAK-a obuhvata:</p>

<p>3.1. detaje mbi buxhetin e ATK;</p> <p>3.2. detaje mbi numrin dhe nivelin e stafit të ATK;</p> <p>3.3. detaje mbi të ardhurat e mbledhura nga ATK duke treguar hollësitë e shumave të të ardhurave për secilin lloj të tatimit dhe për secilin regjion, si dhe hollësi të tjera të tilla që mund të kërkohen nga Ministri;</p> <p>3.4. informata tjera të përcaktuara me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p> <p>4. Drejtori përgatit Raportin Vjetor të Performancës për vitin paraprak mbi veprimtarinë e ATK dhe ia dorëzon Ministrit deri më 31 mars të vitit vijues.</p> <p>5. Raporti Vjetor i Performancës së ATK përfshinë:</p> <p>5.1. detaje mbi buxhetin e ATK;</p> <p>5.2. detaje mbi numrin dhe nivelin e stafit të ATK;</p> <p>5.3. detaje mbi të ardhurat e mbledhura nga ATK duke treguar hollësitë e shumave të të ardhurave për secilin lloj të tatimit dhe për secilin regjion, si dhe hollësi të tjera të tilla që mund të kërkohen nga Ministri;</p>	<p>3.1. details of the budget of TAK;</p> <p>3.2. details of the number and level of staff of TAK;</p> <p>3.3. details of the revenues collected by TAK showing details of the amount of revenue from each type of tax and each region and such other details as may be requested by the Minister;</p> <p>3.4. other information determined by a by-law issued by the Minister.</p> <p>4. The director shall prepare the Annual Performance Report for the previous year on the activity of the TAK and shall submit it to the Minister by March 31 of the following year.</p> <p>5. The Annual Performance Report of the TAK shall include:</p> <p>5.1. details of the budget of TAK;</p> <p>5.2. details of the number and level of staff of TAK;</p> <p>5.3. details of the revenues collected by TAK showing details of the amount of revenue from each type of tax and each region and such other details as may be requested by the Minister;</p>	<p>3.1. detalje o budžetu PAK-a;</p> <p>3.2. detalje o broju i nivou osoblja PAK-a;</p> <p>3.3. detalje o prikupljenim prihodima od strane PAK-a pokazujući detaljnost iznosa prihoda za svaku vrstu poreza i za svaki region, kao i druge takve pojedinosti koje mogu da se zahtevaju od ministra;</p> <p>3.4. ostale informacije određene podzakonskim aktom od strane ministra.</p> <p>4. Direktor priprema godišnji izveštaj učinka za prethodnu godinu o aktivnostima PAK-a i dostavlja ministarstvu do 31. marta naredne godine.</p> <p>5. Godišnji izveštaj učinka PAK-a obuhvata:</p> <p>5.1. detalje o budžetu PAK-a;</p> <p>5.2. detalje o broju i nivou osoblja PAK-a;</p> <p>5.3. detalje o prikupljenim prihodima od strane PAK-a koji pokazuju detalje o iznosima prihoda za svaku vrstu poreza i za svaki region, kao i druge takve detalje koje može zahtevati ministar;</p>
--	---	--

<p>5.4. parashikimet e koston së mbledhjes për secilin lloj të të ardhurave nga tatimet që janë mbledhur;</p> <p>5.5. detaje mbi të gjitha detyrimet tatimore të anuluar sipas nenit 39, përfshirë emrat e personave, detyrimi i të cilëve është anuluar dhe shumën e anuluar;</p> <p>5.6. detaje mbi të gjitha ndjekjet penale në fushën e tatimeve, kur hetimi është iniciuar nga ATK, përfshirë emrin e secilit person i cili është dënuar, dënimi i shqiptuar dhe shumën e tatimit të përfshirë;</p> <p>5.7. informatat në përdorimin e kompetencave të autorizuara me nenin 8 të këtij ligji, përfshirë numrin dhe natyrën e çdo ankese rreth përdorimit të atyre kompetencave, por duke mos i përmendë emrat e personave të përfshirë; dhe</p> <p>5.8. informata tjera të përcaktuara të kërkuara nga Ministri.</p> <p style="text-align: center;">Neni 51 Kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm</p> <p>1. Administrata Tatimore e Kosovës</p>	<p>5.4. estimates of the cost of collection for each type of tax revenue collected;</p> <p>5.5. details of all tax liabilities canceled under Article 39, including the names of the persons whose liability has been canceled and the amount canceled;</p> <p>5.6. details of all initiations of proceedings for criminal tax offenses, where the investigation was commenced by the TAK, including the name of each person who has been convicted, the sentence issued, and the amounts of tax involved;</p> <p>5.7. information on the use of the powers authorized by Article 8 of this law, including the number and nature of any appeals about the use of those powers, but not including the names of the persons involved; and</p> <p>5.8. other specified information requested by the Minister.</p> <p style="text-align: center;">Article 51 Criteria for the selection and appointment of the Executive Director</p> <p>1. The Tax Administration of Kosovo is led</p>	<p>5.4. procene troškova naplate za svaku vrstu prikupljenog poreskog prihoda;</p> <p>5.5. pojedinosti o svim poreskim obavezama poništenim prema članu 39, uključujući imena lica čija je obaveza otkazana i iznos otkazan;</p> <p>5.6. pojedinosti o svim krivičnim gonjenjima u poreskoj oblasti, kada je istraga pokrenuta od strane PAK-a, uključujući ime svake osobe koja je osuđena, izrečenu kaznu i iznos uključenog poreza;</p> <p>5.7. informacije o korišćenju ovlašćenja iz člana 8. ovog zakona, uključujući broj i prirodu žalbi na korišćenje ovih ovlašćenja, ali ne pominjući imena uključenih lica; i</p> <p>5.8. druge određene informacije koje zahteva ministar.</p> <p style="text-align: center;">Član 51 Kriterijumi za izbor i imenovanje izvršnog direktora</p> <p>1. Poresku administraciju Kosova vodi</p>
---	---	--

<p>udhëhiqet nga Drejtori, që do të emërohet nga Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës bazuar në rekomandimin e dorëzuar nga Ministri. Rekomandimi i tillë bëhet pas kompletimit të procesit të rekrutimit nga Ministria.</p> <p>2. Kandidati për Drejtor duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret vijuese:</p> <p>2.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;</p> <p>2.2. të ketë diplomë universitare nga fusha e ekonomisë, juridikut apo në fusha të ngjashme, e lëshuar nga universitetet me programe të akredituara në Republikën e Kosovës apo e nostrifikuar sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>2.3. të ketë tetë (8) vite përvojë pune, prej tyre pesë (5) vite përvojë në pozitë menaxheriale;</p> <p>2.4. të mos ketë qenë i dënuar për veprë penale me aktgjykim të formës së prerë;</p> <p>2.5. të mos jetë përjashtuar nga puna për shkelje të rënda disiplinore; dhe</p> <p>2.6. të mos ketë konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e</p>	<p>by the Director, who will be appointed by the Prime Minister of the Government of the Republic of Kosovo based on the recommendation submitted by the Minister. Such recommendation is made after the completion of the recruitment process by the Ministry.</p> <p>2. The candidate for Director must have the following qualifications and meet the following criteria:</p> <p>2.1. be a citizen of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.2. have a university degree in the field of economics, law or similar fields, issued by universities with accredited programs in the Republic of Kosovo or certified according to the legislation in force;</p> <p>2.3. have eight (8) years of work experience, of which five (5) years of experience in a managerial position;</p> <p>2.4. has not been convicted of a criminal offense by a final court decision;</p> <p>2.5. has not been dismissed from work for serious disciplinary violations; and</p> <p>2.6. has no conflict of interest according to the legislation in force in the Republic</p>	<p>direktor, koga će imenovati resorni ministar finansija nakon završetka procesa zapošljavanja od strane Ministarstva.</p> <p>2. Kandidat za direktora mora da ima kvalifikacije i da ispunjava sledeće kriterijume:</p> <p>2.1. da bude državljinin Republike Kosovo;</p> <p>2.2. da ima univerzitetsku diplomu iz oblasti ekonomije, prava ili sličnih oblasti, izdatu od univerziteta sa akreditovanim programima u Republici Kosovo ili nostrifikovanu prema zakonodavstvu na snazi;</p> <p>2.3. da ima osam (8) godina radnog iskustva, od čega pet (5) godina iskustva na rukovodećim pozicijama;</p> <p>2.4. da nije pravosnažnom presudom osuđivan za krivično delo;</p> <p>2.5. nisu otpušteni s posla zbog ozbiljnih disciplinskih prekršaja; i</p> <p>2.6. da nema sukoba interesa u skladu sa zakonodavstvom na snazi u</p>
---	--	--

Kosovës.	of Kosovo.	Republici Kosovo.
<p>3. Secili kandidat për pozitën e Drejtorit i nënshtrohet verifikimit të sigurisë sipas ligjit përkatës në fuqi.</p> <p>4. Drejtori ka mandat katër (4) vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat, me vendim të Kryeministrit, bazuar në performancën sipas rekomandimit nga Ministri, pa zhvilluar procedurat e rekrutimit të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>5. Me përfundimin e mandatit të Drejtorit, nëse i njëjti ka qenë para emërimit në pozitën e zyrtarit tatimor, ai ose ajo kthehet në pozitën paraprake ose në ndonjë pozitë ekuivalente me të.</p> <p>6. Procedura e rekrutimit, përzgjedhjes dhe afati për emërimin e Drejtorit, përcaktohet me akt nënligjor të Ministrit.</p>	<p>3. Each candidate for the position of Director is subject to security verification according to the relevant law in force.</p> <p>4. The director is appointed for a term of four (4) years, with the possibility of extension for another term, by decision of the Prime Minister, based on the performance as recommended by the Minister, without conducting the recruitment procedures provided for in paragraph 1 of this article.</p> <p>5. At the end of the Director's term, if he or she was in the position of tax official before the appointment, he or she shall return to the previous position or to a position equivalent to it.</p> <p>6. The recruitment and selection procedure and the deadline for the appointment of the Director, shall be determined by a by-law of the Minister.</p>	<p>3. Svaki kandidat za poziciju direktora podleže sigurnosnoj proveru u skladu sa relevantnim zakonom na snazi.</p> <p>4. Direktor ima mandat od četiri (4) godine, sa mogućnošću produženja za još jedan mandat, odlukom ministra, na osnovu svog rada, bez razvijanja procedure prijema u radni odnos iz stava 1. ovog člana.</p> <p>5. Po isteku mandata direktora, ako je bio pre imenovanja na poziciju poreskog službenika, vraća se na prethodnu poziciju ili na bilo koju poziciju koja joj je ekvivalentna.</p> <p>6. Postupak regrutacije, izbora i rok za imenovanje direktora, utvrđuje se podzakonskim aktom ministra.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 52 Përfundimi i mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm</p> <p>1. Mandati i Drejtorit përfundon me:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. humbjen e shtetësisë apo zotësisë për veprim;</p>	<p style="text-align: center;">Article 52 Executive Director's term completion</p> <p>1. The mandate of the Director shall end upon:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. loss of citizenship or legal capacity;</p>	<p style="text-align: center;">Član 52 Završetak mandata izvršnog direktora</p> <p>1. Mandat direktora prestaje kada:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. izgubi državljanstvo ili radnu sposobnost;</p>

<p>1.2. pamundësinë ose paaftësinë e ushtrimit të detyrës më gjatë se gjashtë (6) muaj;</p> <p>1.3. pushimin e kushteve mbi të cilat bazohet emërimi;</p> <p>1.4. skadimin e mandatit;</p> <p>1.5. dorëheqje, duke i ofruar Ministrit njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditëve;</p> <p>1.6. arritjen e moshës së pensionimit;</p> <p>1.7. dënim me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale; dhe</p> <p>1.8. vdekje.</p> <p>2. Drejtori shkarkohet nga detyra nga Kryeministri, para përfundimit të mandatit, pas rekomandimit të Ministrit, edhe për së paku njërën nga arsyet e mëposhtme:</p> <p>2.1. për shkak të shkeljeve të rënda disiplinore; dhe</p> <p>2.2. për shkak të performancës jo të mirë, të dokumentuar.</p> <p>3. Në rastet e shkarkimit, dorëheqjes apo pezullimit të Drejtorit, me propozim të Ministrit, Kryeministri emëron ushtrues</p>	<p>1.2. impossibility or inability to exercise the duty for longer than six (6) months;</p> <p>1.3. termination of the conditions on which the appointment is based;</p> <p>1.4. expiration of the term;</p> <p>1.5. resignation, providing the Minister with thirty (30) days prior notice;</p> <p>1.6. reaching retirement age;</p> <p>1.7. conviction by final judgment for a criminal offense; and</p> <p>1.8. death.</p> <p>2. The director is dismissed from office by the Prime Minister, before the end of the term, upon recommendation of the Minister, for at least one of the following reasons:</p> <p>2.1. due to serious disciplinary violations; and</p> <p>2.2. due to documented poor performance.</p> <p>3. In cases of dismissal, resignation or suspension of the Director, at the proposal of the Minister, the Prime Minister shall</p>	<p>1.2. nije u mogućnosti ili nije sposoban da obavlja dužnost duže od šest (6) meseci;</p> <p>1.3. prestanu uslova na kojima se zasniva njegovo imenovanje;</p> <p>1.4. istekne mandat;</p> <p>1.5. da ostavku, uz obaveštenje ministra trideset (30) dana unapred;</p> <p>1.6. dostigne starosnu dob za penziju;</p> <p>1.7. pravosnažno je osuđen za krivično delo; i</p> <p>1.8. u slučaju smrti.</p> <p>2. Direktora razrešava predsednik Vlade, pre isteka mandata, na predlog ministra, iz najmanje jednog od sledećih razloga:</p> <p>2.1. zbog teških disciplinskih prekršaja; i</p> <p>2.2. zbog dokumentovanog lošeg učinka.</p> <p>3. U slučaju razrešenja, ostavke ili suspenzije direktora, na predlog ministra, predsednik Vlade imenuje vršioca</p>
--	--	---

<p>detyre, njërin nga vartësit e Drejtorit, për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 53 Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës</p> <p>Administrata Tatimore e Kosovës ka dy (2) Zëvendës Drejtor të Përgjithshëm (në tekstin e mëtejshëm: Zëvendës Drejtor) të cilët mbështesin Drejtorin, emërimi dhe lirimi i të cilit bëhet me pëlqimin e Ministrit pas propozimit nga Drejtori.</p> <p style="text-align: center;">Neni 54 Kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm</p> <p>1. Kandidati për Zëvendës Drejtor duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret vijuese:</p> <p>1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2. të ketë diplomë universitare nga fusha e ekonomisë, juridikut apo në fusha të ngjashme, e lëshuar nga universitetet me programe të akredituara në Republikën e Kosovës apo e nostrifikuar sipas legjislacionit në fuqi;</p>	<p>appoint an acting deputy, one of the Director's subordinates, for a period no longer than six (6) months.</p> <p style="text-align: center;">Article 53 Deputy Executive Directors of the Tax Administration of Kosovo</p> <p>The Tax Administration of Kosovo has dy (2) Deputy Executive Directors (hereinafter: Deputy Director) who support the Director, whose appointment and release is made with the consent of the Minister after the proposal by the Director.</p> <p style="text-align: center;">Article 54 Criteria for the selection and appointment of the Deputy Executive Director</p> <p>1. The candidate for Deputy Director must have the qualifications and meet the following criteria:</p> <p>1.1. be a citizen of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. have a university degree in the field of economics, law or similar fields, issued by universities with accredited programs in the Republic of Kosovo or certified according to the legislation in force;</p>	<p>dužnosti zamenika, jednog od podređenih direktoru, na period ne duži od šest (6) meseci.</p> <p style="text-align: center;">Član 53 Zamenik izvršnog direktora Poreske administracije Kosova</p> <p>Poreska administracija Kosova ima dva (2) zamenika izvršnih direktora (u daljem tekstu: zamenik direktora) koji podržavaju direktora, čije se imenovanje i razrešenje vrši uz saglasnost ministra na predlog direktora.</p> <p style="text-align: center;">Član 54 Kriterijumi za izbor i imenovanje zamenika izvršnog direktora</p> <p>1. Kandidat za zamenika direktora treba da bude kvalifikovan i da ispunjava sledeće uslove:</p> <p>1.1. da bude državljanin Republike Kosovo;</p> <p>1.2. da ima univerzitetsku diplomu iz oblasti ekonomije, prava ili sličnih oblasti, izdatu od univerziteta sa akreditovanim programima u Republici Kosovo ili nostrifikovanu prema zakonodavstvu na snazi;</p>
--	--	--

<p>1.3. të ketë tetë (8) vite përvojë pune, prej tyre katër (4) vite përvojë në pozitë menaxheriale;</p> <p>1.4. të mos ketë qenë i dënuar për veprë penale me aktgjykim të formës së prerë;</p> <p>1.5. të mos jetë përjashtuar nga puna për shkelje të rënda disiplinore; dhe</p> <p>1.6. të mos ketë konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Secili kandidat për pozitën e Zëvendës Drejtorit i nënshtrohet verifikimit të sigurisë sipas ligjit përkatës në fuqi.</p> <p>3. Zëvendës Drejtori ka mandat katër (4) vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat, me vendim të Ministrit, bazuar në performancën sipas rekomandimit nga Drejtori, pa zhvilluar procedurat e rekrutimit të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p>4. Me përfundimin e mandatit të Zëvendës Drejtorit, nëse i njëjti ka qenë para emërimit në pozitën e zyrtarit tatimor, ai ose ajo kthehet në pozitën paraprake ose në ndonjë pozitë ekuivalente me të.</p> <p>5. Procedura e rekrutimit, përzgjedhjes dhe afati për emërimin e Zëvendës Drejtorit,</p>	<p>1.3. have eight (8) years of work experience, of which four (4) years of experience in a managerial position;</p> <p>1.4. has not been convicted of a criminal offense by a final court decision;</p> <p>1.5. has not been dismissed from work for serious disciplinary violations; and</p> <p>1.6. has no conflict of interest according to of the legislation in force in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Each candidate for the position of Deputy Director is subject to security verification according to the relevant law in force.</p> <p>3. The Deputy Director is appointed for a term of four (4) years, with the possibility of extension for another term, by decision of the Minister, based on the performance as recommended by the Director, without conducting the recruitment procedures provided for in paragraph 1 of this article.</p> <p>4. At the end of the Deputy Director's term, if he or she was in the position of tax official before the appointment, he or she shall return to the previous position or to a position equivalent to it.</p> <p>5. The recruitment, selection procedure and the deadline for the appointment of the</p>	<p>1.3. da ima osam (8) godina radnog iskustva, od čega četiri (4) godine iskustva na poziciji upravljanja;</p> <p>1.4. da nije osuđivan za krivična dela pravosnažnom presudom;</p> <p>1.5. da nije otpušten sa posla zbog disciplinskih prekršaja; i</p> <p>1.6. da nije u sukobu interesa prema zakonodavstvu na snazi u Republici Kosovo.</p> <p>2. Svaki kandidat za mesto zamenika direktora podleže sigurnosnoj proveri u skladu sa važećim zakonom.</p> <p>3. Zamenik direktora ima mandat od četiri (4) godine, sa mogućnošću produženja za još jedan mandat odlukom ministra, na osnovu rada po preporuci direktora, bez razvijanja procedura zapošljavanja predviđenih stavom 1. ovog člana.</p> <p>4. Po isteku mandata zamenika direktora, ako je pre imenovanja bio na poziciji poreskog službenika, vraća se na prethodnu poziciju ili na bilo koju njemu ekvivalentnu funkciju.</p> <p>5. Postupak prijema, izbora i rok za</p>
--	--	---

<p>përcaktohet me akt nënligjor të Ministrit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 55 Përfundimi i mandatit të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm</p> <p>1. Mandati i Zëvendës Drejtorit përfundon me:</p> <p>1.1. humbjen e shtetësisë apo zotësisë për veprim;</p> <p>1.2. pamundësinë ose paaftësinë e ushtrimit të detyrës më gjatë se gjashtë (6) muaj;</p> <p>1.3. pushimin e kushteve mbi të cilat bazohet emërimi;</p> <p>1.4. skadimin e mandatit;</p> <p>1.5. dorëheqje, duke i ofruar Drejtorit njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditëve;</p> <p>1.6. arritjen e moshës së pensionimit;</p> <p>1.7. dënim me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale; dhe</p> <p>1.8. vdekje.</p> <p>2. Zëvendës Drejtori shkarkohet nga</p>	<p>Deputy Director, shall be determined by a by-law of the Minister.</p> <p style="text-align: center;">Article 55 Deputy Executive Director's term completion</p> <p>1. The mandate of the Deputy Director shall end upon:</p> <p>1.1. loss of citizenship or legal capacity;</p> <p>1.2. impossibility or inability to exercise the duty for longer than six (6) months;</p> <p>1.3. termination of the conditions on which the appointment is based;</p> <p>1.4. expiration of the term;</p> <p>1.5. resignation, providing the Director with thirty (30) days prior notice;</p> <p>1.6. reaching retirement age;</p> <p>1.7. conviction by final judgment for a criminal offense; and</p> <p>1.8. death.</p> <p>2. The Deputy Director is dismissed from</p>	<p>imenovanje zamenika direktora utvrđuje se podzakonskim aktom ministra.</p> <p style="text-align: center;">Član 55 Završetak mandata zamenika izvršnog direktora</p> <p>1. Mandat zamenika direktora prestaje kada:</p> <p>1.1. izgubi državljanstvo ili radnu sposobnost;</p> <p>1.2. nije u mogućnosti ili nije sposoban da obavlja dužnost duže od šest (6) meseci;</p> <p>1.3. prekinu se uslovi na kojima se zasniva njegovo imenovanje;</p> <p>1.4. istekne mu mandat;</p> <p>1.5. da ostavku, pružajući ministru obaveštenje unapred trideset (30) dana;</p> <p>1.6. dostigne starosnu dob za penziju;</p> <p>1.7. pravosnažno je osuđen za krivično delo; i</p> <p>1.8. u slučaju smrti.</p> <p>2. Zamenika direktora razrešava ministar,</p>
---	--	---

<p>detyra nga Ministri, para përfundimit të mandatit, pas rekomandimit të Drejtorit, edhe për së paku njëri nga arsyet e mëposhtme:</p> <p>2.1. për shkak të shkeljeve të rënda disiplinore; dhe</p> <p>2.2. për shkak të performancës jo të mirë, të dokumentuar.</p> <p>3. Në rastet e shkarkimit, dorëheqjes apo pezullimit të Zëvendës Drejtorit, me propozim të Drejtorit, Ministri emëron ushtrues detyre, njërin nga vartësit e Zëvendës Drejtorit, për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj.</p>	<p>office by the Minister, before the end of the term, upon recommendation of the Director, for at least one of the following reasons:</p> <p>2.1. due to serious disciplinary violations; and</p> <p>2.2. due to documented poor performance.</p> <p>3. In cases of dismissal, resignation or suspension of the Deputy Director, at the proposal of the Director, the Minister shall appoint an acting deputy, one of the Deputy Director's subordinates, for a period no longer than six (6) months.</p>	<p>pre isteka mandata, na predlog direktora, iz najmanje jednog od sledećih razloga:</p> <p>2.1. zbog teških disciplinskih prekršaja; i</p> <p>2.2. zbog dokumentovanog lošeg učinka.</p> <p>3. U slučaju razrešenja, ostavke ili suspenzije zamenika direktora, predlogom direktora, ministar imenuje vršioca dužnosti, jednog od podređenih zameniku direktora, za period ne duži od šest (6) meseci.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 56 Hetimet Tatimore dhe Inteligjenca</p> <p>1. Administrata Tatimore e Kosovës siguron brenda strukturës së saj funksionimin e Njësisë së Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës, si njësi e specializuar dhe përgjegjëse për:</p> <p>1.1. hetime administrative në fushën e tatimeve;</p> <p>1.2. përcaktimin e bazave tatimore dhe kryerjen e vlerësimeve në rastet e hetimeve administrative në fushën e tatimeve; dhe</p>	<p style="text-align: center;">Article 56 Tax Investigations and Intelligence</p> <p>1. The Tax Administration of Kosovo ensures within its structure the functioning of the Tax Investigations and Intelligence Unit, as a specialized unit responsible for:</p> <p>1.1. administrative investigations in the field of taxes;</p> <p>1.2. determining the tax base and carrying out assessments in cases of administrative investigations in the field of taxes;</p>	<p style="text-align: center;">Član 56 Poreske i obaveštajne istrage</p> <p>1. Poreska administracija Kosovo unutar njene strukture obezbeđuje funkcionisanje Jedinice poreske i obaveštajne istrage, kao specijalizovane jedinice odgovorne za:</p> <p>1.1. administrativna istraživanja u oblasti poreza;</p> <p>1.2. utvrđivanje poreskih osnova i vršenja procena u slučajevima administrativnih istraga u oblasti poreza;</p>

<p>1.3. mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, analizën e informatave dhe shpërndarjen e tyre tek institucionet e zbatimit të ligjit.</p> <p>2. Përveç kompetencave të dhëna sipas nenit 92, zyrtarët e Njësisë së Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës i kanë kompetencat dhe përgjegjësitë që i posedon cilido zyrtar tatimor i autorizuar nga Drejtori, lidhur me procedurat tatimore, siç janë:</p> <p>2.1. qasje në libra, regjistra, kompjuterë dhe pajisje tjera regjistrash, siç janë dhënë në nenin 8 të këtij ligji;</p> <p>2.2. mbledhja e informatave apo dëshmimeve, siç janë dhënë në nenin 9 të këtij Ligji;</p> <p>2.3. përgatitja e vlerësimeve në rast rreziku sipas nenit 17 të këtij Ligji;</p> <p>2.4. përgatitja e kërkesave për embargo të importit dhe eksportit sipas nenit 36 të këtij Ligji;</p> <p>2.5. përgatitja e informatave me shkrim për Policinë e Kosovës për moslejimet për largim sipas nenit 37 të këtij Ligji; dhe</p> <p>2.6. të kenë qasje direkte në DK gjatë vlerësim-zhdoganimit të mallrave të</p>	<p>1.3. collection, processing, storing, analyzing information and distributing it to law enforcement institutions.</p> <p>2. In addition to the powers granted under Article 92 of this law, the officials of the Tax Investigation Unit shall have the powers and the responsibilities that any tax officer authorized by the Director has in the taxation procedure, such as:</p> <p>2.1. access to books, records, computers and similar record storage devices as provided for in Article 8 of this law,</p> <p>2.2. collection of information or evidence as provided for in Article 9 of this law,</p> <p>2.3. preparations of jeopardy assessments according to Article 17 of this law,</p> <p>2.4. preparations of requests for embargoes on import and export according to Article 36 of this law,</p> <p>2.5. preparations for the written information for the Border Police for departure prohibitions according to Article 37 of this law.</p> <p>2.6. having direct access to the KC during the assessment-clearance of goods</p>	<p>1.3. prikupljanje, obradu, skladištenje, analizu informacija i njegovu distribuciju institucijama za sprovođenje zakona.</p> <p>2. Pored ovlašćenja koja su data članom 92, službenici Jedinice za poreske i obaveštajne istrage imaju ovlašćenja i odgovornosti koje poseduje svaki poreski službenik kojeg ovlasti direktor, a u vezi sa poreskim postupcima, kao što su:</p> <p>2.1. pristup knjigama, registrima, kompjuterima i drugoj opremi za registar, kao što je predviđeno članom 8. ovog zakona;</p> <p>2.2. prikupljanje informacija ili dokaza, kako je predviđeno članom 9. ovog zakona;</p> <p>2.3. priprema procene rizika u skladu sa članom 17. ovog zakona;</p> <p>2.4. priprema uvoznih i izvoznih zahteva za embargo u skladu sa članom 36. ovog zakona;</p> <p>2.5. priprema pismene informacije za Policiju Kosova o odbijanju napuštanja u skladu sa članom 37. ovog zakona; i</p> <p>2.6. imaju direktan pristup CK tokom procene carinjenja robe poreskih</p>
---	---	---

<p>tatimpaguesve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 57 Ankesat</p> <p>Administrata Tatimore e Kosovës siguron brenda strukturës së saj funksionimin e Njesisë së Ankesave, e cila ka përgjegjësi të vlerësojë kërkesat për rishqyrtim nga personat të cilët kundërshtojnë një vlerësim ose vendim të ATK sipas legjislacionit të administruar nga ATK, si instancë e parë ankimore në procedurën administrative.</p> <p style="text-align: center;">Neni 58 Avokati i Tatimpaguesve</p> <p>1. Administrata Tatimore e Kosovës siguron brenda strukturës së saj funksionimin e Avokatit të Tatimpaguesve, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të tatimpaguesve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, si dhe për t'u ndihmuar tatimpaguesve në zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve, për të cilat ata pretendojnë se nuk janë trajtuar drejtë ose në kohë.</p> <p>2. Avokati i Tatimpaguesve nuk është zëvendësim për procedurat e rregullta ose procedurën e ankesave.</p> <p>3. Avokati i Tatimpaguesve mbron</p>	<p>of taxpayers.</p> <p style="text-align: center;">Article 57 Appeals</p> <p>The Tax Administration of Kosovo ensures within its structure the functioning of the Appeals Unit, which is responsible for evaluating claims for review by persons who oppose a TAK assessment or decision according to the legislation administered by the TAK, as the first appeal instance in the administrative procedure.</p> <p style="text-align: center;">Article 58 Taxpayers' Ombudsperson</p> <p>1. The Tax Administration of Kosovo shall ensure within its structure the operation of the Taxpayers' Ombudsperson, with the aim of protecting the rights of taxpayers defined by the legislation in force, as well as to help taxpayers in solving problems and issues, for which they claim that they were not treated fairly or in a timely manner.</p> <p>2. The Taxpayers' Ombudsperson is not a substitute for due process or the appeals process.</p> <p>3. The Taxpayers' Ombudsperson shall</p>	<p>obveznika.</p> <p style="text-align: center;">Član 57 Žalbe</p> <p>Poreska administracija Kosova obezbeđuje u okviru svoje strukture funkcionisanje Jedinice za žalbe, koja je odgovorna za procenu zahteva za preispitivanje od strane lica koja se protive proceni ili odluci PAK-a u skladu sa zakonodavstvom koji administruje PAK, kao prve žalbene instance u upravnom postupku.</p> <p style="text-align: center;">Član 58 Advokat poreskog obveznika</p> <p>1. Poreska uprava Kosova obezbeđuje u okviru svoje strukture funkcionisanje Advokata poreskih obveznika, sa ciljem zaštite prava poreskih obveznika definisanih zakonima na snazi, kao i da pomogne poreskim obveznicima u rešavanju problema i pitanja na koja se polažu. nisu obrađeni pošteno ili blagovremeno.</p> <p>2. Advokat poreskih obveznika nije zamjena za redovne postupke ili žalbeni postupak.</p> <p>3. Advokat poreskog obveznika štiti</p>
---	---	--

<p>interesat e tatimpaguesit në marrëdhëniet me ATK.</p> <p>4. Avokati i Tatimpaguesve ka këto funksione:</p> <p>4.1. të ndihmojë tatimpaguesin të zgjidh problemet me ATK;</p> <p>4.2. të shqyrtojë çdo kërkesë të tatimpaguesit dhe të rekomandojë veprime për zgjidhjen e çështjes, në rastet kur tatimpaguesi pretendon se procedurat lidhur me vendosjen e çështjes së konstatuar nga tatimpaguesi nuk janë zbatuar drejtë ose në kohë;</p> <p>4.3. të bashkëpunojë me Departamentin e Shërbimit të Tatimpaguesve, për të promovuar rolin e Avokatit të Tatimpaguesve në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesve;</p> <p>4.4. të bashkëpunojë me të gjitha Departamentet në ATK, për të garantuar që tatimpaguesit të trajtohen apo do të trajtohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe se të drejtat e tyre mbrohen dhe respektohen në mënyrën e duhur nga zyrtarët e ATK;</p> <p>4.5. të informojë Zëvendës Drejtorët</p>	<p>protects taxpayer interests with regards to the TAK.</p> <p>4. The Taxpayers' Ombudsperson shall have the following functions:</p> <p>4.1. help the taxpayer to solve problems with the TAK;</p> <p>4.2. review any taxpayer claim and recommend actions to resolve the case when the taxpayer claims that the procedures related to the determination of the case ascertained by the taxpayer were not implemented correctly or in a timely manner;</p> <p>4.3. cooperate with the Taxpayer Service Department to promote the role of the Taxpayers' Ombudsperson in protecting the rights of taxpayers;</p> <p>4.4. cooperate with all Departments within the TAK, to guarantee that taxpayers are treated or will be treated in accordance with the legal provisions and that their rights are protected and respected properly by TAK officials;</p> <p>4.5. inform the Deputy Directors about</p>	<p>interese poreskog obveznika u odnosima sa PAK-om.</p> <p>4. Zastupnik poreskih obveznika ima sledeće funkcije:</p> <p>4.1. da pomogne poreskom obvezniku da reši probleme sa PAK-om;</p> <p>4.2. da ispita svaki zahtev poreskog obveznika i preporuči radnje za rešavanje slučaja, u slučajevima kada poreski obveznik tvrdi da postupci u vezi sa utvrđivanjem slučaja koje je utvrdio poreski obveznik nisu sprovedeni pravilno ili blagovremeno;</p> <p>4.3. saraduje sa Službom za poreske obveznike na promovisanju uloge advokata poreskih obveznika u zaštiti prava poreskih obveznika;</p> <p>4.4. da saraduje sa svim odeljenjima u PAK-u, da garantuje da se poreski obveznici tretiraju ili da će biti tretirani u skladu sa zakonskim odredbama i da su njihova prava zaštićena i pravilno poštovana od strane službenika PAK-a;</p> <p>4.5. da obaveštava zamenike direktora</p>
--	---	---

<p>për shkeljen e të drejtave të tatimpaguesit nga ana e zyrtarëve tatimor;</p> <p>4.6. t'i propozojë Drejtorit për përmirësime në proceset e punës dhe në procedurat tatimore, me synim përmirësimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, reduktimin e barrës administrative dhe lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit në përmbushjen e detyrimeve tatimore;</p> <p>4.7. të nxjerr rekomandime me karakter të përgjithshëm në lidhje me çështjet e identifikuar gjatë ushtrimit të funksioneve të tij dhe i përdor ato si bazë për të bërë propozime për ndryshimin e legjislacionit përkatës;</p> <p>4.8. të nxjerr rekomandime me shkrim drejtuar Njesisë së Ankesave dhe/ose i paraqet këto rekomandime në seancat dëgjimore administrative të mbajtura nga Njësia e Ankesave;</p> <p>5. Avokati i Tatimpaguesve nuk është i autorizuar të shqyrtojë apo të ndërhyjë në rastet, për të cilat tatimpaguesi është hetuar nga Njësia e Hetimeve Tatimore dhe Intelgjencës, si dhe për rastet për të cilat tatimpaguesi i është drejtuar Bordit,</p>	<p>the violation of taxpayer rights by tax officials;</p> <p>4.6. propose to the Director improvements in work processes and tax procedures, with the aim of improving services to taxpayers, reducing the administrative burden, and facilitating procedures for taxpayers in fulfilling tax liabilities;</p> <p>4.7. issue recommendations of a general nature regarding the issues identified during the exercise of their functions and use them as a basis for making proposals for changing the relevant legislation;</p> <p>4.8. issue written recommendations to the Appeals Unit and/or present these recommendations at the administrative hearings held by the Appeals Unit;</p> <p>5. The Taxpayers' Ombudsperson is not authorized to review or intervene in cases for which the taxpayer has been investigated by the Tax Investigation and Intelligence Unit, as well as in cases for which the taxpayer has turned to the Board, court or</p>	<p>o povredi prava poreskog obveznika od strane poreskih službenika;</p> <p>4.6. da predlaže direktoru unapređenje procesa rada i poreskih procedura, u cilju unapređenja usluga poreskim obveznicima, smanjenja administrativnog opterećenja i olakšavanja procedura poreskim obveznicima u ispunjavanju poreskih obaveza;</p> <p>4.7. daje preporuke opšte prirode u vezi sa pitanjima identifikovanim tokom obavljanja svojih funkcija i koristi ih kao osnovu za davanje predloga za izmenu relevantnog zakonodavstva;</p> <p>4.8. izdaje pismene preporuke Jedinici za žalbe i/ili predočava ove preporuke na administrativnim raspravama koje održava Jedinica za žalbe;</p> <p>5. Advokat poreskog obveznika nije ovlašćen da ispituje ili interveniše u predmetima za koje je poreski obveznik vođen istragom od strane Jedinice za poreske i obaveštajne istrage, kao ni za slučajeve za koje se poreski obveznik</p>
---	---	--

<p>gjykatës ose organit tjetër kompetent.</p> <p>6. Avokati i Tatimpaguesve nuk autorizohet të shqyrtojë apo të ndërhyjë në procesin e përcaktimit të detyrimit tatimor apo për raste, të cilat janë në proces. Megjithatë, Avokati i Tatimpaguesve është i autorizuar të shqyrtojë dhe të ndërhyjë, nëse procesi i vlerësimit të detyrimeve tatimore apo procesi i ankimimit nuk kryhet në përputhje me procedurat e vendosura në ligj apo në dispozitat përkatëse nënligjore. Ky autorizim kufizohet me të drejtën e sigurimit të respektimit të procedurave dhe jo në vendimet lidhur me shumat e vlerësuara të detyrimeve tatimore apo në vendimin e marrë për ankimim.</p> <p>7. Procedurat e hollësishme për funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen nga Avokati i Tatimpaguesve, si dhe procedurat që do të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar nga shërbimet e ofruara nga Avokati i Tatimpaguesve, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p> <p style="text-align: center;">Neni 59 Standardet Profesionale</p> <p>1. Administrata Tatimore e Kosovës siguron brenda strukturës së saj funksionimin e Njësisë së Standardeve</p>	<p>other competent body.</p> <p>6. The Taxpayers; Ombudsperson is not authorized to review or intervene in the process of determining the tax liability or in cases which are in process. However, the Taxpayers' Ombudsperson is authorized to review and intervene, if the tax liability assessment process or the appeal process is not carried out in accordance with the procedures established in the law or in the relevant by-law provisions. This authorization is limited to the right to ensure compliance with the procedures and not to the decisions related to the estimated amounts of tax liabilities or to the decision taken with regards to the appeal.</p> <p>7. The detailed procedures for the functions, responsibilities and procedures to be implemented by the Taxpayers' Ombudsperson, as well as the procedures to be followed by the taxpayers to benefit from the services provided by the Taxpayers' Ombudsperson, shall be determined by a by-law issued by the Minister.</p> <p style="text-align: center;">Article 59 Professional Standards</p> <p>1. The Tax Administration of Kosovo shall ensure within its structure the functioning of the Professional Standards Unit within its</p>	<p>obratio Odboru, sudu ili drugom nadležnom organu.</p> <p>6. Advokat poreskog obveznika nije ovlašćen da ispituje ili interveniše u postupku utvrđivanja poreske obaveze ili u predmetima koji su u postupku. Međutim, advokat poreskog obveznika je ovlašćen da ispita i interveniše, ako se postupak utvrđivanja poreske obaveze ili žalbeni postupak ne sprovede u skladu sa procedurama utvrđenim zakonom ili relevantnim podzakonskim odredbama. Ovo ovlašćenje je ograničeno na pravo da se obezbedi poštovanje procedura, a ne na odluke koje se odnose na procenjene iznose poreskih obaveza ili na odluku donetu za žalbu.</p> <p>7. Detaljne procedure za funkcije, odgovornosti i procedure koje sprovodi Zastupnik poreskih obveznika, kao i procedure kojih treba da se pridržavaju poreski obveznici da bi imali koristi od usluga koje pruža advokat poreskih obveznika, utvrđeni su podzakonskim aktom koji izdaje ministar.</p> <p style="text-align: center;">Član 59 Profesionalni standardi</p> <p>1. Poreska administracija Kosova unutar njene strukture obezbeduje funkcionisanje Jedinice profesionalnih</p>
---	--	--

<p>Profesionale në kuadër të organizimit të saj, me qëllim të mbikëqyrjes së respektimit të Kodit të Etikës nga zyrtarët tatimor dhe nëpunësit e tjerë brenda ATK.</p> <p>2. Njësia e Standardeve Profesionale ka përgjegjësi të siguroj zbatimin e Kodit të Etikës dhe ka autorizimet, si në vijim:</p> <p>2.1. të përgatis plane operative dhe plane afatmesme për ruajtjen e integritetit të ATK;</p> <p>2.2. të mbaj trajnime për zyrtarët tatimorë për Kodin e Etikës dhe Kodin e veshjes;</p> <p>2.3. të mbajë trajnime për zyrtarët tatimorë në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit;</p> <p>2.4. të mbajë trajnime për zyrtarët tatimorë në lidhje me detyrimet që përcaktohen me ligjin përkatës për zyrtarët publik;</p> <p>2.5. të ofrojë këshilla për zyrtarët tatimor lidhur me zbatimin e Kodit të Etikës dhe parandalimin e konfliktit të interesit;</p> <p>2.6. të monitorojë zyrtarët tatimor</p>	<p>organization, with the aim of supervising compliance with the Code of Ethics by tax officials and other employees within the TAK.</p> <p>2. The Professional Standards Unit is responsible for ensuring the implementation of the Code of Ethics and has the following authorizations:</p> <p>2.1. hold trainings for tax officials on the Code of Ethics and the Dress Code;</p> <p>2.2. hold trainings for tax officials regarding the prevention of conflict of interest;</p> <p>2.3. hold trainings for tax officials with regards to the obligations that are determined by the relevant law on public officials;</p> <p>2.4. provide advice to tax officials regarding the implementation of the Code of Ethics and the prevention of conflict of interest;</p> <p>2.5. provide advice to tax officials regarding the implementation of the Code of Ethics and prevention of conflicts of interest;</p> <p>2.6. monitor tax officials regarding the</p>	<p>standarda u okviru njene organizacije, u cilju nadzora poštovanja Etičkog kodeksa poreskih službenika i drugih zaposlenih u PAK-u.</p> <p>2. Jedinica profesionalnih standarda ima odgovornost da obezbedi sprovođenje Etičkog kodeksa i ima sledeća ovlašćenja:</p> <p>2.1. održava obuke za poreske službenike o Etičkom kodeksu i Kodeksu oblačenja;</p> <p>2.2 održava obuke za poreske službenike u vezi sa sprečavanjem sukoba interesa;</p> <p>2.3. održava obuke za poreske službenike u vezi sa obavezama koje su utvrđene relevantnim zakonom za javne službenike;</p> <p>2.4. daje savete poreskim službenicima u vezi s primenom Etičkog kodeksa i sprečavanjem sukoba interesa;</p> <p>2.5. pruža savete poreskim zvaničnicima u vezi sa primenom Etičkog kodeksa i sprečavanjem sukoba interesa;</p> <p>2.6. nadzire poreske službenike u</p>
--	--	--

<p>lidhur me zbatimin e Kodit të Etikes;</p> <p>2.7. të sigurojë informata bazuar në kërkesën e Drejtorit, Njësisë së Burimeve Njerëzore dhe komisionit disiplinor në ATK, me qëllim të ruajtjes së integritetit të ATK;</p> <p>2.8. të verifikojë të kaluarën e zyrtarit tatimor të ri;</p> <p>2.9. të pranojë dhe shqyrtoj ankesat për shkeljen e Kodit të Etikës;</p> <p>2.10. të shqyrtojë kërkesën e zyrtarit tatimor për punë dytësore, si dhe të nxjerrë vendim për aprovim ose refuzim të kërkesës; dhe</p> <p>2.11. të ndërlidhë dhe shkëmbejë informata me institucionet tjera përkatëse, me qëllim që të sigurojnë integritet dhe siguri të ATK;</p>	<p>implementation of the Code of Ethics;</p> <p>2.7. provide information based on the request of the Director, Human Resources Unit and disciplinary committee at TAK, in order to preserve the integrity of TAK;;</p> <p>2.8. verify the background of new tax officials;</p> <p>2.9. receive and review appeals for violations of the Code of Ethics;</p> <p>2.10. examine tax official requests for secondary work, as well as issue a decision on approval or rejection of the request; and</p> <p>2.11. connect and exchange information with other relevant institutions, in order to ensure the integrity and security of the TAK;</p>	<p>pogledu primene Etičkog kodeksa;</p> <p>2.7. pruži informacije na osnovu zahteva direktora, Jedinice za ljudske resurse i disciplinske komisije u TAK-u, u cilju očuvanja integriteta TAK;</p> <p>2.8. proverava prošlost novog poreskog službenika;</p> <p>2.9. prihvata i razmatra žalbe za kršenje Etičkog kodeksa;</p> <p>2.10. razmatra zahtev poreskog službenika za sporedni rad, kao i donosi rešenje o usvajanju ili odbijanju zahteva; i</p> <p>2.11. komunicira i razmenjuje informacije i drugim relevantnim institucijama, kako bi se obezbedio integritet i bezbednost PAK-a;</p>
<p style="text-align: center;">Neni 60 Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative</p>	<p style="text-align: center;">Article 60 Office for Fines and Administrative Penalties</p>	<p style="text-align: center;">Član 60 Kancelarija za novčane kazne i administrativne kazne</p>
<p>Administrata Tatimore e Kosovës siguron brenda strukturës së saj</p>	<p>The Tax Administration of Kosovo shall ensure within its structure the functioning of</p>	<p>Poreska administracija Kosova u okviru svoje strukture obezbeđuje</p>

<p>funksionimin e Zyrës për Gjopa dhe Ndëshkime Administrative (në tekstin e mëtejshëm: ZGjoNA), e cila trajton shkeljet ligjore për të gjitha të gjeturat nga njësitë operative, si dhe nxjerr vendime që kanë të bëjnë me ndëshkime dhe gjopa të përcaktuara në legjislacionin tatimor.</p>	<p>the Office for Administrative Fines and Penalties (hereinafter: OFAP), which deals with legal violations from all findings by operational units, as well as issues decisions related to punishments and fines defined in the tax legislation.</p>	<p>funkcionisanje Kancelarije za kazne i administrativne sankcije (u daljem tekstu: KKAS), koja se bavi zakonskim prekršajima za sve nalaze operativnih jedinica, kao i donosi odluke u vezi sa kaznama i novčanim kaznama definisanim poreskim zakonodavstvom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 61 Bordi i Ankesave</p>	<p style="text-align: center;">Article 61 Appeals Board</p>	<p style="text-align: center;">Član 61 Odbor za žalbe</p>
<p>1. Me këtë ligj themelohet Bordi i Ankesave në Ministri për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të nxjerra nga Njësia e Ankesave në ATK dhe DK lidhur me çështjet tatimore dhe doganore.</p>	<p>1. With this law, the Board of Appeals in the Ministry is established for the review of appeals against decisions issued by the TAK Appeals Unit and KC with regards to tax and customs matters.</p>	<p>1. Ovim zakonom formira se Odbor za žalbe u Ministarstvu za razmatranje žalbi na odluke donete od strane Jedinice za žalbe u PAK-u i CK u vezi sa poreskim i carinskim pitanjima.</p>
<p>2. Bordi përbëhet prej një (1) kryesuesi dhe tetë (8) anëtarëve, të cilët emërohen për një mandat prej katër (4) viteve, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat të dytë</p>	<p>2. The board consists of one (1) Chairperson and eight (8) members, who are appointed for a term of four (4) years, with the possibility of extension for a second term.</p>	<p>2. Odbor se sastoji od jednog (1) predsedavajućeg i osam (8) članova koji se imenuju na mandat od četiri (4) godine, sa mogućnošću produženja za drugi mandat.</p>
<p>3. Anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes sipas kriterëve të parapara me këtë Ligj nëpërmjet shpalljes publike.</p>	<p>3. The members of the Board are appointed by the Minister after the completion of the selection process according to the criteria provided by this Law through public announcement.</p>	<p>3. Članove Odbora imenuje ministar nakon završetka procesa selekcije u skladu sa kriterijumima predviđenim ovim zakonom putem javnog oglasa.</p>
<p>4. Për t'u emëruar anëtar i Bordit, kandidati duhet të plotësojnë kriteret, si në vijim:</p>	<p>4. To be appointed Board members, a candidate must meet the following criteria:</p>	<p>4. Da bi bio imenovan za člana Odbora, kandidat mora ispunjavati sledeće kriterijume:</p>
<p>4.1. të jetë shtetas i Republikës së</p>	<p>4.1. be a citizen of the Republic of</p>	<p>4.1. . da bude državljanin Republike</p>

<p>Kosovës;</p> <p>4.2. të ketë diplomë universitare nga fusha e ekonomisë, juridikut apo në fusha të ngjashme, e lëshuar nga universitetet me programe të akredituara në Kosovë apo e nostrifikuar sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>4.3. të ketë pesë (5) vite përvojë pune, në fushën e tatimeve apo doganave në sektor publik ose privat;</p> <p>4.4. të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale me aktgjykim të formës së prerë; dhe</p> <p>4.5. të mos ketë konflikt interesi me detyrën apo konflikt interesi të natyrës tjetër, siç parashihet me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.</p> <p>5. Kryesuesi i Bordit i raporton Ministrit mbi veprimtarinë dhe rezultatet e Bordit.</p> <p>6. Anëtarët e Bordit mund të largohen nga Bordi me vendim të Ministrit për njërin nga arsyet e mëposhtme:</p> <p>6.1. nëse është dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale;</p> <p>6.2. për shkak të pamundësisë ose paaftësisë së ushtrimit të detyrës më</p>	<p>Kosovo;</p> <p>4.2. have a university degree in the field of economics, law or similar fields, issued by universities with accredited programs in Kosovo or certified according to the legislation in force;</p> <p>4.3. have 5 (5) years of work experience in the field of taxes or customs in the public or private sector;</p> <p>4.4. has not been convicted of a criminal offense by a final court decision; and</p> <p>4.5. has no conflict of interest with the task or any conflict of interest of another nature, as provided by the Law on the prevention of conflict of interest in the discharge of a public function.</p> <p>5. The Chairperson of the Board shall report to the Minister on the activities and results of the Board.</p> <p>6. Board members may leave the Board by decision of the Minister for one of the following reasons:</p> <p>6.1. in case of conviction by final judgment for a criminal offense;</p> <p>6.2. due to the impossibility or inability to exercise the duty for longer than six</p>	<p>Kosovo;</p> <p>4.2. da ima univerzitetsku diplomu iz oblasti ekonomije, prava ili sličnih oblasti, izdatu od univerziteta sa akreditovanim programima u Republici Kosovo ili nostrifikovanu prema zakonodavstvu na snazi;</p> <p>4.3. da ima pet (5) godina radnog iskustva, iz oblasti poreza ili carina u javnom ili privatnom sektoru;</p> <p>4.4. da nije osuđivan za krivična dela pravosnažnom presudom; i</p> <p>4.5. da nema sukoba interesa na položaju ili sukoba interesa druge prirode, predviđenih Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javne funkcije.</p> <p>5. Predsedavajući Odbora izveštava Ministarstvo o delovanju i rezultatima Odbora.</p> <p>6. Članovi Odbora mogu napustiti Odbor odlukom Ministarstva iz jednog od sledećih razloga:</p> <p>6.1. ako je pravosnažnom presudom osuđen za neko krivično delo;</p> <p>6.2. zbog nemogućnosti ili nesposobnosti vršenja dužnosti duže</p>
--	---	--

<p>gjatë se gjashtë (6) muaj;</p> <p>6.3. kur anëtari i Bordit nuk informon Bordin për një konflikt të mundshëm të interesit me çfarë mund të rrezikohet kredibiliteti i Bordit;</p> <p>6.4. për shkak të shkeljeve të rënda disiplinore; dhe</p> <p>6.5. për shkak të performancës jo të mirë.</p> <p>7. Bordi mund të mbështetet nga këshilltarët profesional të kontraktuar për afat të caktuar sipas nevojës.</p> <p>8. Ministri nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve lidhur me funksionimin e Bordit.</p>	<p>(6) months;</p> <p>6.3. when the member of the Board does not inform the Board about a possible conflict of interest, which could jeopardize the credibility of the Board;</p> <p>6.4. due to serious disciplinary violations; and</p> <p>6.5. due to poor performance.</p> <p>7. The Board may be supported by professional advisors contracted for a fixed term as needed.</p> <p>8. The Minister shall issue a by-law on defining the procedures and criteria related to the operation of the Board.</p>	<p>od šest (6) meseci;</p> <p>6.3. kada član Odbora ne obavesti Upravu o mogućem sukobu interesa koji bi mogao ugroziti kredibilitet Odbora;</p> <p>6.4. zbog teških disciplinskih prekršaja; i</p> <p>6.5. zbog lošeg učinka.</p> <p>7. Odbor mogu po potrebi podržavati profesionalni savetnici ugovoreni na određeno vreme.</p> <p>8. Ministar donosi podzakonski akt kojim se utvrđuju procedure i kriterijumi za rad Odbora.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 62 Juridiksioni i Bordit</p> <p>1. Bordi ka juridiksion të shqyrtojë çdo vendim nga njësitë përkatëse të ankesave në lidhje me legjislacionin tatimor dhe doganor në fuqi në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Vendimet e Bordit lëshohen me shkrim dhe kanë karakter detyrues për palët. Vendimet e Bordit janë përfundimtare në procedurën administrative.</p>	<p style="text-align: center;">Article 62 Board Jurisdiction</p> <p>1. The Board has jurisdiction to review any decision by the relevant appeals units regarding tax and customs legislation in force in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The decisions of the Board are made in writing and are binding on the parties. The decisions of the Board are final in the administrative procedure.</p>	<p style="text-align: center;">Član 62 Nadležnost Odbora</p> <p>1. Odbor ima nadležnost da preispita svaku odluku relevantnih jedinica za žalbe u vezi sa poreskim i carinskim zakonodavstvom na snazi u Republici Kosovo.</p> <p>2. Odluke Odbora se donose u pisanoj formi i obavezujuće su za strane. Odluke Odbora su konačne u upravnom postupku.</p>

<p>3. Kundër vendimeve të Bordit, mund të ngritët padi në Gjykatën kompetente.</p> <p style="text-align: center;">Neni 63 Vendimi shpjegues publik</p> <p>1. Administrata Tatimore e Kosovës mund të nxjerrë vendim shpjegues publik për të sqaruar se si ATK interpreton dhe zbaton dispozitat e legjislacionit që administron, me qëllim që t'u sigurojë udhëzime personave që kërkohet të paguajnë tatimin ose t'u mbahet tatimi në burim.</p> <p>2. Vendimi shpjegues publik bëhet i qasshëm për publikun.</p> <p>3. Vendimi shpjegues publik i nxjerrë sipas këtij neni ka efekt detyrues për ATK lidhur me çdo detyrim tatimor që lind në periudhën tatimore gjatë së cilës vendimi ka qenë në fuqi.</p> <p>4. Vendimi shpjegues publik nuk është detyrues për personin i cili është i detyruar të paguajë tatime në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovë.</p>	<p>3. Against the decisions of the Board, a claim can be filed with the competent Court.</p> <p style="text-align: center;">Article 63 Public Rulings</p> <p>1. The Tax Administration of Kosovo may issue public rulings to explain how TAK shall interpret and apply the provisions of the legislation that it administers in order to provide guidance to persons required to pay tax or to withhold tax.</p> <p>2. The public ruling is made accessible to the public.</p> <p>3. The public ruling issued according to this article has a binding effect on the TAK regarding any tax liability that arises in the tax period during which the ruling was in force.</p> <p>4. A public ruling is not binding on a person liable to pay tax under the legislation in force in the Republic of Kosovo.</p>	<p>3. Protiv odluka Odbora može da se podnese tužba nadležnom sudu.</p> <p style="text-align: center;">Član 63 Javna obrazložena odluka</p> <p>1. Poreska administracija Kosova može izdati javnu odluku sa obrazloženjem kako bi razjasnila kako PAK tumači i primenjuje odredbe zakona kojim upravlja, kako bi dala uputstva licima od kojih se traži da plate porez ili porez po odbitku.</p> <p>2. Javna obrazložena odluka postaje dostupna javnosti.</p> <p>3. Javno obrazloženje doneto u skladu sa ovim članom ima obavezujući efekat za PAK u vezi sa bilo kojom poreskom obavezom koja nastane u poreskom periodu tokom kojeg je odluka bila na snazi.</p> <p>4. Javna obrazložena odluka nije obavezujuća za lice koje je dužno da plaća porez na osnovu zakona na snazi u Republici Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 64 Vendimi shpjegues individual</p> <p>1. Administrata Tatimore e Kosovës mund t'i lëshojë një vendim shpjegues individual</p>	<p style="text-align: center;">Article 64 Individual ruling</p> <p>1. The Tax Administration of Kosovo may issue a ruling to a particular person</p>	<p style="text-align: center;">Član 64 Pojedinačna obrazložena odluka</p> <p>1. Poreska administracija Kosova može doneti pojedinačnu odluku sa</p>

<p>një personi të caktuar duke i sqaruar se si ATK interpreton dhe zbaton dispozitat e legjislacionit tatimor që e administron, ashtu siç zbatohet për një transaksion të caktuar apo marrëveshje të planifikuar nga personi i cili kërkon vendimin shpjegues.</p> <p>2. Në qoftë se tatimpaguesi ka bërë një deklaram të tërësishëm dhe të vërtetë të natyrës të të gjitha aspekteve të transaksionit që është relevant për vendimin shpjegues, dhe transaksioni kryhet në të gjitha pikëpamjet materiale, ashtu siç është përshkruar në kërkesën e tatimpaguesit për vendim shpjegues, vendimi shpjegues individual është detyrues për ATK dhe tatimpaguesin në lidhje me zbatimin e ligjit, siç parashikohet në kohën e nxjerrjes së vendimit shpjegues individual.</p> <p>3. Ministri nxjerrë akt nënligjor me të cilin përcakton procedurat për të kërkuar një vendim shpjegues individual, përfshirë dokumentet që kërkohen, informatat që duhet përmbajtur kërkesa, afatet kohore për të kërkuar dhe lëshuar vendimin shpjegues individual, si dhe pagesat që kërkohen për t'u pajisur me vendim shpjegues individual.</p>	<p>explaining how TAK shall interpret and apply the provisions of the tax legislation that it administers as it applies to a particular transaction or arrangement planned by the person seeking the ruling.</p> <p>2. If the taxpayer has made a full and true disclosure of the nature of all aspects of the transaction relevant to the ruling, and the transaction proceeds in all material respects as described in the taxpayer's application for the ruling, the ruling shall be binding on TAK and the taxpayer with respect to the application of the law as it stood at the time of the ruling.</p> <p>3. The Minister shall issue a by-law to prescribe the requirements for requesting an individual ruling; including the documents required, the information to be included in the request, timeframes for requesting and issuing individual rulings, and the fees to be required to be issued an individual ruling.</p>	<p>obrazloženjem određenom licu objašnjavajući kako PAK tumači i primenjuje odredbe poreskog zakonodavstva koje administruje, kako se ono primenjuje na određenu transakciju ili sporazum planiran od strane lica kome je potrebna obrazložena odluka.</p> <p>2. Ako je poreski obveznik dao potpunu i istinitu izjavu o prirodi svih aspekata transakcije koja je relevantna za obrazloženje odluke, a transakcija je izvršena u svim materijalnim aspektima, kako je opisano u zahtevu poreskog obveznika za donošenje obrazložene odluke, pojedinačna obrazložena odluka je obavezujuća za PAK i poreskog obveznika u vezi sa sprovođenjem zakona, kako je predviđeno u trenutku donošenja pojedinačne obrazložene odluke.</p> <p>3. Ministar donosi podzakonski akt kojim se uređuju postupci za traženje pojedinačnog obrazloženja, uključujući potrebnu dokumentaciju, podatke koje zahtev mora sadržavati, rokove za traženje i izdavanje pojedinačnog obrazloženja, kao i uplate koje se zahtevaju radi dobijanja pojedinačne obrazložene odluke.</p>
---	--	---

<p align="center">Neni 65 Përfaqësuesit e Tatimpaguesit</p>	<p align="center">Article 65 Taxpayer Representatives</p>	<p align="center">Član 65 Predstavnici poreskih obveznika</p>
<p>1. Tatimpaguesi mund të marrë pjesë në një procedurë tatimore, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar.</p> <p>2. Në rastin e personave juridikë, përfaqësuesit e tatimpaguesit mund të përfshijnë pronarin e një veprimtarie të biznesit, kryetarin, drejtorin e përgjithshëm të kompanisë, menaxherin, ose administratorin e një personi juridik, përfaqësuesin e falimentimit të një organizate në likuidim, kujdestarin e mallrave për një biznes në gjendje insolvente, administratorin ose trashëgimtarët e një pasurie dhe çdo person tjetër me autorizim me shkrim për të përfaqësuar tatimpaguesin.</p> <p>3. Në rastin e personave fizikë, përfaqësuesi i tatimpaguesit mund të jetë një avokat, kontabilist, ose agjent tjetër me autorizim me shkrim për të përfaqësuar tatimpaguesin.</p> <p>4. Kompetencat dhe detyrat e një përfaqësuesi të tatimpaguesit janë të kufizuara brenda marrëveshjes me shkrim.</p> <p>5. Pjesëmarrja e një përfaqësuesi të tatimpaguesit në çdo procedurë tatimore nuk e privon tatimpaguesin nga të drejtat e tij personale për të marrë pjesë në këtë procedurë dhe nuk i heq të drejtën ATK</p>	<p>1. The taxpayer may participate in tax proceedings through their authorized representative.</p> <p>2. For legal persons, taxpayer representatives may include the proprietor of a business activity, the president, director general of the company, manager, or administrator of a legal person, the bankruptcy representative of an organization in liquidation, the guardian of goods for an insolvent business, the administrator or heirs of an estate and any other person with written authorization to represent the taxpayer.</p> <p>3. For natural persons, taxpayer representatives may be an attorney, accountant or other agent with written authorization to represent the taxpayer.</p> <p>4. The powers and duties of a taxpayer representative shall be limited to the terms of the written agreement.</p> <p>5. The participation of a taxpayer representative in any tax proceeding shall not deprive the taxpayer of their personal right to participate in such proceedings and shall not deprive the TAK of access to the</p>	<p>1. Poreski obveznik može učestvovati u poreskom postupku preko svog ovlašćenog predstavnika.</p> <p>2. U slučaju pravnih lica, predstavnici poreskog obveznika mogu biti vlasnik poslovne delatnosti, predsednik, generalni direktor kompanije, direktor ili upravnik pravnog lica, stečajni zastupnik organizacije u likvidaciji, čuvar dobara za nesolventni biznis, upravnik ili naslednici imovine i svako drugo lice pismeno ovlašćeno da zastupa poreskog obveznika.</p> <p>3. U slučaju fizičkih lica, predstavnik poreskog obveznika može biti advokat, računovođa ili neki drugi agent sa pismenim ovlašćenjem za zastupanje poreskog obveznika.</p> <p>4. Ovlašćenja i dužnosti predstavnika poreskog obveznika su ograničene pismenim sporazumom.</p> <p>5. Učešće predstavnika poreskog obveznika u bilo kom poreskom postupku ne lišava poreskog obveznika njegovih ličnih prava da učestvuje u ovom postupku i ne ukida pravo PAK-a</p>

<p>për të pasur qasje tek tatimpaguesi.</p> <p>6. Një person i cili është tatimpagues jo-rezident, sipas legjislacionit tatimor në fuqi informon ATK për përfaqësuesin e tij brenda tre (3) javësh pasi të ketë filluar të sigurojë të ardhura ose të ketë blerë pasuri në Republikën e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 66 Konfidencialiteti i informatave tatimore</p> <p>1. Çdo zyrtari ose personi tjetër, i cili në ushtrimin e detyrave të tij zyrtare ka qasje tek informatat e tatimpaguesit, i ndalohet t’ia zbulojë informata e tilla ndonjë personi tjetër, përveç rastit kur kjo gjë është e nevojshme në procedurat tatimore, në procedurat penale të krimeve në fushën e tatimeve, ose nëse është përcaktuar ndryshe në këtë nen.</p> <p>2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, një zyrtar tatimor mund t’u zbulojë informata për tatimpaguesin personave vijues:</p> <p>2.1. Ministrisë së Financave, aty ku ato informata janë të nevojshme për qëllime zyrtare të Ministrisë. Informatat e tilla të tatimpaguesit i nënshtrohen kërkesave dhe sanksioneve të njëjta të konfidencialitetit sikurse janë vendosur</p>	<p>taxpayer.</p> <p>6. A person who is a non-resident taxpayer under the tax legislation in force, must inform the TAK of its taxpayer representative within three (3) weeks after it begins generating income or acquiring property in the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 66 Confidentiality of Tax Information</p> <p>1. Any tax official or any other person who, in the execution of his or her official duties, has access to taxpayer information, is prohibited from disclosing such information to any other person except as needed in tax proceedings, in criminal proceedings related to criminal tax offenses, or otherwise provided in this Article.</p> <p>2. Notwithstanding paragraph 1 of this Article, a tax official may disclose information concerning a taxpayer to the following persons:</p> <p>2.1. the Ministry of Finance, where that information is needed for the official work of the Ministry. Such taxpayer information shall be subject to the same confidentiality requirements and sanctions as established by this Article.</p>	<p>da ima pristup poreskom obvezniku.</p> <p>6. Lice koje je nerezidentni poreski obveznik, u skladu sa poreskim zakonodavstvom na snazi, obaveštava PAK o svom zastupniku u roku od tri (3) nedelje nakon što je počeo da obezbeđuje prihod ili je kupio imovinu u Republici Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Član 66 Poverljivost poreznih informacija</p> <p>1. Svakom službenom ili drugom licu, koje u vršenju službene dužnosti ima pristup podacima poreskog obveznika, zabranjeno je da te podatke otkrije bilo kom drugom licu, osim kada je to neophodno u poreskim postupcima, u krivičnom postupku za krivična dela u oblasti poreza, ili ako je drugačije određeno ovim članom.</p> <p>2. Bez obzira na stav 1. ovog člana, poreski službenik može otkriti podatke o poreskom obvezniku sledećim licima:</p> <p>2.1. Ministarstvu finansija, gde su ti podaci neophodni za službene svrhe Ministarstva. Takve informacije o poreskim obveznicima podležu istim zahtevima poverljivosti i sankcijama kao što je utvrđeno u ovom članu;</p>
--	---	--

<p>në këtë nen;</p> <p>2.2. Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për një qëllim të autorizuar nga legjislacioni dhe rregulloret në fuqi lidhur me pensionet në Republikën e Kosovës apo fondeve të tjera ashtu siç është përcaktuar me ligje të veçanta;</p> <p>2.3. Institucionit të Avokatit të Popullit, për përdorim në zgjidhjen e ankesave të tatimpaguesit;</p> <p>2.4. Gjykatave për qëllime zyrtare;</p> <p>2.5. Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, për mirëmbajtjen e regjistrit të bizneseve. ATK mund t'ia zbulojë informatat për identifikimin individual Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës për qëllime të çregjistrimit ose për qëllime të informimit të Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës lidhur me informatat e tatimpaguesit të cilat nuk kanë mundur të vërtetohen përmes vizitës personale. Zbulimi për Regjistrin e Bizneseve të Kosovës po ashtu është i autorizuar sipas nevojës për të verifikuar të dhënat e regjistrimit të bizneseve të regjistruara me Regjistrin e Bizneseve të Kosovës.</p> <p>2.6. Auditorit të Përgjithshëm - Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, për qëllim të auditimit të ATK në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi</p>	<p>2.2. the Kosovo Pension Savings Fund, for a purpose authorized by the legislation and regulations in force related to pensions in the Republic of Kosovo or other funds as determined by special laws;</p> <p>2.3. the Institution of the Ombudsperson, for use in resolving taxpayer appeals;</p> <p>2.4. Courts for official purposes;</p> <p>2.5. the Kosovo Business Registration Agency for maintenance of the business registry. The TAK may disclose individual identification information to the Kosovo Business Registry for the purposes of de-registration or for the purposes of advising the Kosovo Business Registry of taxpayer information that could not be verified through personal visitation. Disclosure to Kosovo Business Registry is also authorized as necessary to verify the registration details of businesses registered with Kosovo Business Registry.</p> <p>2.6. the Auditor General - Kosovo's National Audit Office for the purpose of auditing the TAK pursuant to legislation and regulations in force regarding the</p>	<p>2.2. Kosovskom fondu za penzijsku štednju, za svrhe ovlašćene zakonima i propisima na snazi u vezi sa penzijama u Republici Kosovo ili drugim fondovima utvrđenim posebnim zakonima;</p> <p>2.3. Instituciji narodnog advokata, za korišćenje u rešavanju pritužbi poreskih obveznika;</p> <p>2.4. Sudovima za službene potrebe;</p> <p>2.5. Kosovskoj agenciji za registraciju biznisa, za vođenje registra biznisa. PAK može otkriti pojedinačne identifikacione informacije Kosovskom registru biznisa u svrhu deregistracije ili u svrhu informisanja Kosovskog registra biznisa u vezi sa informacijama o poreskim obveznicima koje se ne mogu proveriti ličnom posetom. Otkrivanje za Kosovski registar biznisa je takođe ovlašćeno po potrebi za verifikaciju podataka o registraciji preduzeća registrovanih u Kosovskom registru biznisa.</p> <p>2.6. Generalnom revizoru - Nacionalnoj kancelariji za reviziju Kosova, u cilju revizije PAK-a u skladu sa zakonima i propisima na</p>
---	---	--

<p>lidhur me auditimin e përgjithshëm në Republikën e Kosovës;</p> <p>2.7. Zyrtarëve të institucioneve shtetore ose të punësuarve të ATK gjatë dhe për qëllim të kryerjes së detyrave të tyre zyrtare;</p> <p>2.8. Autoriteteve tatimore dhe doganore të një vendi të huaj në përputhje me traktatet ose marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;</p> <p>2.9. Doganës së Kosovës, për qëllime të administrimit të legjislacionit doganor;</p> <p>2.10. Çdo personi, kur tatimpaguesi është dënuar për mashtrim ose kur informatat përmbajnë një listë të personave të regjistruar për TVSh, me qëllim që personat të verifikojnë nëse janë duke bërë biznes me një person të regjistruar për TVSh; apo çdo personi, kur informatat përmbajnë një listë të personave, përfshirë numrat e tyre fiskal apo numrat unik të identifikimit, me qëllim të kryerjes së veprimtarisë ekonomike.</p> <p>2.11. Zyrës së Prokurorisë së Shtetit apo agjencive kompetente për zbatimin e ligjit:</p> <p>2.11.1. për ndjekjen penale apo hetimin e rasteve të dyshuara për</p>	<p>general audit in the Republic of Kosovo;</p> <p>2.7. other TAK officials or employees in the course of and for the purpose of carrying out their official duties;</p> <p>2.8. the tax authorities of a foreign country in accordance with ratified international treaties or agreements;</p> <p>2.9. Kosovo Customs, for purposes of administering the customs legislation;</p> <p>2.10. any person, when the taxpayer has been convicted of fraud, or where the information consists of a list of registered persons for VAT in order that persons can check they are doing business with a VAT registered person; or any person, where the information consists of a list of persons, including their fiscal number or unique ID number, in order to conduct an economic activity.</p> <p>2.11. State Prosecutor's Office or competent law enforcement agencies:</p> <p>2.11.1. for criminal prosecution or investigation of cases suspected of</p>	<p>snazi u vezi sa opštom revizijom u Republici Kosovo;</p> <p>2.7. Drugim službenicima ili zaposlenima PAK-a tokom i u svrhu obavljanja službenih dužnosti;</p> <p>2.8. Poreskim i carinskim organima strane države u skladu sa ratifikovanim međunarodnim ugovorima ili sporazumima;</p> <p>2.9. Carini Kosova, za potrebe administracije carinskog zakonodavstva;</p> <p>2.10. Bilo kom licu, kada je poreski obveznik osuđen za prevaru ili kada informacija sadrži spisak lica registrovanih za PDV, kako bi lica proverila da li posluju sa licem registrovanim za PDV; ili bilo kom licu, kada informacija sadrži spisak lica, uključujući njihove fiskalne brojeve ili jedinstvene identifikacione brojeve, za obavljanje ekonomske delatnosti.</p> <p>2.11. Državno tužilaštvo ili nadležne agencije za sprovođenje zakona:</p> <p>2.11.1. za krivično gonjenje ili istragu slučajeva osumnjičenih za</p>
--	--	--

<p>të pashlyer, paguan detyrimin tatimor së bashku me interesin me një pagesë të njëhershme, gjobat e aplikuara sipas këtij Ligji, përveç gjobave sipas nenit 103, do të zbriten në tredhjetë përqind (30%).</p> <p>4. Aty ku tatimpaguesi me detyrim tatimor të pashlyer, hyn në marrëveshje me shkrim për të paguar tatimin e pashlyer me dy ose më tepër këste, i përmbush kushtet e marrëveshjes me shkrim, dhe i kryen në kohë të gjitha detyrimet e tjera tatimore gjatë kohës së asaj marrëveshjeje, gjobat e aplikuara sipas këtij Ligji, përveç gjobave sipas nenit 103, do të zbriten në pesëdhjetë përqind (50%).</p> <p>5. Administrata Tatimore e Kosovës ka të drejtë të zvogëlojë ose heq çdo gjobë të vlerësuar, apo propozuar, në baza sipas rastit, në rastet kur personi obligues për ndonjë tatim dëshmon shkaqe të arsyeshme, besim të mirë, vështirësi të madhe ose arsye të tjera të cilat do të ngritin efektivitetin e ATK.</p> <p>6. Administrata Tatimore e Kosovës shqyrton kërkesat për zbritjen e gjobave dhe merr vendim bazuar në rishqyrtimin e fakteve dhe rrethanave.</p> <p>7. Çdo ndëshkim i aplikuar sipas këtij Ligji, përveç gjobave sipas nenit 103, nëse paguhet brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e njoftimit për</p>	<p>liability pays the tax liability with a one-time payment, the penalties applied under this Law, except the penalties under Article 103, shall be deducted to thirty percent (30%).</p> <p>4. Where the taxpayer with an outstanding tax liability enters into a written agreement to pay the outstanding tax in one lump sum or in two or more installments, fulfills the terms of the written agreement, and fulfills all other liabilities on time tax during the time of that agreement, the fines applied under this Law, except the fines under Article 103, will be reduced by fifty percent (50%).</p> <p>5. The Tax Administration of Kosovo has the right to reduce or remove any fine assessed, or proposed, on a case-by-case basis, in cases where the person liable for any tax proves reasonable causes, good faith, great hardship or other reasons which will increase the effectiveness of the TAK.</p> <p>6. The Tax Administration of Kosovo shall examine the requests for deduction of fines and take a decision based on the review of the facts and circumstances.</p> <p>7. Any penalty applied according to this Law, except fines according to Article 103, if paid within fifteen (15) calendar days from the date of notification of application</p>	<p>poreskom odgovornošću plaća poresku obveznicu jednom uplatom, kazne koje se primenjuju na osnovu ovog zakona, osim kazni iz člana 103.</p> <p>4. Kada poreski obveznik sa neizmirenom poreskom obavezom sklopi pismeni sporazum o plaćanju neizmirenog poreza u jednokratnoj uplati ili u dve ili više rata, ispunjava uslove pismenog sporazuma i ispunjava sve ostale poreske obaveze na vreme tokom trajanja tog sporazuma, kazne koje se primenjuju prema ovom zakonu, osim kazni iz člana 103, biće smanjene na pedeset posto (50%).</p> <p>5. Poreska administracija Kosova ima pravo da smanji ili ukloni svaku procenjenu ili predloženu kaznu, od slučaja do slučaja, u slučajevima kada lice odgovorno za bilo koji porez dokaže razumne razloge, dobru veru, velike poteškoće ili druge razloge koje bi povećale efektivnost PAK-a.</p> <p>6. Poreska administracija Kosova razmatra zahteve za smanjenje novčanih kazni i donosi odluku na osnovu preispitivanja činjenica i okolnosti.</p> <p>7. Svaka kazna primenjena u skladu sa ovim zakonom, osim novčane kazne prema članu 103, ako je plaćena u roku od petnaest (15) kalendarskih dana od</p>
---	---	---

<p>aplikim të gjobës, paguhet vetëm pesëdhjetë përqind (50%) e vlerës së gjobës të aplikuar.</p> <p>8. Në rastet kur tatimpaguesi raporon keqpërdorimin dhe ofron prova të mjaftueshme se një zyrtar tatimor ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare, Drejtori i ATK mund të nxjerrë vendim që tatimpaguesit t'i lejohet korrigjimi i deklaratës tatimore mbrenda afatit tre (3) muaj pa qenë subjekt i ndëshkimeve të përcaktuara me këtë Ligj.</p> <p>9. Për zbatim të këtij neni, Ministri nxjerrë akt nënligjor.</p>	<p>of the fine, will only charge for payment fifty percent (50%) of the value of the applied fine.</p> <p>8. In cases where the taxpayer reports the misuse and provides sufficient evidence that a tax official has misused his official duty, the Director of TAK may issue a decision that the taxpayer is allowed to correct the tax return within three (3) months without being subject to punishments determined by this Law.</p> <p>9. For the implementation of this article the Minister shall issue a by-law.</p>	<p>dana obaveštenja o primeni kazne, plaća se samo pedeset posto (50%) vrednosti primenjene kazne.</p> <p>8. U slučajevima kada poreski obveznik prijavi zloupotrebu i pruži dovoljno dokaza da je poreski službenik zloupotrebio svoju službenu dužnost, direktor PAK-a može doneti odluku da se poreskom obvezniku dozvoljava da ispravi poresku prijavu u roku od tri (3) meseca, a da ne podleže kazne utvrđene ovim zakonom.</p> <p>9. Za sprovođenje ovog člana ministar donosi podzakonski akt.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI X PROCEDURAT ANKIMORE</p> <p style="text-align: center;">Neni 111 Ankesat në Administratën Tatimore të Kosovës</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER X APPEAL PROCEDURE</p> <p style="text-align: center;">Article 111 Appeals to the Tax Administration of Kosovo</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE X ŽALBENI POSTUPCI</p> <p style="text-align: center;">Član 111 Žalbe Poreskoj administraciji Kosova</p>
<p>1. Një person i cili kundërshton vlerësimin e tatimeve ose përcaktimin zyrtar të ATK, mund të paraqesë kërkesë për rishqyrtim në Njësinë e Ankesave për të ri-shqyrtuar përcaktimin zyrtar. Kërkesa duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur tatimpaguesi ka pranuar njoftimin e vlerësimit ose përcaktimin tjetër zyrtar. Kërkesa duhet të jetë me shkrim dhe duhet të përmbajë arsyet dhe dokumentet mbi të cilat tatimpaguesi e bazon kërkesën.</p>	<p>1. A person who disputes a tax assessment or official determination of the TAK may file a claim for review with the Appeals Unit for reconsideration of the official determination. The appeal shall be filed within thirty (30) days of the date that the taxpayer received the notice of the assessment or other official determination. The appeal shall be in writing and must indicate the reasons and documents on which the taxpayer bases the appeal.</p>	<p>1. Lice koje osporava poresku procenu ili službenu odluku PAK-a može podneti zahtev za ponovno razmatranje Jedinici za žalbe radi preispitivanja službene odluke. Zahtev se mora podneti u roku od trideset (30) dana od dana kada je poreski obveznik primio obaveštenje o proceni ili drugu službenu odluku. Zahtev mora da bude u pisanoj formi i mora da sadrži razloge i dokumente na kojima poreski obveznik zasniva zahtev.</p>

<p>2. Periudha kohore për kërkesë për rishqyrtim, kundër ndonjë vendimi zyrtar të ATK e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni mund të zgjatet nëse gjatë kësaj periudhe kanë ekzistuar rrethanat e arsyeshme të cilat e kanë penguar personin në respektimin e afatit ligjor e të cilat rrethana janë jashtë kontrollit të tatimpaguesit ose janë të atilla që nëse nuk lejohet rivendosje e afatit do të rezultojnë me padrejtësi ndaj personit. Zgjatja e afatit bëhet në pajtim me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative.</p>	<p>2. The deadline for appealing against any official decision issued by TAK specified in paragraph 1 of this Article can be extended if the taxpayer demonstrates reasonable circumstances that might have prevented him or her from respecting the legal deadline and such circumstances are out of taxpayers control or are such that if a deadline is not extended it might result in unfairness toward the person. The extension of the deadline shall be compatible with Law on the General Administrative Procedure.</p>	<p>2. Rok za podnošenje zahteva za preispitivanje, protiv bilo koje službene odluke PAK-a definisane u stavu 1. ovog člana, može se produžiti ako su tokom tog perioda postojale razumne okolnosti koje su sprečile lice da ispoštuje zakonski rok i koje su van kontrole poreskog obveznika ili su takve da, ako se ne dozvoli ponovno postavljanje roka, rezultiraće nepravdom prema licu. Produženje roka vrši se u skladu sa Zakonom o opštoj administrativnoj proceduri.</p>
<p>3. Njësia e Ankesave shqyrton kërkesën e tatimpaguesit dhe lëshon një vendim për këtë. Vendimi i dorëzohet me shkrim personit i cili ka paraqitur ankesën sa më shpejt që të jetë e realizueshme, por jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas datës së kërkesës.</p>	<p>3. The Appeals Unit shall examine the taxpayer's appeal and issue a decision on it. The decision shall be delivered in writing to the person making the appeal as soon as practicable, but not later than sixty (45) days after the date of appeal.</p>	<p>3. Jedinica za žalbe razmatra zahtev poreskog obveznika i o tome donosi odluku. Odluka se pismeno dostavlja licu koje je podnelo žalbu u najkraćem mogućem roku, a najkasnije četrdeset pet (45) dana od dana podnošenja zahteva.</p>
<p>4. Vendimi i Ankesave, është vendimi i fundit i ATK në procedurën administrative dhe është detyrues për ATK.</p>	<p>4. The Appeals decision is the last decision of the TAK in the administrative proceedings and is binding for the TAK.</p>	<p>4. Odluka o žalbi je poslednja odluka PAK-a u administrativnoj proceduri i obavezujuća je za PAK.</p>
<p>5. Tatimpaguesi i cili nuk pajtohet me një vendim të Ankesave, brenda tridhjetë (30) ditëve pasi është marrë njoftimi i vendimit të Ankesave, mundet të paraqesë ankesë në Bord.</p>	<p>5. The taxpayer who does not agree with a decision of the Appeals Unit, within thirty (30) days after receiving the notice of the decision of the Appeals Unit, may submit an appeal to the Board.</p>	<p>5. Poreski obveznik koji se ne slaže sa odlukom žalbe, u roku od trideset (30) dana nakon prijema obaveštenja o odluci žalbe, može podneti žalbu Odboru.</p>
<p>6. Nëse Njësia e Ankesave nuk është në gjendje të merr vendim mbi rastin, bazuar në informatat e dhëna qoftë nga tatimpaguesi apo nga ATK, mund të</p>	<p>6. If the Appeals Unit is unable to make a decision on the case based on the information provided by either the taxpayer or the TAK, it may request additional</p>	<p>6. Ako Jedinica za žalbe nije u mogućnosti da donese odluku o slučaju, na osnovu informacija koje je dao poreski obveznik ili PAK, može da traži</p>

<p>kërkojnë sqarime shtesë nga tatimpaguesi apo nga ATK ose nga të dyja. Në këto raste, afati i paraparë në paragrafin 3 të këtij neni mund të shtyhet deri në dyzetepesë (45) ditë të tjera.</p> <p>7. E drejta e tatimpaguesit për të parashtruar kërkesë për rishqyrtim vlen edhe për rastet e vlerësimeve tatimore të kryera nga ana e Njësisë së Hetimeve Tatimore dhe Intiligjencës dhe e njëjta shqyrtohet nga Ankesat brenda afatit ligjor, përveç rasteve kur ka ndonjë urdhër me shkrim nga Prokuroria e Shtetit apo gjykata kompetente që rasti të pezullohet deri në përmbylljen e procedurës penale, apo kur vlerësohet se duhet të zbatohen dispozitat përkatëse sipas Ligjit për Procedurat e Përgjithshme Administrative.</p> <p>8. Në rastin kur Ankesat nuk dorëzojnë vendimin brenda dyzetepesë (45) ditëve nga dita kur është dorëzuar ankesa, tatimpaguesi mundet të paraqesë ankesë për vlerësimin ose vendimin tjetër zyrtar drejtpërdrejt në Bord.</p> <p style="text-align: center;">Neni 112 Ankesat në Bord</p> <p>1. Pala e pakënaqur me vendimin e Njësisë së Ankesave në ATK apo të Njësisë së Ankesave në DK, mund të parashtrroj ankesë në Bord.</p>	<p>clarification from either the taxpayer or the TAK or both. In these cases, the deadline provided for in paragraph 3 of this article may be extended up to another forty-five (45) days.</p> <p>7. The taxpayer's right to submit an appeal for review also applies to cases of tax assessments carried out by the Tax Investigations and Intelligence Unit, and the same is reviewed by the Appeals Unit within the legal term, unless there is a written order from the State Prosecutor's Office or the competent court for the case to be suspended until the conclusion of the criminal proceedings, or when it is estimated that the relevant provisions according to the Law on General Administrative Procedures should be applied.</p> <p>8. Where the Appeals Division has not delivered a decision within sixty (45) days of the day on which an appeal was filed, the taxpayer may appeal the assessment or other official determination directly to the Board.</p> <p style="text-align: center;">Article 112 Appeals to the Board</p> <p>1. The party dissatisfied with the decision of the Appeals Unit within the TAK or the Appeals Unit within the KC, may submit an appeal to the Board.</p>	<p>dodatna pojašnjenja od poreskog obveznika ili PAK-a ili od oboje. U tim slučajevima, rok iz stava 3. ovog člana može da se produži za još četrdeset pet (45) dana.</p> <p>7. Pravo poreskog obveznika da podnese zahtev za preispitivanje odnosi se i na slučajeve poreskih procena koje vrši Jedinica za poreske i obaveštajne istrage i isti se razmatra od strane Žalbe u zakonskom roku, osim ako postoji pismeni nalog Državnog tužilaštva ili nadležnog suda da se predmet obustavi do okončanja krivičnog postupka, odnosno kada se proceni da treba primeniti odgovarajuće odredbe Zakona o opštoj administrativnoj proceduri.</p> <p>8. U slučaju da žalbe ne podnesu odluku u roku od četrdeset pet (45) dana od dana podnošenja žalbe, poreski obveznik može direktno Odboru da podnese žalbu na procenu ili neku drugu zvaničnu odluku.</p> <p style="text-align: center;">Član 112 Žalbe Odboru</p> <p>1. Stranka koja je nezadovoljna odlukom Jedinice za žalbe u PAK-u ili Jedinice za žalbe u CK može da podnese žalbu Odboru.</p>
--	---	---

2. Para Bordit, palë në procedurë ankimore janë ATK apo DK, e cila e ka lëshuar vendimin e ankimuar, si dhe tatimpaguesi që ka parashtruar ankesën.

3. Ankuesi mund të marrë pjesë në Bord pa qenë i përfaqësuar ose ndihmuar nga një avokat ose këshilltar profesional tatimor.

4. Administrata Tatimore e Kosovës apo DK përfaqësohet para Bordit nga zyrtari ligjor, zyrtari që ka kryer vlerësimin e lëndës, zyrtari që ka kryer vlerësimin e ankesës, apo një zyrtar tjetër i autorizuar.

Neni 113
Përmbajtja e ankesës në Bord

1. Një tatimpagues i cili ka marrë një vendim ose nuk ka pranuar vendimin e kërkuar brenda kohës së paraparë me ligj, nga Njësia për ankesa nga ATK ose DK, mund të ushtroj ankesë në Bord.

2. Pala e pakënaqur me vendimin nga Njësia e Ankesave në ATK ose DK, dorëzon ankesën me shkrim tek Bordi. Një kopje e ankesës, në afat prej pesë (5) ditëve, dorëzohet nga Bordi tek pala kundër të cilës është iniciuar rishqyrtimi i vendimit.

2. Before the Board, parties in the appeal procedure are the TAK or KC, which issued the appealed decision, as well as the taxpayer who submitted the appeal.

3. The claimant may attend the Board without being represented or assisted by an attorney or professional tax advisor.

4. The Tax Administration of Kosovo or KC are represented before the Board by their legal officer, the officer who conducted the assessment of the case, the officer who conducted the assessment of the appeal, or another authorized official.

Article 113
Content of the appeal to the Board

1. A taxpayer for whom a decision was made or has not received the required decision within the time provided by law, from the Appeal Unit within the TAK or KC, may file an appeal with the Board.

2. The party dissatisfied with the decision by the Appeals Unit within the TAK or KC, submits the written appeal to the Board. A copy of the appeal, within five (5) days, is delivered by the Board to the party against whom the review of the decision was initiated.

2. Pred Odborom stranke u žalbenom postupku su PAK ili CK, koji donosi rešenje o žalbi, kao i poreski obveznik koji podnosi žalbu.

3. Podnosilac žalbe može da učestvuje u Odboru bez da ga zastupa ili da mu pomaže advokat ili profesionalni poreski savetnik.

4. Poresku administraciju Kosova ili CK pred Odborom zastupa pravni službenik, službenik koji je izvršio procenu predmeta, službenik koji je izvršio procenu žalbe ili neki drugi ovlašćeni službenik.

Član 113
Sadržaj žalbe Odboru

1. Poreski obveznik koji je doneo odluku ili nije prihvatio traženu odluku u roku predviđenom zakonom, iz Jedinice za žalbe PAK-a ili CK, može da podnese žalbu Odboru.

2. Stranka nezadovoljna odlukom Jedinice za žalbe u PAK ili CK podnosi pismenu žalbu Odboru. Kopiju žalbe, u roku od pet (5) dana, Odbor dostavlja stranci protiv koje je pokrenuto preispitivanje odluke.

<p>3. Një ankesë e adresuar tek Bordi përmban njërën nga kërkesat në vijim:</p> <p>3.1. anulimin e plotë ose të pjesshëm, të vendimit të kundërshtuar;</p> <p>3.2. kthimin e tatimit të paguar padrejtësisht, i cili nuk është nxjerrë sipas kushteve të parapara;</p> <p>3.3. marrjen e vendimit, i cili nuk është marrë nga ATK brenda afateve të përcaktuara;</p> <p>3.4. marrjen e vendimit për të zvogëluar borxhin doganor, i cili nuk është marr sipas kushteve të parapara; apo</p> <p>3.5. kthimin e gjërave të konfiskuara dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar për shkak të ekzekutimit të vendimit kontestues.</p>	<p>3. An appeal addressed to the Board shall contain one of the following requests:</p> <p>3.1. full or partial annulment of the contested decision;</p> <p>3.2. the return of tax paid unjustly, which was not issued according to the conditions foreseen;</p> <p>3.3. taking the decision, which was not taken by the TAK within the set deadlines;</p> <p>3.4. taking the decision to reduce the customs debt, which was not taken according to the conditions foreseen; or</p> <p>3.5. return of confiscated items and compensation for damage caused due to the execution of the contested decision.</p>	<p>3. Žalba upućena Odboru sadrži jedan od sledećih zahteva:</p> <p>3.1. potpuno ili delimično poništenje osporene odluke;</p> <p>3.2. povraćaj nepravedno plaćenog poreza, koji nije izdat prema predviđenim uslovima;</p> <p>3.3. donošenje odluke koju PAK nije donela u predviđenim rokovima;</p> <p>3.4. donošenje odluke o smanjenju carinskog duga, koja nije doneta prema predviđenim uslovima; ili</p> <p>3.5. vraćanje konfiskovanih predmeta i naknada štete prouzrokovane izvršenjem osporene odluke.</p>
<p>4. Ankesa duhet të përmbajë:</p> <p>4.1. emrin e administratës kompetente e cila ka marrë vendimin e kundërshtuar ose që nuk ka marr vendimin e kërkuar brenda kohës së përcaktuar me ligjin përkatës;</p> <p>4.2. numrin e referencës dhe datën e vendimit të kundërshtuar;</p> <p>4.3. detajet personale të ankuesit;</p>	<p>4. The appeal must contain:</p> <p>4.1. the name of the competent administration which took the disputed decision or which did not take the requested decision within the time specified by the relevant law;</p> <p>4.2. reference number and date of contested decision;</p> <p>4.3. personal details of the claimant;</p>	<p>4. Žalba mora da sadrži:</p> <p>4.1. naziv nadležne administracije koja je donela osporenu odluku ili koja nije donela traženu odluku u roku određenom relevantnim zakonom;</p> <p>4.2. poziv na broj i datum osporene odluke;</p> <p>4.3. lične podatke podnosioca žalbe;</p>

<p>4.4. arsyetimin ligjor dhe faktik për ankesa;</p> <p>4.5. faktet në mbështetje të kërkesës;</p> <p>4.6. çdo dokument tjetër që mendohet të jetë relevant në masa; dhe</p> <p>4.7. nënshkrimin e ankuesit apo të autorizuarit të tij.</p>	<p>4.4. legal and factual reasoning for the appeal;</p> <p>4.5. the facts in support of the appeal;</p> <p>4.6. any other document that is considered to be relevant to the measure; and</p> <p>4.7. the signature of the claimant or their authorized representative.</p>	<p>4.4. pravno i činjenično obrazloženje žalbi;</p> <p>4.5. činjenice koje potkrepljuju zahtev;</p> <p>4.6. svaki drugi dokument koji se smatra relevantnim za mere; i</p> <p>4.7. potpis podnosioca žalbe ili njegovog ovlašćenog predstavnika.</p>
<p>5. Bordi vendosë mbi arsyeshmërinë e kërkesave të pretenduara nga pala.</p>	<p>5. The Board shall decide on the reasonableness of the claims made by the party.</p>	<p>5. Odbor odlučuje o osnovanosti zahteva koje podnosi stranka.</p>
<p>6. Nëse personi që ankohet në Bord dëshmon se nuk ka mundur të dorëzoj dokumentacionin ose provat tjera brenda afatit të përcaktuar me ligj për shkak të arsyeve që ishin jashtë kontrollit të tij, ai lejohet të dorëzoj ato në gjykatë.</p>	<p>6. If the person who files an appeal with the Board proves that they were unable to submit the documentation or other evidence within the deadline set by law due to reasons that were beyond their control, they are allowed to submit them to the court.</p>	<p>6. Ako lice koje se žali Odboru dokaže da nije bilo u mogućnosti da dostavi dokumentaciju ili druge dokaze u zakonskom roku iz razloga koji su bili van njegove kontrole, dozvoljeno mu je da ih dostavi sudu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 114 Barra e provës</p>	<p style="text-align: center;">Article 114 Burden of proof</p>	<p style="text-align: center;">Član 114 Teret dokazivanja</p>
<p>1. Ankuesi ka barrën të provojë që vendimi, vlerësimi dhe përcaktimi kundër të cilit ka ngritur ankesë është i pasaktë.</p>	<p>1. The claimant shall have the burden of proving that a decision, assessment or determination against which they are appealing is incorrect.</p>	<p>1. Na podnosiocu žalbe je da dokaže da su odluka, procena i rešenje protiv kojeg je podneo žalbu neispravni.</p>
<p>2. Administrata Tatimore e Kosovës dhe DK bartin detyrimin e vërtetimit të fakteve, të cilat e mbështesin vendimin dhe</p>	<p>2. The Tax Administration of Kosovo and KC bear the obligation to prove the facts, which support the decision and oppose the</p>	<p>2. Poreska administracija Kosova i CK snose obavezu dokazivanja činjenica koje potkrepljuju odluku i protive se zahtevu</p>

<p>kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 115 Procedura e Bordit</p> <p>1. Bordi mbanë seanca ku dëgjohen palët dhe shqyrtohen provat, si dhe seanca të mbyllura.</p> <p>2. Kryesuesi i Bordit emëron panelin i cili duhet të jetë numër tek. Paneli mban seanca ku palët dëgjohen dhe shqyrtohen provat.</p> <p>3. Ankesa shqyrtohet nga Bordi dhe vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.</p> <p>4. Ankesa shqyrtohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit. Në rast se ankuesi nuk pranon vendim brenda tridhjetë (30) ditëve nga Bordi, ai mund të iniciojë padi në gjykatën kompetente.</p> <p>5. Në rastet kur Bordi konstaton se konflikti i interesit ka lindur ose mund të lindë në një rast të caktuar si rezultat i marrëdhënieve familjare, marrëdhënieve biznesore ose ndonjë faktori tjetër, anëtari nuk merr pjesë në shqyrtimin e atij rasti.</p>	<p>appeal of the taxpayer.</p> <p style="text-align: center;">Article 115 Board procedure</p> <p>1. The board shall hold hearings where parties are heard and evidence is examined, as well as closed hearings.</p> <p>2. The Chairperson of the Board shall appoint the panel, which must have an odd number of members. The panel shall hold hearings where the parties are heard and evidence is examined.</p> <p>3. The appeal shall be reviewed by the Board and the decision made by the majority of the votes of the members of the Board.</p> <p>4. The appeal shall be reviewed within thirty (30) days from the date of receipt. In case the claimant does not receive a decision within thirty (30) days from the Board, they can initiate a lawsuit with the competent court.</p> <p>5. In cases where the Board determines that a conflict of interest has arisen or may arise in a particular case as a result of family relationships, business relationships or any other factor, that member shall not participate in the consideration of that case.</p>	<p>poreskog obveznika.</p> <p style="text-align: center;">Član 115 Procedura odbora</p> <p>1. Odbor održava ročišta na kojima se saslušavaju stranke i ispituju dokazi, kao i zatvorena ročišta.</p> <p>2. Predsednik odbora imenuje panel koji mora da bude sačinjen od neparnog broja. Panel održava ročišta na kojima se saslušavaju stranke i ispituju dokazi.</p> <p>3. Žalbu razmatra Odbor i odluku donosi većinom glasova članova Odbora.</p> <p>4. Žalba se razmatra u roku od trideset (30) dana od dana prijema. U slučaju da podnosilac žalbe ne prihvati odluku od Odbora u roku od trideset (30) dana, može da pokrene tužbu kod nadležnog suda.</p> <p>5. U slučajevima kada Odbor utvrdi da je nastao sukob interesa ili da može da nastane u konkretnom slučaju kao rezultat porodičnih ili poslovnih odnosa ili nekog drugog faktora, član ne učestvuje u ispitivanju tog slučaja.</p>
--	---	---

<p>6. Pas marrjes së pëlqimit me shkrim të Ministrisë, Bordi miraton rregulloren për procedurën e zhvillimit të seancave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 116 Marrëveshja tatimore</p> <p>1. Para seancës së Bordit, palët mund të rregullojnë konfliktin, tërësisht ose pjesërisht, përmes një marrëveshjeje mbi çështjet dhe shumën e tatimeve, detyrimeve, gjobave ose interesit përkatës. Marrëveshja duhet të jetë me shkrim dhe hyn në fuqi sapo të nënshkruhet nga dy palët dhe dorëzohet në Bord.</p> <p>2. Deri në përfundim të seancës kryesore, palët me propozimin e tyre ose të gjykatës mund të zgjedhin konfliktin e tyre, tërësisht ose pjesërisht, përmes marrëveshjes së ndërmjetësimit mbi çështjet dhe shumën e tatimeve, detyrimeve, gjobave ose interesit përkatës. Marrëveshja duhet të jetë me shkrim dhe hyn në fuqi sapo të pranohet nga gjykata.</p> <p>3. Nëse marrëveshja është e pjesshme, pjesa e mbetur e kërkesës vazhdon të shqyrtohet nga Bordi ose gjykata.</p> <p>4. Ministri nxjerr akt nënligjor për të rregulluar procedurat e parashtrimit të kërkesës për marrëveshje dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesës nga institucionet përkatëse deri në arritjen apo mos arritjen</p>	<p>6. After receiving the written consent of the Minister, the Board shall approve the regulation for the hearings procedure.</p> <p style="text-align: center;">Article 116 Tax agreement</p> <p>1. Before the Board hearing, the parties may settle the conflict, in whole or in part, through an agreement on the issues and the amount of the relevant taxes, duties, penalties or interest. The agreement must be in writing and becomes effective as soon as it is signed by both parties and submitted to the Board.</p> <p>2. Until the end of the main hearing, the parties may, at their own or the court's proposal, settle their conflict, in whole or in part, through the mediation agreement on the issues and the amount of taxes, duties, fines or related interest. The agreement must be in writing and becomes effective as soon as it is accepted by the court.</p> <p>3. If the agreement is partial, the remainder of the claim continues to be reviewed by the Board or the court.</p> <p>4. The Minister shall issue a by-law to regulate the procedures for submitting the request for an agreement and the procedures for examining the request by the relevant institutions until reaching or not reaching an</p>	<p>6. Nakon dobijanja pismene saglasnosti ministra, Odbor usvaja uredbu o postupku vođenja ročišta.</p> <p style="text-align: center;">Član 116 Poreski sporazum</p> <p>1. Pre rasprave u Odboru, strane mogu da reše sukob, u celosti ili delimično, sporazumom o pitanjima i iznosu relevantnih poreza, dažbina, novčanih kazni ili kamata. Sporazum mora biti u pisanoj formi i stupa na snagu čim ga potpišu obe strane i predaju Odboru.</p> <p>2. Do kraja glavnog ročišta, stranke svojim ili sudskim predlogom mogu da reše svoj sukob, u celini ili delimično, sporazumom o posredovanju o pitanjima i iznosu relevantnih poreza, dažbina, novčanih kazni ili kamata. Sporazum mora biti u pisanoj formi i stupa na snagu čim ga sud prihvati.</p> <p>3. Ako je sporazum delimičan, preostali deo zahteva nastavlja da ispituje Odbor ili sud.</p> <p>4. Ministar donosi podzakonski akt kojim uređuje procedure za podnošenje zahteva za sporazum i procedure za razmatranje zahteva od strane nadležnih institucija do postizanja ili nepostizanja sporazuma,</p>
---	---	--

<p>e marrëveshjes duke vendosur kritere të qarta për arritjen apo mos arritjen e marrëveshjes.</p> <p style="text-align: center;">Neni 117 Obligimi për të paguar detyrimin tatimor gjatë procedurës së ankesave</p> <p>1. Paraqitja e ankesës në Njësinë e Ankesave dhe në Bord, si dhe paraqitja e padisë në gjykatën kompetente nuk pezullon obligimin për pagesë të detyrimeve tatimore.</p> <p>2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, mbledhja e tatimit përmes masës për marrjen e pasurisë është e ndaluar në pasurinë e paluajtshme, për deri sa tatimpaguesi ka të drejtë të ankohet në Bord apo gjykatë kompetente. Çdo tatimpagues që kërkon të shtyjë veprimin e mbledhjes së tatimit para se të bëjë një ankesë te Bordi apo gjykata kompetente, mund të dorëzojë një garancion bankar ose formë tjetër të sigurisë të pranueshme nga ATK, për një shumë të mjaftueshme për të mbuluar tatimin, gjobën, dhe interesin e tillë që mund të rritet gjatë çdo veprimi pasues.</p> <p>3. Nëse tatimpaguesi, kundër njoftim-vlerësimit, ka parashtruar ankesë në Njësinë e Ankesave, ATK nuk do të ndërmarrë veprim në konfiskimin e pasurisë së luajtshme të tatimpaguesit deri</p>	<p>agreement, establishing clear criteria for reaching or not reaching an agreement.</p> <p style="text-align: center;">Article 117 Obligation to pay tax due during appeals proceedings</p> <p>1. Submitting an appeal to the Appeals Unit and the Board, as well as filing a lawsuit in the competent court, does not suspend the obligation to pay tax liabilities.</p> <p>2. Notwithstanding paragraph 1 of this article, the collection of tax through the levy is prohibited in real estate, as long as the taxpayer has the right to appeal to the competent Board or court. Any taxpayer who seeks to postpone the action of tax collection before filing an appeal with the Board or the competent court, may submit a bank guarantee or other form of security acceptable to the TAK, for an amount sufficient to cover the tax, the fine, and such interest as may accrue during any subsequent action.</p> <p>3. If the taxpayer, against the notice-assessment, has submitted an appeal to the Appeals Unit, the TAK will not take action in the confiscation of the taxpayer's movable property until a decision is issued</p>	<p>utvrđujući jasne kriterijume za postizanje ili nepostizanje sporazuma.</p> <p style="text-align: center;">Član 117 Obaveza plaćanja poreske obaveze tokom žalbenog postupka</p> <p>1. Podnošenje žalbi Jedinici za žalbe i Odboru, kao i podnošenje tužbe nadležnom sudu, ne miruje obavezu plaćanja poreskih obaveza.</p> <p>2. Sa izuzetkom stava 1. ovog člana, na nepokretnostima je zabranjena naplata poreza putem mere oduzimanja imovine, sve dok poreski obveznik ima pravo žalbe nadležnom odboru ili sudu. Svaki poreski obveznik koji želi da odloži radnju naplate poreza pre podnošenja žalbe Odboru ili nadležnom sudu, može da preda bankarsku garanciju ili drugi oblik obezbeđenja prihvatljiv PAK-u, za iznos dovoljan da pokrije porez, kaznu i kamate koje mogu nastati tokom bilo koje naknadne radnje.</p> <p>3. Ako je poreski obveznik, protiv obaveštenja-procene, uložio žalbu Jedinici za žalbe, PAK neće preduzeti radnje na konfiskaciji pokretne imovine poreskog obveznika dok se ne donese</p>
--	--	--

<p>në nxjerrjen e një vendimi nga Ankesat, me përjashtim të rasteve kur shpallet tatimi në rrezik. Një kufizim i tillë i masës së konfiskimit nuk e ndalon ATK që të vendosë barrën tatimore në të gjithë pasurinë apo në një pjesë të pasurisë së tatimpaguesit, derisa borxhi tatimor të paguhet.</p>	<p>by the Appeals Unit, except in cases of jeopardy assessments. Such limitation of the measure of confiscation does not prevent the TAK from placing the tax lien on all or part of the taxpayer's property, until the tax debt is paid.</p>	<p>odluka od strane Žalbe, osim u slučajevima kada je porez proglašen ugroženim. Ovakvo ograničenje mere konfiskacije ne sprečava PAK da stavi poreski zalog na celu imovinu ili na deo imovine poreskog obveznika, sve dok se poreski dug ne plati.</p>
<p>4. Përveç rastit kur pasuria e konfiskuar është e tillë që priset, pasuria e konfiskuar nga ATK nuk shitet ose tjetërsohet deri në kalimin e periudhës tridhjetë (30) ditore pas dorëzimit të njoftimit për konfiskim sipas paragrafit 6 të nenit 30 të këtij Ligji ose deri në përfundimin e procedurave të ankesave të parashikuara në këtë Ligj, cilido qoftë afati më i fundit. Aty ku pasuria e konfiskuar është shitur ose është tjetërsuar, të gjitha paratë mbahen nga ATK për kreditim të tatimpaguesit derisa të jetë zgjidhur përfundimisht çështja për të cilën është ngritur ankesa, në të cilën kohë bëhet rimbursimi i tatimpaguesit sipas paragrafit 5 të këtij neni ose do të bëhet ulja nga shuma e pashlyer sipas paragrafit 6 të këtij neni, sipas rastit.</p>	<p>4. Unless the property seized is perishable, property seized by TAK shall not be sold or otherwise disposed of until the expiry of the thirty (30) day period after delivery of notice of seizure under paragraph 6 Article 30 of this law, or until the conclusion of the appeal procedures provided for in this law, whichever is the later. Where property seized has been sold or otherwise disposed of, any proceeds shall be held by TAK for the credit of the taxpayer until the matter that is appealed is finally resolved, at which time it shall be refunded to the taxpayer under paragraph 5 of this Article, or deducted from the amount outstanding under paragraph 6 of this Article, as appropriate.</p>	<p>4. Osim u slučaju kada je konfiskovana imovina kvarljiva, imovina zaplenjena od strane PAK-a se ne prodaje ili otuđuje sve dok ne prođe rok od trideset (30) dana nakon dostavljanja obaveštenja o konfiskaciji prema stavu 6. člana 30. ovog zakona ili do okončanja žalbenih postupaka predviđenih ovim zakonom, u zavisnosti od toga koji je krajnji rok. Kada je konfiskovana imovina prodana ili otuđena, sav novac čuva PAK za kreditovanje poreskog obveznika sve dok se pitanje za koje je podneta žalba konačno ne reši, nakon čega se poreskom obvezniku isplaćuje naknada u skladu sa stavom 5. ovog člana ili se izvrši umanjenje neisplaćenog iznosa prema stavu 6. ovog člana, u zavisnosti od slučaja.</p>
<p>5. Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK i kthen çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria për secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga</p>	<p>5. If a matter that is appealed is finally resolved in favor of the taxpayer, TAK shall refund any excess tax paid, together with interest calculated at the rate prescribed by the Ministry in respect of each whole calendar month between the date of payment by the taxpayer to the date of TAK</p>	<p>5. Ako je predmet za koju je podneta žalba konačno rešen u korist poreskog obveznika, PAK vraća sav preplaćeni porez, zajedno sa kamatom obračunatom po stopi koju utvrđuje Ministarstvo za svaki kalendariski mesec između datuma uplate od strane poreskog obveznika i</p>

<p>tatimpaguesi dhe datës kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë.</p> <p>6. Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesa është zgjidhur përfundimisht në favor të ATK, tatimpaguesi paguan tatimin e pashlyer, gjobat dhe interesin që është vlerësuar deri kur është zgjidhur lënda.</p> <p style="text-align: center;">Neni 118 Rregullat ndërkombëtare</p> <p>1. Aty ku ligjet ekzistuese të Kosovës për tatime lidhen me tatuarjen ndërkombëtare nuk e adresojnë tatuarjen e transaksioneve ndërkombëtare, ato mund të interpretohen me Direktivat e Bashkimit Evropian, si dhe rregullave dhe parimeve ndërkombëtare.</p> <p>2. Aty ku ligjet ekzistuese tatimore që lidhen me tatuarjen e dyfishtë ndërkombëtare juridike të të ardhurave dhe kapitalit të personave në Republikën e Kosovës nuk adresojnë tatuarjen e tillë, do të interpretohen me parimet e Modelit të Konventës Tatimore mbi të Ardhurat dhe mbi Kapitalin të OECD, Modeli i Konventës për tatuarje të dyfishtë i Kombeve të Bashkuara, me qëllim të shmangies së tatuarjes së dyfishtë të të ardhurave dhe kapitalit të tillë.</p> <p>3. Aty ku ligjet ekzistuese tatimore që lidhen me tatuarjen e transaksioneve për</p>	<p>referring the refund to the Ministry for payment.</p> <p>6. If a matter that is appealed is finally resolved in favor of TAK, the taxpayer shall pay outstanding tax, fines and interest accrued until the matter is resolved.</p> <p style="text-align: center;">Article 118 International Rules</p> <p>1. Where Kosovo’s existing tax laws related to international taxation do not address the taxation of international transactions, they can be interpreted following European Union Directives, as well as international rules and principles.</p> <p>2. Where the existing tax laws relative to the international juridical double taxation of revenues and capital of persons in Republic of Kosovo do not address such taxation, they will be interpreted following the principles of the OECD Model Tax Convention on Income and on Capital, and UN’s Model Double Taxation Convention shall apply in order to avoid double taxation of such income and capital.</p> <p>3. Where existing tax laws relating to the taxation of VAT transactions for goods and</p>	<p>datuma kada PAK upućuje naknadu Ministarstvu za isplatu.</p> <p>6. Ako je predmet za koji je podneta žalba konačno rešen u korist PAK-a, poreski obveznik plaća neplaćeni porez, kazne i kamate koje su procenjene do rešavanja slučaja.</p> <p style="text-align: center;">Član 118 Međunarodna pravila</p> <p>1. Tamo gde se postojeći poreski zakoni Kosova koji se odnose na međunarodno oporezivanje ne bave oporezivanjem međunarodnih transakcija, oni se mogu tumačiti direktivama Evropske unije, kao i međunarodnim pravilima i principima.</p> <p>2. Kada postojeći poreski zakoni koji se odnose na međunarodno-pravno dvostruko oporezivanje dohotka i kapitala lica u Republici Kosovo ne tretiraju takvo oporezivanje, oni će se tumačiti po principima OECD-ovog Modela poreske konvencije o prihodu i kapitalu, Model konvencije o dvostrukom oporezivanju, radi izbegavanja dvostrukog oporezivanja takvog prihoda i kapitala.</p> <p>3. Tamo gde postojeći poreski zakoni koji se odnose na oporezivanje PDV</p>
--	---	--

TVSh për mallrat dhe shërbimet nuk adresojnë tatuarjen e tillë, ato mund të interpretohen me parimet e Direktivave të Sistemit të TVSh së Bashkimit Evropian dhe gjykimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

**KAPITULLI XI
DISPOZITAT KALIMTARE DHE
PËRFUNDIMTARE**

**Neni 119
Dispozitat Kalimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, të gjitha ankesat me këtë Ligj dorëzohen në Bord gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji..

2. Divizioni Fiskal pranë Gjykatës përkatëse vazhdon të trajtojë të gjitha ankesat e pranuar deri në hyrjen në fuqi të këtij Ligji, si dhe t'i pranoj ankesat edhe për gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

3. Të gjitha procedurat e iniciuara para hyrjes në fuqi të këtij Ligji zhvillohen sipas legjislacionit që ka qenë në fuqi në kohën e inicimit të atyre procedurave.

services do not address such taxation, they may be interpreted following the principles of the European Union VAT System Directives and judgments of the European Court of Justice.

**CHAPTER XI
TRANSITORY AND FINAL
PROVISIONS**

**Article 119
Transitional Provisions**

1. Upon the entry into force of this Law, all appeals under this Law shall be submitted to the Board six (6) months after the entry into force of this Law.

2. The Fiscal Division at the Basic Court shall continue to handle all appeals received until the entry into force of this Law, as well as to accept appeals for six (6) months after the entry into force of this Law.

3. All proceedings initiated before the entry into force of this Law, shall be conducted according to the legislation that was in force at the time of initiation of those proceedings.

transakcija za dobra i usluge ne tretiraju takvo oporezivanje, oni se mogu tumačiti po principima Direktiva sistema PDV-a Evropske unije i presudama Evropskog suda pravde.

**POGLAVLJE XI
PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE**

**Neni 119
Prelazne odredbe**

1. Stupanjem na snagu ovog zakona, sve žalbe po ovom zakonu podnose se Odboru šest (6) meseci nakon stupanja na snagu ovog zakona.

2. Fiskalni odsek pri Osnovnom sudu nastavlja sa rešavanjem svih žalbi primljenih do stupanja na snagu ovog zakona, kao i sa prihvatanjem žalbi šest (6) meseci nakon stupanja na snagu ovog zakona.

3. Svi postupci započeti pre stupanja na snagu ovog zakona odvijaju se u skladu sa zakonima koji su bili na snazi u vreme pokretanja tih postupaka.

<p style="text-align: center;">Neni 120 Plotësimi dhe ndryshimi i Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik</p> <p>1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, plotësohet dhe ndryshohet Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ashtu që Neni 44, paragrafit 1.6, i shtohet nën-paragrafi 1.6.3. me tekstin si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.6.3. Shtojca Nr. 6.3. - Administrata Tatimore e Kosovës.</p> <p>2. Shtojca Nr. 6.3. - Administrata Tatimore e Kosovës, i bashkangjitet këtij Ligji.</p> <p>3. Ky nen fillon të zbatohet pas miratimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të ATK dhe klasifikimit të pozitave të punës brenda ATK.</p>	<p style="text-align: center;">Article 120 Amendment of Law No. 08/L-196 on Salaries in the Public Sector.</p> <p>1. The entry into force of this Law shall amend Law No. 08/L-196 on Salaries in the Public Sector, so that in Article 44, paragraph 1.6, sub-paragraph 1.6.3. with the following text is added:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.6.3. Annex No. 6.3. - Tax Administration of Kosovo .</p> <p>2. Annex No. 6.3. - Tax Administration of Kosovo, attached to this Law.</p> <p>3. This article shall begin to be implemented after the adoption of the Regulation on the Internal Organization of the TAK and the classification of jobs within the TAK.</p>	<p style="text-align: center;">Član 120 Dopuna i izmena zakona br. 08/L-196 o platama u javnom sektoru</p> <p>1. Sa primenom ovog zakona, Zakon br. 08/L-196 o platama u javnom sektoru se dopunjuje i dopunjuje, tako da se član 44, stav 1.6, dodaje u pod-stav 1.6.3. Sa tekstom na sledeći način:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.6.3. Aneks br. 6.3. - Poreska uprava Kosova.</p> <p>2. Aneks br. 6.3. Poreska uprava Kosova je pripojena ovom zakonu.</p> <p>3. Ovaj član počinje da se primenjuje nakon usvajanja Uredbe o unutrašnjoj organizaciji TAK-a i klasifikacije pozicija rada u okviru TAK- a.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 121 Aktet Nënligjore</p> <p>Aktet nënligjore të përcaktuara në këtë Ligj nxjerrën nga Ministri dhe Qveria brenda një (1) viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.</p>	<p style="text-align: center;">Article 121 By-laws</p> <p>The by-laws defined in this Law shall be issued by the Minister and the Government within one (1) year from the date of entry into force of this Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 121 Podzakonski akti</p> <p>Podzakonske akte utvrđene ovim zakonom donosi minister i valda u roku od jedne (1) godine od dana stupanja na snagu ovog zakona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 122 Shfuqizimi</p> <p>1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji,</p>	<p style="text-align: center;">Article 122 Repeal</p> <p>1. Upon the entry into force of this Law,</p>	<p style="text-align: center;">Član 122 Ukidanje</p> <p>1. Stupanjem na snagu ovog zakona</p>

<p>shfuqizohen:</p> <p>1.1. Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat;</p> <p>1.2. Ligji Nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat; dhe</p> <p>1.3. Ligji Nr. 04/L-223 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102.</p> <p style="text-align: center;">Neni 123 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetë Zyrtare.</p> <p style="text-align: center;">Glauk Konjufca</p> <hr/> <p style="text-align: center;">Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p>the following are repealed:</p> <p>1.1. Law No. 03/L-222 on Tax Administration and Procedures;</p> <p>1.2. Law No. 04/L-102 on amending and supplementing Law No. 03/L-222 on Tax Administration and Procedures; and</p> <p>1.3. Law No. 04/L-223 on amending and supplementing Law No. 03/L-222 on Tax Administration and Procedures, amended and supplemented by Law No. 04/L-102.</p> <p style="text-align: center;">Article 123 Entry into Force</p> <p>This Law shall enter into force fifteen (15) days after its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Glauk Konjufca</p> <hr/> <p style="text-align: center;">Speaker of the Assembly of the Republic of Kosovo</p>	<p>ukidaju se:</p> <p>1.1. Zakon br. 03/L-222 o poreskoj administraciji i postupcima;</p> <p>1.2. Zakon br. 04/L-102 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-222 o poreskoj administraciji i postupcima; i</p> <p>1.3. Zakon br. 04/L-223 o dopunama i izmenama Zakona br. 03/L-222 o poreskoj administraciji i postupcima, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-102.</p> <p style="text-align: center;">Član 123 Stupanje na snagu</p> <p>Ovaj akt stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja u Službenom glasniku.</p> <p style="text-align: center;">Glauk Konjufca</p> <hr/> <p style="text-align: center;">Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>
---	--	--

SHTOJCË

SHTOJCA NR.6.3 - ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS (ATK)					
NR.	EMËRTIMI I POZITËS	GRUPI	KLASA	KOEFICIENTI	FUSHA E ZBATIMIT
1	Drejtorë/i Ekzekutiv e/i ATK	N	N1	14.5	
2	Zv. Drejtorë/i Ekzekutiv e/i ATK		N1	12	
3	Drejtor/e Departamenti në ATK		N2	11	
	Drejtor/e Rajonal në ATK		N3	10.4	
4	Udhëheqës/e Divizioni në ATK		N4	9.4	
5	Zyrtar/e i/e lartë tatimor 1 (niveli i katërt tatimor)		N5	8.4	
6	Zyrtar/e i/e lartë tatimor 2 (niveli i tretë tatimor)		N6	7.8	
7	Zyrtar/e tatimor 3 (niveli i dytë tatimor)		N7	7.4	
8	Zyrtar/e tatimor 4 (niveli i parë tatimor)		N8	6.5	
9	Asistent teknik mbështetës	N9	4.5		